**URBANIZIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË EKONOMI "QYTETI I TIRANËS"**

Otjela Lubonja

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, profili Menaxhim, për marrjen e gradës shkencore "Doktor"

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Luljeta Minxhozi

Numri i fjalëve: 50.163

Tiranë, Nëntor 2015

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se, ky punim, me temë "Urbanizimi dhe ndikimi i tij në Ekonomi", Qyteti i Tiranës, për marrjen e gradës "Doktor" në Fakultetin Ekonomik, departamenti i Menaxhimit, është punimi im origjinal. Deklaroj gjithashtu se, burimet në të cilat u mbështeta për zhvillimin e këtij punimi, janë paraqitur në mënyrë të hollësishme, duke paraqitur autorët, titujt e librave ose revistave dhe faqet përkatëse. Gjithashtu, është paraqitur në mënyrë të hollësishme, çdo site në internet në të cilin është marrë informacioni.

## *Abstrakt*

*Vendet në zhvillim arrijnë një urbanizim tepër të shpejtë në raport me disa vende të tjera. Procesi i urbanizimit është i lidhur me nivelet e zhvillimit dhe disa pohojnë se, për një vend të zhvilluar, ekziston nevoja për rritjen e nivelit të industrializimit, sepse sipas shkollës moderne të mendimit, nuk mund të ketë urbanizim pa rritje ekonomike. Vendet e zhvilluara kanë kaluar nëpër këtë proces dhe sipas kësaj qasjeje, vendet në zhvillim duhet të bëjnë të njëjtën gjë. Kjo situatë, gjithsesi supozohet të jetë e ndryshme, si p.sh.: në qytetin e Tiranës në raport me qytetet e tjera. Teoria moderne e urbanizimit nuk zbatohet për vendet në zhvillim, të cilat nuk kanë arritur rritjen ekonomike të vendeve të zhvilluara, para se të arrijnë nivele të larta të urbanizimit. Kjo pastaj ngre pyetjen se, si qytete të zhvilluara që i përkasin Shqipërisë, dhe konkretisht qyteti i Tiranës, kanë arritur urbanizim dhe vazhdojnë të urbanizohen.*

*Me fjalë të tjera, teoria moderne e urbanizimit është e zbatueshme për urbanizimin shqiptar. Një masë standarde, indeksi i urbanizimit, është zhvilluar për matjen e urbanizimit në Shqipëri, që prej masës tradicionale për urbanizimin varet nga ajo që çdo vend përcaktohet sa urban është. Kjo pastaj, krahasuar me masën tradicionale të urbanizimit, theksohet në parashikimin e urbanizimit në Shqipëri. Është gjetur se treguesit socialë të zhvillimit kanë tendencë që të parashikojnë urbanizimin më shumë se variablat tradicionalë ekonomikë mbi të cilët është bazuar teoria e modernizimit. Gjithashtu, ndryshoret socio-ekonomike të zhvillimit kanë tendencë që të parashikojnë indeks urbanizimi më të saktë se shkalla e urbanizimit, i cili është masa tradicionale për urbanizimin. Ajo çka synohet të vërtetohet në këtë punim është se si faktorë të ndryshëm ndikojnë në urbanizim, dhe e anasjellta, si ndikon urbanizimi në ekonominë e një vendi.*

***Fjalët kyçe:*** *urbanizim, zhvillim, rritje ekonomike, popullsi, migrim, urbane, rurale.*

## *Abstract*

*Developing countries reach urbanization faster compared to some other countries. The process of urbanization is associated with levels of development and some claim that, for a developed country, there is a need to increase the level of industrialization, as to modern school's opinion, there can be no economic growth without urbanization. Developed countries have passed through this process and under this approach, developing countries should do the same. This Situation, however, is supposed be different for eg: in the city of Tirana compared to other cities. The modern theory of urbanization does not apply to developing countries that haven't yet achieved economic growth of areas, developed before reaching high levels of urbanization. This then raises the question how the developed cities of Albania, specifically the city of Tirana have reached urbanization and continue toward their way of doing it.*

*In other words, the modern theory of urbanization can be applied to the Albanian urbanization. A standard measure, the index of urbanization has been developed for the measurement of urbanization in Albania since traditional mass urbanization depends each country being defined as urban. After, it was compared with the traditional mass urbanization in anticipation note of urbanization in Bangladesh. It was found that the social development indicators tend to predict urbanization over traditional economic variables which is based on the theory of modernization.*

*Also, socio-economic variables of development tend to predict accurately index urbanization rate of urbanization, which is the traditional measure of urbanization. The aim of this paper is to prove how different factors affect the urbanization and vice versa, as urbanization affects the economy of a country.*

***Keywords:*** *urbanization, development, economic growth, population, migration, urban, rural.*

**DEDIKIMI**

***Familjes sime, e cila mbështet çdo përpjekje timen!***

## MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Ky punim është rezultat i një përpjekjeje personale disavjeçare. Ndihmësja ime kryesore në këtë përpjekje ishte Prof. Dr. Luljeta Minxhozi, e cila, me durim dhe këmbëngulje, më udhëhoqi gjatë gjithë punës sime. Sugjerimet e saj, vërejtjet dhe mbështetja morale, ndikuan në përfundimin me sukses të këtij punimi. E konsideroj të vlefshme ta falënderoj nga zemra për ndihmën dhe mbështetjen e ofruar.

Falënderoj gjithashtu pedagogët e Universitetit Europian të Tiranës që kanë ndjekur në vazhdimësi prezantimet e bëra në ditët doktorale, duke dhënë sugjerimet e tyre.

Së fundmi, dua të falënderoj familjen time, për mbështetjen që më ka dhënë gjatë gjithë kohës së përgatitjes së këtij punimi.

*Faleminderit!*

**TABELA E PËRMBAJTJES**

**KAPITULLI 1:** ........ **1**

1.1. Motivacioni ........ 1

1.2. Hyrje ........ 1

1.3. Qëllimi dhe objektivat e studimit ........ 2

1.4. Hipotezat/ pyetjet kërkimore të punimit ........ 4

1.5. Organizimi i studimit ........ 5

1.6. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë ........ 6

1.7. Përmbledhje e kapitullit ........ 6

**KAPITULLI II: KUADRI TEORIK " URBANIZIMI DHE ZHVILLIMI"** ........ **8**

2.1. Përkufizimi i termit "urbanistikë", fillesat e studimeve urbanistike ........ 8

2.2. Koncepti "qytet". Lindja e tij dhe hipotezat e ndryshme të krijimit ........ 10

2.3. Urbanizimi global dhe rritja ekonomike ........ 16

2.4. Teoritë e urbanizimit ........ 20

*2.4.1. Teoria moderne* ........ 21

*2.4.2. Teoria e varësisë* ........ 26

*2.4.3. Teoria e "shtrembër" urbane* ........ 27

2.5. Urbanizimi dhe Zhvillimi ........ 28

2.6. Lidhja e ngushtë që ekziston midis ekonomisë dhe urbanizimit ........ 34

*2.6.1. Modelet e variacionit të përkohshëm gjeografik, Urbanizimi global, Korrelacioni i urbanizimit dhe rritjes ekonomike* ........ 37

2.7. Konkluzione ........ 40

**KAPITULLI III: ZHVILLIMI URBAN DHE TREGUESIT EKONOMIKË-FINANCIARË/ QYTETI I TIRANËS** ........ **42**

**Pjesa I: Zhvillimi urban dhe treguesit ekonomikë-financiarë** ........ **42**

3.1. Si ka evoluar sektori urban në Shqipëri? ........ 42

*3.1.1. Si paraqitej urbanistika në vitet 1912-1944, 1944-1990 dhe 1990-2015.* .................. 43

3.2. 100 vjet Ekonomi Shqiptare .................................................................................... 46

*3.2.1. Ekonomia shqiptare gjatë regjimit komunist (1945-1990) dhe përpjekjet për industrializimin e vendit.* ................................................................................................ 48

3.3. Planet pesëvjeçare (1951-1985) ............................................................................... 50

3.4. Kriza totale e sistemit socialist ................................................................................. 59

3.5. Reformat ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit dhe rritja ekonomike, përcaktimi i strategjisë më të mirë ............................................................................................... 61

3.6. Treguesit kryesorë ekonomikë gjatë 1990-2000 ........................................................ 63

3.7. Konkluzione ............................................................................................................. 65

**KAPITULLI III: ZHVILLIMI URBAN DHE TREGUESIT EKONOMIKË-FINANCIARË/ QYTETI I TIRANËS** ............................................................................ **66**

**Pjesa II: Qyteti i Tiranës dhe koncepti "Zhvillim i Qëndrueshëm"** ................................ **66**

3.8. Ekonomia e Tiranës dhe perspektiva e saj ................................................................. 66

3.9. Zhvillimi i territorit që prej 1990-ës ......................................................................... 67

3.10. Të dhëna të përgjithshme mbi qytetin e Tiranës ....................................................... 70

*3.10.1. Historia e urbanizimit në Tiranë dhe historiku i planeve rregulluese* ..................... 71

3.11. Industria e ndërtimit dhe faktorët që ndikuan në zhvillimin e qytetit të Tiranës. .......... 100

*Faktorët që ndikuan në zhvillimin e industrisë së ndërtimit* ............................................ 101

3.12. Vlerësimi social-ekonomik në qytetin e Tiranës ....................................................... 102

*3.12.1. Të dhëna mbi institucionet arsimore* ................................................................... 102

*3.12.2. Institucionet shëndetësore* .................................................................................. 105

*3.12.3. Zhvillimi i Turizmit në Tiranë* ............................................................................. 107

*3.12.4. Tirana - qyteti i qendrave më të mëdha tregtare në vend* ....................................... 108

*3.12.5. Zonat e gjelbra në Tiranë* ................................................................................... 110

*3.12.6. Investimet e Huaja Direkte dhe efektet e tyre* ....................................................... 112

3.13. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe koncepti i tij ..................................................... 114

3.14. Konkluzione ........................................................................................................ 115

**KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT ........................................................ 117**

4.1. Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik ....................... 117

4.2. Burimet e informacionit ............................................................................................ 117

4.3. Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit ........................................ 119

4.4. Përmbledhje e kapitullit ............................................................................................ 127

**KAPITULLI V. ANALIZA DHE INTERPRETIME TË DHËNASH "QYTETI DHE EKONOMIA" ........................................................................................................ 128**

5.1. Urbanizimi dhe rritja ekonomike ............................................................................... 132

5.2. Urbanizimi dhe cilësia e jetës .................................................................................... 140

*5.2.1. Urbanizimi dhe jetëgjatësia në Shqipëri* ................................................................. 142

*5.2.2 Jetëgjatësia në zonat rurale* ..................................................................................... 146

5.3. Investimet dhe Rritja Ekonomike ............................................................................... 150

5.4. Investimet dhe Urbanizimi ........................................................................................ 161

5.5. Urbanizimi dhe Energjia ........................................................................................... 165

5. 6. Qytetet dhe bizneset ............................................................................................... 169

*5.6.1 Mundësia për të bërë biznes* ..................................................................................... 174

*5.6.2. Urbanizimi dhe ndërmarrjet e mëdha* ..................................................................... 179

5.7. Konkluzione ............................................................................................................ 181

**KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME ........................................... 182**

6.1. Hyrje ...................................................................................................................... 182

6.2. Konkluzione të studimit ............................................................................................ 182

6.3. Kontribute teorike të studimit .................................................................................... 184

6.4. Kontributet praktike të studimit .................................................................................. 185

6.5. Kufizimet e studimit ................................................................................................. 186

6.6. Rekomandime........................................................................................................ 187
Bibliografia.............................................................................................................. 1901
Shtojcat.................................................................................................................... 200

**Lista e figurave**

Figura 2.1. Zhvillimi i shpejtë urban dhe rritja ekonomike........................................................19
Tabela 3.7. Sistemi i planifikimit pas vitit 1990 – marrëdhëniet midis aktorëve dhe komponentëve..........................................................................................................67
Figura 3.11. Pozita gjeografike e Tiranës......................................................................... 70
Figura 3.12. Vija kufizuese e qytetit të Tiranës..................................................................71
Figura 3.13. Plani Rregullues i vitit 1929......................................................................... 76
Figura 3.14. Plani Rregullues italian (1940-1943)...........................................................78
Figura 3.15. Plani Rregullues i vitit 1957..........................................................................79
Figura 3.16. Skema e zonimit, Plani Rregullues i vitit 1990..............................................82
Figura 3.17. Skema e rrjetit rrugor dhe vija kufizuese e qytetit, Plani Rregullues i vitit 1990..................................................................................83
Figura 3.18. Planimetria e qytetit të Tiranës me funksionet e propozuara, Rregullorja e Zonimit 1996....................................................................................84
Figura 3.19. Sistemi rrugor i propozuar nga Plani Strategjik i Tiranës së Madhe.......................87
Figura 3.20. Sistemi rrugor i propozuar nga Plani Strategjik i Tiranës së Madhe. Unaza e tretë dhe Orbitalja....................................................................................88
Figura 3.21. Studimi i Zhvillimit Rajonal Tiranë-Durrës, Struktura administrative dhe hapësinore. Studimi francez i qendrës (2004) ..........................................89
Figura 3.22. Plani i Qendrës së Tiranës, Architecture Studio, 2004....................................90
Figura 3.23. Zonimi funksional i qytetit, Urbaplan, 2008..................................................94
Figura 3.24. Polet e rëndësishme të zhvillimit, Urbaplan, 2008.........................................95
Figura 3.25. Fazat e zhvillimit dhe zonat prioritare, Urbaplan, 2008..................................95
Figura 3.26. Sistemi Rrugor i propozuar, Urbaplan, 2008..................................................96
Figura 3.27. Zhvillimi i korridoreve rrugore në Tiranë, JICA 2012...................................98
Figura 3.28. Masa e zbatimit të Studimeve Pjesore të miratuara deri në vitin 2011...................99
Figura 5.1. Aktivitetet ekonomike të një vendi..............................................................128
Figura 5.2. Denduria e popullsisë për çdo rajon.............................................................. 128

**Lista e tabelave dhe grafikëve**


Grafiku 2.2. Ritmet e rritjes së popullsisë rurale, urbane dhe totale për vitet 1950-2050............16
Grafiku 2.3. Përqindja e popullsisë sipas qarqeve, 2001-2011....................................................17
Tabela 2.4. Urbanizimi dhe PBB-ja.................................................................................................18
Tabela 2.5. Tranzicioni demografik.................................................................................................24
Tabela 2.6. Fazat e rritjes ekonomike të Rostow’t në raport me urbanizimin..............................25
Grafiku 3.6. Zhvendosjet e pjesëve të Popullsisë Urbane dhe Rurale, 1945-2001.......................45
Grafiku 3.8. Klasifikimi i ndërtimit të banesave në Shqipëri sipas rajoneve.............................100
Grafiku 3.9. Shpërndarja territoriale në Shqipëri e Investimeve të Huaja Direkte.....................112
Grafiku 3.10. Xhiroja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik deri në 2008,
shprehur në %...............................................................................................................................113
Tabela 5.3. Vlerat ndër vite të Urbanizimit dhe të Prodhimit të Brendshëm
Bruto në Shqipëri.........................................................................................................................132
Grafiku 5.4. Urbanizimi dhe PBB në krahasim.......................................................................... 133
Tabela 5.5. Evolucioni i Urbanizimit dhe PBB-së në krahasim me veten................................133
Tabela 5.6. Urbanizimi në Shqipëri............................................................................................. 143
Tabela 5.7. Popullsia rurale në Shqipëri...................................................................................... 147
Figura 5.8. Evolucioni i jetëgjatësisë në raport me ndotjen.......................................................150
Tabela 5.9. Vlera e Investimeve të Huaja Direkte dhe të
Prodhimit të Brendshëm Bruto (në USD) në Shqipëri...............................................................151
Grafiku 5.10. Vlera e IHD-ve dhe e PBB-së ndër vite në Shqipëri..........................................152
Grafiku 5.11. Evolucioni nga viti në vit i rritjes së IHD-ve dhe PBB-së..................................153
Tabela 5.12. Përqindja e Urbanizimit dhe konsumi i kwh për person........................................161
Grafiku 5.13. Ecuria e konsumit të energjisë elektrike për person.............................................163
Tabela 5.14. Ecuria e Urbanizimit dhe IHD-ve ndër vite...........................................................163
Tabela 5.15. Urbanizimi dhe energjia ndër vite .........................................................................166
Tabela 5.16. Ecuria e konsumit të energjisë dhe urbanizmi ndër vite........................................167
Tabela 5.17. Ecuria e popullsisë në qarqet e Shqipërisë............................................................169
Grafiku 5.18. Krahasimi midis ecurisë së popullsisë në qarkun Tiranë dhe numri
i personave që banojnë në Shqipëri............................................................................................170

Tabela 5.19. Numri i bizneseve në Shqipëri sipas qarqeve dhe viteve......................................171
Tabela 5.20. Ndarja në fusha të veprimtarisë së ndërmarrjeve në Shqipëri................................172
Grafiku 5.21. Specializimi ekonomik i kryeqytetit...................................................................174
Tabela 5.22. Ndërmarrje për banorë ndër vite...........................................................................175
Grafiku 5.23. Krahasimi i banorëve për ndërmarrje në Tiranë dhe Shqipëri..............................176
Grafiku 5.24. Numri i banorëve të ndërmarrjeve ndër vite sipas qarqeve.................................177
Tabela 5.25. Banorë për ndërmarrje sipas viteve dhe qarqeve.................................................. 178
Grafiku 5.26. Banorë për ndërmarrje sipas viteve dhe qarqeve ................................................178
Tabela 5.27. Ndërmarrjet e mëdha (+50 punëtorë) ...................................................................180

**Lista e shkurtimeve**

PBB - Produkti i Brendshëm Bruto

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

INSTAT- Instituti i Statistikave

GNP - Produkti Kombëtar Bruto

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

BRSS - Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike

VMSJ - Vëzhgimi i Matjes së Standardeve të Jetesës

IHD - Investimet e Huaja Direkte

PKSH - Partia Komuniste Shqiptare

# KAPITULLI 1:

## 1.1. Motivacioni

Gjatë 25 viteve të fundit qyteti i Tiranës ka pësuar një sërë ndryshimesh, komplekse dhe të menjëhershme, në të gjitha aspektet: ekonomike, shoqërore dhe politike. Shprehje e qartë e dukurive të paparashikuara dhe të reja për shoqërinë shqiptare ishte ndryshimi i menjëhershëm i peizazhit fizik dhe human. Ndërveprimi i shumë aktorëve, në mes të të cilëve ndryshimi i strukturës ekonomike dhe shpallja e lirisë së qytetarëve për të lëvizur, i dha udhë procesit të urbanizimit të shpejtë, si një ndër proceset kryesore të shoqërisë shqiptare të pas viteve ‘90.

## 1.2. Hyrje

Hulumtuesit urbanë tregojnë se urbanizimi në vendet në zhvillim ndodh kryesisht për shkak të migrimit rural, dhe lëvizja shpesh shpjegohet me teori të ndryshme, të tilla si: ajo e modernizimit, varësisë, dhe teoria e “shtrembër” urbane. Këto teori janë elaboruar në rishikimin e literaturës. Nga këto tri teori, teoria e modernizimit është ajo që është referuar si shkak i urbanizimit (Kasarda dhe Crenshaw, 1991). Kjo teori tregon që kemi një marrëdhënie pozitive midis urbanizimit dhe zhvillimit.

Hulumtues të ndryshëm kanë konfirmuar këtë pohim, por asnjë studim i mëparshëm nuk ka përdorur të dhëna socio-ekonomike për të studiuar këtë marrëdhënie me qytetin e Tiranës, si një qytet që është premtues në zhvillimin ekonomik. Urbanizimi është i lidhur me probleme të tilla si: infrastruktura jo e përshtatshme, menaxhimi jo i mirë i mbeturinave, strehimi i papërshtatshëm, dhe këto probleme janë tepër të vështira për t’u çrrënjosur dhe kontrolluar. Vendet e zhvilluara vazhdojnë t’i luftojnë këto probleme. Shkalla e urbanizimit në Tiranë dhe vende të tjera në zhvillim është mjaft e ndryshme nga ajo që ka ndodhur në vendet e zhvilluara

aktualisht, në kohën kur ato ishin në zhvillim (Dutt dhe Parai, 1994) Demografikisht, migrimi është një rezultat i tërheqjes urbane, e cila ishte shkaku kryesor i urbanizimit në Shqipëri. Normat e urbanizimit ishin gjithashtu graduale në vendet e zhvilluara.

Në Tiranë dhe në vende të tjera në zhvillim, nga ana tjetër, të dy, migrimi dhe rritja natyrore, ishin shkaku kryesor i urbanizimit. Norma e urbanizimit është gjithashtu e shpejtë. Kështu, faktorët që kanë kontribuar në urbanizimin e vendeve të zhvilluara kanë qenë të ndryshëm. Për më tepër, përpjekjet për të gjetur problemet dhe shkaqet e tyre kanë qenë të pakta. Është shumë e vështirë për të përcaktuar se çfarë është e njohur si urbane.

Siç mund të nxirret nga përmbledhja e literaturës, nuk ka ndonjë përkufizim të veçantë për termin “urban”; ai ka qenë përcaktuar ndryshe, në vende të ndryshme dhe nga disiplina të ndryshme. Për të studiuar në mënyrë efektive urbanizimin dhe për të gjetur zgjidhje për problemet e tij, ekziston nevoja për nxjerrjen e një mase standarde për urbanizimin dhe gjithashtu për të identifikuar variablat e ndryshëm të zhvillimit social-ekonomik që tentojnë të parashikojnë urbanizimin në Tiranë.

## 1.3. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është analiza e urbanizimit dhe lidhjes ekonomike, faktorët që ndikojnë në urbanizimin e një vendi, duke kontribuar kështu në literaturën ekzistuese, teorike dhe empirike, në lidhje me urbanizimin.

Në këtë mënyrë, studimi kontribuon edhe në zgjerimin dhe plotësimin e studimeve të mëparshme lidhur me këtë element. Ai bën një analizë të thellë të faktorëve që ndikojnë në urbanizim dhe të rritjes ekonomike. Gjithashtu, ky studim shqyrton edhe elementë të tjerë, të cilët mendohet të jenë të lidhur me lëvizjen e popullsisë, duke analizuar marrëdhëniet shkakësore midis këtyre faktorëve dhe ndikimin e tyre në ekonomi. Gjetjet e tij kërkimore mund të ndihmojnë, në kohë të

drejtuar, për të kuptuar faktorët që tentojnë të parashikojnë urbanizimin, dhe të shërbejë si bazë për përpjekjet për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për problemet urbane, veçanërisht në Tiranë si dhe në përgjithësi. Punimi është bazuar në teorinë moderne të urbanizimit, që është më e zbatueshme për rastin e qytetit të Tiranës.

Ky studim do të kontribuojë në avancimin e njohurive në mënyrat e mëposhtme:

a) Identifikimi i variablave socio-ekonomikë që tentojnë të parashikojnë urbanizimin në Tiranë;

b) Krijimi i një mënyre për të matur urbanizimin dhe rritjen ekonomike me një masë të standardizuar.

Në qendër janë urbanizimi dhe ekonomia në Shqipëri, duke u ndalur konkretisht në qytetin e Tiranës. Modeli i paraqitur në këtë studim e koncepton urbanizimin si një variabël të varur dhe faktorët ndikues paraqiten si variabla të pavarur.

*Së pari,* studimi ka për qëllim të vlerësojë në mënyrë kritike dhe të analizojë urbanizimin dhe ndikimin në ekonomi. *Së dyti*, studimi synon të përcaktojë për secilin nga faktorët se si ndikojnë në urbanizim. *Së treti*, synon të zbulojë rëndësinë relative të secilit variabël, në mënyrë që të jetë i qartë roli i secilit prej tyre dhe praktikuesit e sektorit të dinë se ku t'i përqendrojnë përpjekjet e tyre. *Së katërti,* synohet gjithashtu të zbulohen lidhjet shkakësore direkte dhe indirekte midis të gjithë elementëve në modelin e studimit, me synim përcaktimin dhe njohjen e ndikimit të secilit prej tyre ashtu siç përjetohen realisht, së bashku dhe të ndërlidhur me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë do të ofrohet një model i testuar empirikisht për të analizuar urbanizimin dhe faktorët që ndikojnë në ekonomi.

*Së fundmi,* synohet të ofrohen konkluzione dhe rekomandime me vlerë për studiuesit dhe për sektorin e urbanistikës, për rritjen ekonomike, për përmirësimin e tyre. Në këtë kuadër, ky

studim do të jetë me interes për sektorin e urbanistikës, për sektorin e ekonomisë. Gjithashtu studimi do të jetë i vlefshëm për studiuesit në fushën e menaxhimit dhe jo vetëm, në kuadër të studimeve të tyre në lidhje me variablat e përdorur në studim.

### 1.4. Hipotezat/ pyetjet kërkimore të punimit

Studimi synon t'u përgjigjet disa pyetjeve kërkimore. Këto pyetje kanë lindur si rezultat i një studimi intensiv të literaturës mbi urbanizimin. Duke ndjekur qëllimin, mund të përcaktojmë problemet e punimit në formën e pyetjeve të mëposhtme:

1. Në ç'mënyrë urbanizimi kontribuon në zhvillimin e një vendi?
2. A ekziston një lidhje midis urbanizimit dhe ekonomisë, dhe e anasjellta?
3. Si ndikojnë investimet e huaja direkte në urbanizimin e një vendi?
4. Ku është më e lartë jetëgjatësia e banorëve, në zonat urbane apo në ato rurale?
5. Ku janë më të zhvilluara ndërmarrjet, në zonat urbane apo në ato rurale?

Rezultatet që do të arrijmë në këtë studim, a do të garantojnë suksesin e duhur në aspektin urbanistik?

**- Hipotezat e ngritura në këtë punim janë:**

1. Rritja e shkallës së urbanizimit çon në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe anasjelltas.

2. Ndonëse janë zvogëluar hendeqet mbi stilin e jetesës midis fshatit dhe qytetit në Shqipëri, ekziston një epërsi në cilësisë e jetesës dhe në jetëgjatësinë e banorëve në qytete.

3. Investimet e Huaja Direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në rritjen e urbanizimit në Shqipëri.

4. Konsumi i energjisë elektrike nuk ndikon pozitivisht në urbanizim dhe anasjelltas.

### 1.5. Organizimi i studimit

Studimi është i ndarë në një total prej gjashtë kapitujsh.

*Kapitulli i parë:* është Hyrja, e cila është preludi i studimit. Në këtë kapitull paraqiten arsyet e përzgjedhjes së temës "Urbanizimi dhe ndikimi i tij në ekonomi", rast studimor "Qyteti i Tiranës". Gjithashtu parashtrohet një hyrje se pse hulumtues të ndryshëm në mbarë botën kanë bërë studime të ngjashme në lidhje me ekonominë, qëllimi dhe objektivat e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura në këtë punim.

*Kapitulli i dytë:* është literatura e marrë në shqyrtim, ku autori përpiqet të sigurojë pikat kryesore mbi historinë e urbanizimit, zona kryesore e studimit. Gjithashtu përpiqet të sigurojë përkufizimet e ndryshme për urbanizimin, zhvillimin dhe lidhjet e tyre ekonomike, si dhe shqyrton punën e bërë nga hulumtuesit e ndryshëm në krijimin e marrëdhënieve mes urbanizimit dhe zhvillimit, teoritë e urbanizimit.

*Kapitulli i tretë:* ndahet në dy pjesë, për arsye të njohjes më të thellë të pjesës së ekonomisë dhe zhvillimit të qytetit. *Pjesa e par*ë analizon zhvillimet urbane dhe treguesit ekonomikë-financiarë në periudha të ndryshme mbi Shqipërinë, urbanistika e hershme që prej viteve 1912 deri më 2015-ën, si evoluoi ekonomia e vendit dhe zhvillimet urbane të qytetit. Ajo që ka më tepër interes në këtë kapitull është njohja e pjesës historike të Shqipërisë, ndaj, në *pjesën e dytë* të këtij kapitulli studiohet qyteti i Tiranës në tërësinë e tij, në shumë aspekte, si: planet rregulluese që janë bërë gjatë viteve në vijim nga studio të njohura, zhvillimi ekonomik, social, arsimor etj.

*Kapitulli i katërt:* ka të bëjë me metodologjinë e përdorur në këtë punim. Të dhënat e përdorura, të cilat kontribuojnë si në bazën teorike, ashtu edhe në praktikë të studimit. Analiza përshkruese dhe ajo e regresionit përbëjnë komponentët kryesorë të analizës së rezultateve të këtij studimi, testimit të hipotezave dhe nxjerrjes së konkluzioneve përfundimtare.

*Kapitulli i pestë:* ka të bëjë me analizën dhe interpretimin e të dhënave, teknikat statistikore të përdorura në studim. Shpjegohen qartë se si ndikojnë faktorë të ndryshëm në urbanizmin e një vendi dhe ndikimin që ata paraqesin në ekonomi. Në këtë kapitull vërtetohen pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura.

*Kapitulli i gjashtë:* ofron përmbledhjen e gjetjeve dhe implikimin e gjetjeve për studime urbane dhe politikat, si dhe zonat e sugjeruara për hulumtimet e ardhshme. Në këtë kapitull përshkruhen konkluzionet dhe rekomandimet që duhen ndjekur nga studimi i kryer.

### 1.6. Përshkrim i shkurtër i metodologjisë

Për të studiuar urbanizimin, ekonominë dhe faktorët që ndikojnë në ta, janë përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat janë mbledhur gjatë viteve 2000-2014; kjo pasi, para kësaj periudhe, vendi ynë ka pësuar ndryshime tepër të luhatshme e të shpejta si në ekonomi, ashtu edhe në shpërndarjen dhe lëvizjen e popullsisë, si pasojë e problemeve të shkaktuara në vitin '97. Natyra e punimit është hulumtuese dhe analitike.

Si të dhëna dytësore shërbejnë: literatura ekzistuese, si për vendet e zhvilluara, ashtu edhe për ato në zhvillim, dhe të dhëna nga INSTAT-i, Banka Botërore e institucione të tjera. Këto të dhëna kontribuojnë si në bazën teorike, ashtu edhe në praktikë të studimit. Analiza përshkruese dhe ajo e regresionit përbëjnë komponentët kryesorë të analizës së rezultateve të këtij studimi, testimit të hipotezave dhe nxjerrjes së konkluzioneve përfundimtare.

### 1.7. Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua lidhur me problemet dhe objektivat e këtij studimi, problematikën e zgjedhur, arsyet e përzgjedhjes së kësaj teme, rëndësinë që ka ky studim. Pasi kemi shtjelluar

pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë, në kapitullin vijues do të hyjmë më në thellësi të përkufizimeve për termin “urbanizim”; fillesat e studimeve urbanistike, konceptin “qytet”; hipotezat mbi krijimin e tij; lidhjen që ekziston midis ekonomisë dhe urbanizimit; teoritë e ndryshme të urbanizimit, si: teoria moderne, teoria e varësisë, teoria e “shtrembër” urbane; urbanizimin global dhe rritjen ekonomike; modelet e variacionit të përkohshëm gjeografik; korrelacionin e urbanizimit dhe rritjes ekonomike; me synim krijimin e një baze të fortë të instrumenteve teorike mbi këtë temë si dhe ballafaqimin me kontributet më të fundit të studiuesve dhe shkencës në këtë drejtim.

# KAPITULLI II: KUADRI TEORIK '' URBANIZIMI DHE ZHVILLIMI''

## 2.1. Përkufizimi i termit "urbanistikë", fillesat e studimeve urbanistike

Ky seksion shqyrton literaturë të urbanizimit në Tiranë kryesisht gjatë etapave të ndryshme në vitet para '90-ës dhe pas demokracisë. Gjithashtu shikohen faktorët dhe studiuesit e ndryshëm mbi urbanizimin dhe teoritë e urbanizimit, për të shpjeguar këtë proces. Konceptet e urbanizimit, zhvillimit dhe marrëdhënia mes urbanizimit dhe zhvillimit janë marrë në diskutim.

*Urbanistika* - vjen nga fjala latine urbs - qytet. Urbanistika është shkenca, arti dhe teknika e ndërtimit të qyteteve e qendrave të banuara, sipas një plani të caktuar, për të lejuar kushte sa më të përshtatshme banimi, pune e pushimi. Urbanistika është teoria dhe praktika e ndërtimit të qyteteve. (*Faja, Urbanistika: 5*).

Zgjidhja e detyrave urbanistike ndërthuret me një sërë faktorësh: shoqërorë, ekonomikë, demografikë, higjieno-sanitarë dhe ideoartistikë e panoramikë peizazhistë. Studimet urbanistike zgjidhin problemet e qarkullimit dhe lëvizjes në qytete. Urbanistika përcakton lidhjen me qytete e rajone të tjera, stacionet hekurudhore, linjat urbane, sistemet e brendshme rrugore, gjerësitë dhe profilet e rrugëve, rrugët e transportit të rëndë etj. Ajo është arti i organizimit hapësinor të njësive urbane dhe i kompozimit të ansambleve arkitekturore.

Problemet urbanistike në kohë dhe hapësirë kanë ndryshuar. Investimet në zona të caktuara sjellin zhvillim urban dhe rritje ekonomike në një vend.

Çfarë zhvillimi urban pritet të ketë në të ardhmen Shqipëria?

Është e vështirë të përcaktohet një linjë e qëndrueshme, pasi *urbanizimi* është një dukuri gjithmonë e ndryshueshme, por është e sigurt që linjat e zhvillimit të ardhshëm janë të lidhura me:

- ✓ qytetet;
- ✓ rritjen e numrit të popullsisë.

Urbanistika lidhet me aspektet e jetës shoqërore si:

- ✓ shteti, ligji, zhvillimi ekonomik;
- ✓ shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore;
- ✓ ndërtimet, rrugët, qendrat, objektet e infrastrukturës;
- ✓ veprimtaritë e jetës së përditshme.

Ajo vendos një raport të barabartë midis këtyre fushave të jetës.

Mungesa e njohurive mbi të kaluarën rrezikon të çojë në harresë dhe humbje të identitetit, duke na bërë të paaftë për të kuptuar zhvillimet e tashme dhe ato që do të ndodhin në të ardhmen. Pa njohur arkitekturën dhe urbanistikën e së kaluarës, shoqëria njerëzore do ta kishte të vështirë t'u përgjigjej pyetjeve të tilla si:

- ✓ si kanë qenë arkitektura dhe urbanistika në të kaluarën?
- ✓ ku kanë ndodhur këto zhvillime të këtyre fushave?
- ✓ si janë zhvilluar në hapësirë dhe kohë ato?
- ✓ cilat janë vlerat e tyre thelbësore?
- ✓ cilat vendime të së shkuarës ndikojnë në zhvillimet aktuale?

Duke iu referuar historisë së arkitekturës, duke trajtuar kronologjikisht ngjarjet historike, teoria e arkitekturës mundëson lidhjen e brendshme dhe të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të

ndryshme, si dhe veçoritë specifike, e nga ana tjetër, lidhjet e qytetërimit të popujve të ndryshëm të botës, nga periudhat e lashtësisë, deri në zhvillimet e qytetërimit të sotëm modern.

Urbanistika e qytetërimeve në Antikitet dhe më vonë në Mesjetë trajton qytetërimet e zhvilluara në luginat e lumenjve dhe në brigjet detare, veçoritë e zhvillimit, bashkëveprimin, si dhe ndikimin e tyre mbi qytetërimet e mëvonshme. Ajo përfshin dhe qytetërimin mesjetar, duke pasqyruar tipologjinë e këtij qytetërimi, i njohur ndryshe dhe si "epoka e errët" e qytetërimit botëror. Pikënisja e qytetërimit botëror merr shtysë nga fillesat e veprimtarisë ekonomike të njerëzimit, zhvillimi i mendimit, besimit dhe arteve, fundi i parahistorisë dhe fillimi i historisë. *(Benevolo, Hyrje në Arkitekturë, fq. 4)*

**2.2. Koncepti "qytet". Lindja e tij dhe hipotezat e ndryshme të krijimit**

Është fakt se koncepti "qytet" nuk ka ekzistuar gjithmonë; ai ka lindur në një periudhë të caktuar, si pasojë e një apo disa faktorëve: gjeografikë, socialë, ekonomikë dhe kulturorë. Le të trajtojmë kushtet paraurbane që kanë çuar në krijimin e qyteteve apo qytetërimit, në hapësira dhe periudha të ndryshme kohore.

Tiparet urbanistike të tyre – lidhjet ndërmjet tyre apo ndërmjet tipareve urbanistike të qyteteve antike dhe atyre moderne. Duke u nisur nga kjo kronologji, në fillim duhet të njihemi me kuadrin historiko-kulturor të Lindjes, që përcaktohet nga historianët si djepi i qytetërimit.

*Qyteti lindi:*

- ✓ Në fund të mijëvjeçarit IV p.e.s, në Lindjen e Afërt;
- ✓ Në mes të mijëvjeçarit III shihet në luginën e Indusit;

- ✓ Në mes të mijëvjeçarit II, mund të flasim për qytete në zonën e lumenjve Jance dhe Huanhe (lumi i verdhë dhe ai i kuq);
- ✓ Në periudhën midis mijëvjeçarit I p.e.s. dhe mijëvjeçarit I e.s. lindin qytetet në disa zona të Afrikës ekuatoriale dhe në kontinentin amerikan.

Kjo ndodhi kur shoqëritë e prodhuesve bujqësorë përqendrojnë tepricën e prodhimit për të mbajtur një popullsi specialistësh: artizanë, tregtarë, luftëtarë dhe besimtarë të fesë, të cilët janë të vendosur të jetojnë në një hapësirë të kufizuar dhe prej andej kontrollojnë të gjithë territorin. Ky ndryshim lidhet ngushtësisht edhe me shpikjen e shkrimit (mjet kontrolli për ndarjen dhe organizimin e tepricave bujqësore).

Kushtet për krijimin e qytetërimit, e pikërisht në Lindjen e Afërme, ishin disa.

Në periudhën e parë ka qenë zhvillimi i evolucionit neolitik agrikulturor, i cili kërkonte edhe një mjedis të favorshëm, e konkretisht, territori i gjerë i rrafshët në formë gjysmëhëne midis shkretëtirave të Afrikës dhe Arabisë, malet kufizuese në veri dhe në jug, Deti Mesdhe dhe Gjiri Persik. Zona e Irakut të sotëm, në këtë periudhë ka qenë e mbuluar me një bimësi më të pakët se zonat pyjore veriore, por të konsiderueshme në krahasim me shkretëtirat që e kufizonin.

Hapësirat e kultivueshme që lageshin nga ujërat e lumenjve. Aty rriteshin dhe një sasi e konsiderueshme pemësh frutore të egra (ulliri, vreshtat, fiku etj.). Lumenjtë, detet dhe zonat e hapura që e rrethonin dhe favorizonin shkëmbimet e mallrave, të rejave, informacioneve. Qiejt thuajse gjithmonë të kthjellët, që lejonin pamjen natën të lëvizjes së trupave qiellorë.

Ishte pikërisht kjo arsyeja që disa shoqëri neolitike, - që njihnin në këtë periudhë drithërat e kultivueshme, përpunimin e metaleve, përdorimin e mjeteve me rrota, përdorimin e kafshëve në mbajtjen e ngarkesave, barkat me rrema apo me vela – gjejnë një ambient pak të vështirë për t’i

shfrytëzuar, por të aftë që të japë prodhime shumë më të bollshme nëse punohet në mënyrë të organizuar.

Kështu, kultivimi i drithërave dhe i pemëve frutore në këtë zonë filloi të japë prodhime shumë të mira, dhe ajo çka kishte filluar në një terren të kufizuar mund të zgjerohej, me ujitjen e zonave përreth. Kështu lindin vendbanime të qëndrueshme, të cilave historianët u referohen si "fshatra" ose "qytete neolitike". Një nga fshatrat më të hershme neolitike është Jericho, në Palestinë, mijëvjeçari VIII p.e.s. Ky vendbanim ishte i rrethuar me mur dhe përfshinte shtëpi të ndërtuara me qerpiç (baltë e përpunuar dhe e tharë në diell). Po ashtu, Çatal Hoyuk, i vendosur në Turqinë e sotme, përfshinte një popullsi edhe më të madhe.

Me punën e organizuar në bujqësi rritet sasia e prodhimit, mbi atë të nevojshëm, e për pasojë, koncepti i "tepricës së prodhimit", që mblidhet dhe depozitohet, për t'u përdorur për shkëmbimet tregtare dhe punë më të mëdha ndërmjet shumë njerëzve.

Në këtë mënyrë lind nevoja e një hapësire të kufizuar e të rrethuar, që do të shërbejë për vendosjen e tepricës së prodhimit, si dhe për një sistem kontrolli të sasisë së mallit. Pasqyrimi i sistemit të kontrollit, kërkoi që prodhimet e tepërta të pasqyroheshin në lloje e sasi, e për pasojë këto veprime u bënë shtysë për fillesat e shkrimit. Bashkë me shkrimin, kemi fillimet e lindjes së koncepteve ekonomike (ndonëse tepër modeste). Shtimi i prodhimit bujqësor e përqendrimi i tepricave nëpër qytete u shoqërua:

- ✓ me shtimin e popullsisë, duke thithur vazhdimisht banorë të rinj nga rrethinat përreth;
- ✓ nga prodhimi i garantuar në sasi e cilësi;
- ✓ nga dominimi teknik dhe ushtarak i qytetit mbi rrethinat e fshatrat.

Po të marrim parasysh konceptin e "tepricës së prodhimit", mund të themi se, flasim për lindje qytetesh, kur kemi kalimin, nga një ekonomi e thjeshtë vetëplotësuese fshatare apo rurale, në përmasa më të mëdha. Prodhimi që tejkalon nevojat e komunitetit bëri të mundur shkëputjen e një grupi të caktuar njerëzish, nga puna e rëndë e prodhimit, në punë më të specializuara, artizanale, punë të lidhura me fenë (për shërbime fetare), si luftëtarë për mbrojtjen e jetës në përgjithësi etj.

- ✓ me lindjen e nevojës për një qëndrim, strehim e punësim të përhershëm.

Njerëzit e vendosur në qytet ndërtonin banesa për mbrojtje, struktura të tjera për depozitimin e tepricës së prodhimit. Depozitimi i prodhimit bëri të mundur përdorimin e tij si mall shkëmbimi në tregti. Burrat mbanin përgjegjësinë e punës së prodhimit, ndërsa gratë, krahas rritjes së fëmijëve, punimin e veshjeve dhe punë të tjera që kërkonin qëndrimin e gjatë pranë banesës. Me dhënien më shumë rëndësi të punës prodhuese sesa të punës në shtëpi, meshkujt zunë vendin kryesor në shoqëri, e për të gjitha këto arritje të njerëzve në periudhën neolitike, themi se evolucioni neolitik në këtë pikëpamje është një pikë kthese në historinë njerëzore.

Gjatë mijëvjeçarit IV-III p.e.s, zhvillime të rëndësishme teknike filluan të transformonin qytetet neolitike:

- ✓ shpikja e shkrimit mundësoi mbajtjen e shënimeve;
- ✓ përdorimi i metaleve solli një shkallë të re të shfrytëzimit të natyrës dhe të burimeve të saj.

Qysh para mijëvjeçarit IV p.e.s, njerëzit që merreshin me zejtari kishin vënë re se metalet mund të shkriheshin dhe mund t'u ndryshohej forma, për prodhimin e mjeteve të ndryshme të punës,

armëve etj. Fillimisht përdorej bakri, dhe më pas, bashkimi i bakrit me kallajin solli përdorimin e bronzit, si material më i fortë e i qëndrueshëm. *( P. Stutz. Frederick, The World Economy: 344)*

Me krijimin e qyteteve dhe fuqizimin ekonomik të tyre, lindi nevoja e mbrojtjes, nëpërmjet rrethimit të tyre me mure dhe krijimit të një ushtrie. Në fillimin e periudhës së bronzit, përqendrimi i një numri të madh njerëzish në luginat e lumenjve në Mesopotami dhe Egjipt solli një model të ri të jetës njerëzore, lindjen e qytetërimit dhe qyteteve. Qytetërimi është një kulturë komplekse, në të cilën një numër i madh njerëzish ndajnë elemente jetësore të përbashkëta me njëri-tjetrin. Historianët kanë përcaktuar disa elemente kryesore të qytetërimit, të dukshme në qytetërimin mesopotam dhe egjiptian, të cilat janë:

- ✓ evolucion urban e kthimi i qyteteve në vatrën kryesore të zhvillimit politik, ekonomik, social, kulturor dhe fetar;
- ✓ një strukturë e dukshme fetare ku "Zotat" ishin vendimtarë në suksesin e komunitetit dhe klasa e priftërinjve apo shërbyesve fetarë, si zëdhënës të tyre, rregullonin marrëdhëniet e njerëzve me Zotat;
- ✓ strukturë e re ushtarake-politike;
- ✓ lindja e një qeverie burokratike të organizuar për kërkesat administrative të popullsisë në rritje, kurse ushtritë u organizuan për të fituar tokë dhe fuqi dominimi i një strukture të re sociale të bazuar në fuqinë ekonomike;
- ✓ mbretërit, shërbyesit në tempujt fetarë, drejtuesit politikë dhe luftëtarët, njerëzit e lirë (fermerë, artizanë, zejtarë), e në fund të strukturës sociale ishin skllevërit.
- ✓ zhvillimi i të shkruarit, të cilin strukturat e mësipërme e përdornin për të mbajtur shënime mbi organizimin dhe prodhimin;

- ✓ forma të reja të aktiviteteve të rëndësishme artistike dhe intelektuale, si: objekte monumentale arkitektonike, zakonisht me funksion fetar, zinin një vend të rëndësishëm të ambientit urban. (Cerda, 1867)

*Cilat ishin arsyet që çuan në formimin e qyteteve?* Kjo është e vështirë për t'u përcaktuar, sepse pati forma të pavarura qytetërimi, që u zhvilluan diku më shumë e diku më pak, në Mesopotami, Egjipt, Indi, Greqi, Kinë etj. Megjithatë ekzistojnë disa hipoteza:

1. Teprica e prodhimit lind nga përdorimi i një sistemi ujitës të organizuar, dhe për të krijuar një sistem ujitjeje efiçent duhet një burokraci komplekse. Kjo është njëra prej teorive për krijimin e qyteteve.

2. Një hipotezë tjetër, e botuar nga Jane Jacobs në librin e saj "*The economy of cities-1969*" shpjegon se qytetet mund të jenë zhvilluar si vende nyje tregtare (pazare) të prodhimit. Intensifikimi i bujqësisë ushqente vetë tregtinë e qytetin. Problemi me këtë hipotezë është se jo të gjitha qytetet antike kishin një pazar apo treg, e kjo ka të bëjë me vendndodhjen e tyre në kryqëzimin e rrugëve me distancën që i ndante nga qytetet e tjera.

3. Mendimi se mund të jenë krijuar si nevojë për mbrojtjen e një grupi banesash mund të jetë gjithashtu i drejtë, por lind pyetja: Pse atëherë nuk kanë qenë krijuar më parë, në periudhën paraurbane, kur kishte gjithashtu nevojë për mbrojtje?

4. Mendimi i krijimit të qyteteve si qendra kulti ekziston gjithashtu.

Në përfundim të gjithë këtyre mendimeve, mund të themi se nuk ka vetëm një arsye për krijimin e qyteteve. Në bazë të kushteve para krijimit të tyre, mund të flitet për një nga këto arsye apo për një lidhje të disave prej tyre. (Friedmann, 1986)

### 2.3. Urbanizimi global dhe rritja ekonomike

Urbanizimi nuk është një fenomen modern; ai ka ndodhur që në 5.000 B.C. (Sjöberg, 1960). Niveli i urbanizimit matet me përqindjen e popullsisë urbane, të popullsisë së përgjithshme dhe sa është rritur gjatë viteve. Pas Luftës së Dytë Botërore, urbanizimi u zhvillua me shpejtësi rreth e rrotull globit.

Nivelet e urbanizimit kanë qenë të larta në vendet e zhvilluara, si në Evropë, Amerikën e Veriut dhe Oqeani, ku më shumë se 50% e popullsisë jetojnë në zonat urbane (Kombet e Bashkuara, 2002). Një nivel relativisht i lartë i urbanizimit ka qenë gjithashtu në Amerikën Latine dhe rajonin e Karaibeve, me më shumë se 40% e popullsisë jetojnë në zonat urbane. Afrika dhe Azia ishin më pak të urbanizuara; në vitin 2000, rreth 40% e popullsisë së Afrikës dhe Azisë jetuan në zonat urbane**.** Në Shqipëri shohim që lëvizjet drejt qytetit të Tiranës ndër vite kanë qenë në shifra të larta.

Periudha e parë e urbanizimit karakterizohet nga rritja graduale e popullsisë urbane. Popullsia totale që jeton në zonat urbane, vërejmë një rritje të saj deri në periudhën e vitit 2050 që parashikohet.

Në këtë periudhë të urbanistikës u shfaqën edhe fenomene negative, si zënia e tokave të lira me ndërtime të pakontrolluara. Nga viti 1945 deri në 1990-ën, urbanizimi në Shqipëri ishte në një kontroll të rreptë nga shteti.

Në mënyrë që të ndërtohej një shoqëri socialiste moderne dhe e industrializuar, deri në vitin 1960 udhëheqja e partisë inkurajonte zhvillimin e industrisë dhe sektorit të ndërtimit.

Kjo politikë çoi në rritjen e shpejtë të popullsisë urbane. Ndërmjet viteve 1950-1955 vendi regjistroi një rritje vjetore të habitshme, me 7 për qind të popullsisë urbane. Megjithatë, nga viti 1961 deri në vitin 1990, qeveria ndërroi politikën dhe filloi të kufizonte me forcë urbanizimin. Zhvillimi i qyteteve të vogla u kthye në prioritet dhe qytetet e mëdha u detyruan të zhvilloheshin brenda "vijave të verdha" – kufijtë e qyteteve të vendosura sipas masterplaneve.

Ky kufizim në urbanizim ishte pjesërisht për shkak se banorët e zonave urbane gëzonin mirëqenie më të madhe (për shembull, strehim dhe shërbime shëndetësore) sesa banorët e zonave rurale *(Burimi: të ndryshme, përfshi KB (2002), Situata e Sektorit të Strehimit).*

Trazirat e para politike, pasiguria sociale dhe rënia ekonomike nga viti 1990 deri në 1992-shin nxitën një valë të madhe emigracioni ndërkombëtar. Periudha midis viteve 1993–1996 pa rikthimin e stabilitetit politik, rritjes ekonomike dhe rënies së papunësisë. Pavarësisht nga kjo, migracioni ndërkombëtar vazhdoi të rritej së tepërmi, kryesisht si pasojë e pagave të ulëta dhe diferencimit të pasurisë.

Grafiku 3.6**:** Zhvendosjet e pjesëve të popullsisë urbane dhe rurale, 1945-2001




*Burimi: (Vlerësimi i sektorit urban në Shqipëri, 2007)*

Nga viti 1989 deri në 2001-shin, pjesa e popullsisë urbane u rrit, nga 35, në 42 për qind. Për shkak se popullsia totale ishte në rënie përgjatë dekadës, kjo për shkak të emigracionit përfundimtar, rritja e numrit të banorëve në zonat urbane (rreth 1 për qind në vit) nuk ishte aq i madh sa pritej të ishte nga rritja e shkallës së urbanizimit. Shqipëria mbetet një nga vendet më pak të urbanizuara në rajonin e EAQ, ku një mesatare prej 63 për qind e popullsisë është urbane.

Gjatë viteve të fundit vendi ynë ka bërë një përparim domethënës në tranzicionin e tij, nga një ekonomi e ngurtë me planifikim qendror, në një ekonomi me bazë tregu. Tranzicioni ekonomik dhe social është shoqëruar me një rritje të urbanizimit, nga 36 për qind në vitin 1990, në 44 për qind në vitin 2003.

Shqipëria është dalluar si një nga ekonomitë në tranzicion me rritjen më të shpejtë, me një rritje mesatare reale të PBB-së 7.5 për qind në periudhën 1998-2004 (FMN, 2006). Kjo rritje domethënëse është ushqyer nga dërgesat e parave nga emigrantët, të cilat, sipas Bankës së Shqipërisë, janë vlerësuar në 2004-ën në 1 miliard USD, ose 13.5 për qind e PBB-së (Hernandez-Coss et al, 2006). Performanca e lartë ekonomike dhe dërgesat nga emigrantët, së bashku me

nivelin e ulët të pabarazisë në të ardhura, kanë kontribuar, gjatë këtyre viteve, në reduktimin e nivelit të varfërisë më tepër se në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

- Faktorët që ndikuan në zhvillimin urban ishin:

  - rritja e popullsisë;

  - migrimi rural;

  - migrimi urban.

### 3.2. 100 vjet Ekonomi Shqiptare

Në periudhën 1912-1920 Shqipëria ndodhej në një gjendje ekonomiko-shoqërore mjaft të prapambetur. Mjaft shqiptarë gjendeshin jashtë kufijve të Shqipërisë. Nisur nga ata që ishin të regjistruar, në vitet 1923, popullata e vendit qe 817 mijë vetë. Popullata u rrit në 1 milion e 30 mijë në vitin 1930 dhe mbeti në vend deri në vitin 1938, ku në vend u regjistruan 1 milion e 45 mijë vetë. Transporti rrugor ishte pak i zhvilluar, dhe kjo krijonte tepër mangësi në lidhje me vendet e tjera për këmbimet ekonomike dhe tregtare.

Lufta e Parë Botërore ndikoi ndjeshëm në vazhdimësinë e kësaj situate deri në fillim të viteve ‘20 të shekullit XX. Për herë të parë Shqipëria pati një institucion të Bankës Qendrore në vitin 1913. Në vitin 1925 ajo filloi veprimtarinë e saj me emrin “Banka Kombëtare e Shqipërisë”. Në vitin 1926 u bë dhe qarkullimi i monedhës së parë kombëtare shqiptare. Si njësi monetare tregtare u caktua frangu ar. Monedha jonë kishte nënfishat e saj (leku, qindarka 1 franga dhe frangu ar).

Banka Kombëtare e Shqipërisë gjatë kësaj kohe zbatoi standardin e arit, që nënkuptonte që kartëmonedhat kthehen në ar dhe në valuta të huaja të forta: në dollar, në lira, në sterlina etj.

Periudha pas 20 viteve evidentoi një gjallërim të dukshëm, edhe pse me ritme të ngadalta. Numri i ndërmarrjeve industriale pati rritje; në vitin 1912 ishte 34 dhe në vitin 1922 arriti në 85.

U konstatua në këtë periudhë edhe një rritje e interesit të kapitalit të huaj për ekonominë dhe burimet natyrore shqiptare, sidomos për naftën, bitumin, hekurin, bakrin, pyjet etj. Filloi pjesëmarrja e shumë kompanive të huaja në tregun tonë gjatë asaj kohe, si angleze, franceze dhe amerikane.

Si në shumë vende, edhe Shqipëria i ndjeu pasojat e krizës së përgjithshme ekonomike të viteve 1929-1933. Shenjat e para u shfaqën në sistemin monetar dhe në financat e vendit. Kriza preku ndjeshëm edhe sistemin e kreditit; në këtë kohë u morën hua edhe shumë kredi nga vendet perëndimore. Kriza e viteve 1930-1944 dallohet në shumë drejtime: përqindja e popullatës që jetonte me punë jobujqësore u reduktua, nga 15.9 për qind në vitin 1930, në 15.4 për qind në 1938-ën; eksportet shqiptare u rritën, nga 2 milionë franga ar, në 12 milionë mes viteve 1923 dhe vitit 1931, por në vitet e mëpasshme pati rënie. Periudha 1936-1939 shënoi një lloj faze gjallërimi të ekonomisë shqiptare.

Kemi shtim në numrin e ndërmarrjeve. Në vitin 1944 numri i tyre arriti në 430, nga vetëm 244 në vitin 1938 dhe vetëm 71 të tilla në vitin 1922, ndërkohë që edhe numri i punëtorëve u rrit, nga 500 në vitin 1922, në 7.435 në vitin 1938. Në këtë kohë Shqipëria kishte marrëdhënie tregtare e ekonomike me 21 vende të botës. Përmirësime pati infrastruktura e vendit, kryesisht sistemi i rrugëve dhe i urave, duke bërë që në vitin 1938 Shqipëria të kishte një rrjet rrugor nacional prej 2.224 km dhe një rrjet lokal prej 767 kilometrash *(Civici, Shteti apo Tregu, fq. 303-306).*

*3.2.1. Ekonomia shqiptare gjatë regjimit komunist (1945-1990) dhe përpjekjet për industrializimin e vendit.*

Në periudhën 1945-1946, qeveria e parë komuniste shqiptare ndërmori gjatë disa fazave, një reformë agrare radikale, për shpronësimin e pronarëve të mëdhenj e të mesëm të tokave, përfshirë këtu edhe tokat në pronësi shtetërore, të kapitalit të huaj apo edhe ato në pronësi të institucioneve fetare, dhe në shpërndarjen e tyre në favor të fshatarëve të varfër e pa tokë.

Gjatë asaj kohe u shpall nga Partia Komuniste platforma bazë dhe afatgjatë për bujqësinë, duke theksuar nevojën e transformimit socialist të bujqësisë në kolektivizimin e prodhuesve të vegjël dhe krijimin e fermave të mëdha shtetërore.

Kolektivizimi i bujqësisë duhej të shërbente edhe për të aplikuar teorinë e planifikimit të centralizuar në bujqësi, e cila ishte e papërputhshme me strukturën e prodhuesve të vegjël privatë e individualë. Kooperativat zinin 75.8 për qind të tokave bujqësore, fermat shtetërore 20.7 për qind të tyre dhe kopshtet individuale vetëm 3.5 për qind.

Ky proces përfundoi në vitin 1976, kur nuk kishte më asnjë fermë individuale private. Në vend që në tregun shqiptar të lëvrinte nisma e qindra-mijëra pronarëve për ta shtyrë ekonominë, pra prodhimin përpara, tani për ta shtyrë atë që të zhvillohej mendonte vetëm shteti.

Në vitin 1949, ligji parashikonte që çdo familje fshatare mund të zotëronte 3.000-12.000 m2 tokë; në 1967-ën kjo sipërfaqe u kufizua në vetëm 1.000 m2 dhe në një numër të kufizuar bagëtish; në 1979-ën u limitua në vetëm 300 m2 dhe në një tufë modeste pulash etj., ndërkohë që në vitin 1981 u ndalua çdo metër katror tokë private dhe çdo lopë, pulë etj. G. Jandot (1994), që e ka studiuar gjerësisht këtë fenomen, jep shpjegimin se:

*“Thelbi i dështimit qëndron te reduktimi apo eliminimi total i parcelave private me të cilat ushqeheshin familjet fshatare, që përbënin mbi 65-70 për qind të popullsisë shqiptare... Zvogëlimi i këtyre parcelave drejt zhdukjes së tyre, në fakt zhduku mbi 50 për qind të prodhimeve bujqësore e ushqimore, ndërkohë që prodhimi kolektiv nuk e mbushi dot kurrë këtë boshllëk. Fshatarët, nga prodhues dhe shitës të produkteve bujqësore e blegtorale, u bënë thjesht kërkues e konsumatorë të tyre.”*

*(Civici, Shteti apo Tregu: 309-311)*

Pas ardhjes në pushtet në nëntor 1944, PKSH-ja deklaroi si objektiv primar transformimin e Shqipërisë, nga një vend agrar gjysmëfeudal (1945), në një vend agraro-industrial (1955), për të kaluar më vonë drejt stadit industrialo-agrar, i cili pritej të konsolidohej në vitet 1980-1990.

Sipas kësaj skeme, prioritet do t’i jepej industrisë në raport me bujqësinë, që konsiderohej si dega bazë e ekonomisë. Brenda ekonomisë, prioritet do të kishte industria e rëndë, që përbënte thelbin dhe ambicien kryesore të politikës së “industrializmit socialist” të vendit.

Rezultatet e para ishin inkurajuese, dhe brenda periudhës 1950-1960, industria vendase arriti të katërfishojë prodhimin e para Luftës së Dytë Botërore. U zhvilluan nxjerrja e naftës, industria tekstile e ajo ushqimore dhe u rikonstruktua një pjesë e madhe e rrugëve, urave etj. *(Civici, Shteti apo Tregu, fq. 311-312)*

Në Kongresin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, të mbajtur në Tiranë më 8-22 nëntor 1948, administrata e Hoxhës ndërmori hapat e parë të sigurt drejt një ekonomie të planifikuar të tipit sovjetik. Si detyrë themelore u përcaktua zhvillimi i shpejtë i industrisë dhe bujqësisë dhe u parashtruan objektivat specifikë që duheshin arritur. Ky plan dyvjeçar propozonte zhvillime specifike në nxjerrjen dhe përpunimin e naftës, qymyrit, bakrit dhe kromit, në zhvillimin e bujqësisë dhe në rritjen e nivelit të jetës kulturore të popullit.

Programi i përgjithshëm do të ishte thellësisht i centralizuar, autoritar, i ngurtë, pra me të vërtetë një “ekonomi e komanduar”. Ajo funksiononte në këtë mënyrë:

*Së pari,* Komisioni i Planit të Shtetit parashikonte për pesëvjeçarin e ardhshëm zhvillimin e nevojshëm të degëve të ndryshme, si: industria (që do të ishte gjithnjë parësore), bujqësia, transporti, telekomunikacionet, ndërtimi, mirëqenia e punonjësve, arsimi, mjekësia, kultura, dhe shumë e shumë të tjera.

*Së dyti,* plani i "projektdirektivave" paraqitej në Plenumin e Komunitetit Qendror të Partisë për studim, për ndryshime të mundshme dhe për miratim. (*Jacques, Shqiptarët, fq. 511-512)*

### 3.3. Planet pesëvjeçare (1951-1985)

Kongresi miratoi projektdirektivat për pesëvjeçarin 1951-1955. Aty u mor vendimi për një program të përshpejtuar të zhvillimit industrial-bujqësor, në mënyrë që Shqipëria të kalonte, nga një ekonomi agrare e prapambetur, në një ekonomi agrare-industriale si ajo e vendeve më të zhvilluara komuniste të Evropës.

Midis Tiranës e Moskës do të kishte fërkime të shpeshta, ashtu si dikur me Beogradin, sa i përket raportit të duhur në bujqësi dhe industri.

*Industria* zinte vendin e parë, pasi në këtë drejtim programi kombëtar caktoi 52 për qind të shpenzimeve të përgjithshme shtetërore. Përparësi iu dha grupit të prodhimeve të mjeteve të prodhimit, ndërsa si rëndësi e dorës së dytë u konsiderua prodhimi i sendeve të konsumit. Disa projekte nuk mundën të realizoheshin brenda afatit të caktuar.

*Bujqësia.* Vetëm 12 për qind e fondeve shtetërore të pesëvjeçarit u caktuan për bujqësinë, pavarësisht nga nevoja urgjente për rritjen e prodhimit të sendeve ushqimore, - më pak se 1/4 e shumës së caktuar për zhvillimin e industrisë. Rritja e prodhimit të drithërave të bukës u cilësua si përparësi kryesore, pasi çdo vit, nga BRSS dhe Evropa Lindore importoheshin 50.000 deri në 60.000 tonë. Deri në vitin 1955, rreth 87% e prodhimit bujqësor vinte nga fermat private të fshatarëve, kurse 13% nga kooperativat e sapokrijuara. (*Jacques, Shqiptarët, fq. 513-514)*

*Plani i dytë pesëvjeçar (1956-1960)*

Objektivat kryesorë ishin: zhvillimi i shpejtë i bujqësisë "përmes riorganizimit socialist të prodhimit bujqësor", zhvillimi i industrisë, veçanërisht i minierave, dhe rritja e nivelit kulturor të popullit. Ndihma ekonomike kishte ardhur nga sovjetikët: 18.5 milionë dollarë kredi më 1 janar 1957, 10.5 milionë dollarë të borxhit u falën më 17 prill 1957, në gjysmën e parë të vitit 1958 u premtuan 7.75 milionë kredi për grurin, ndërsa më 22 nëntor 1957 u dha një kredi tjetër prej 40 milionë dollarësh.

*Industria,* zhvillimi industrial, zinte vend kryesor në planet e qeverisë dhe thithte mbi 51 për qind të investimeve të përgjithshme kombëtare. Gjatë kësaj kohe u zhvilluan një sërë projektesh strategjike, si hidrocentrali gjigant "Karl Marks" mbi lumin Mat, rafineria e naftës në Cërrik dhe naftësjellësi që lidhej me Kuçovën, Fabrika e Qelqit në Tiranë, fabrika e konservave të peshkut dhe e perimeve në Vlorë, tri fabrika të mëdha cigaresh. Planifikuesit shpallën se, prodhimi industrial i cili në vitin 1955 ishte plotësuar për 12 muaj, në vitin 1960 ishte realizuar në më pak se gjashtë muaj.

Për herë të parë, vlera e prodhimit industrial e tejkaloi atë të prodhimit bujqësor, duke u rritur, nga 6.9 për qind në vitin 1938, në 55 për qind në vitin 1960. Gjatë kësaj periudhe u përfunduan edhe ndërtesa të tilla si Pallati i Sporteve në Tiranë, përveç stadiumeve, hoteleve turistike, spitaleve, teatrove dhe kinemave në qytete dhe fshatra. Gjithashtu u ngritën ujësjellës dhe 12.000 apartamente. Të ardhurat nga bujqësia dhe industria u rritën 49 për qind.

Në vitin 1959 qeveria e përshpejtoi shkrirjen e kooperativave të vogla në kolektiva të mëdha, duke i paguar fshatarët jo për ditët e punës së kryer, po për realizimin e normave të punës. Fshatarëve gjatë kësaj periudhe iu mor 87 për qind e tokës, e cila iu dha popullit. Në pronësi

private mbeti vetëm rreth 13 për qind e tokës, kryesisht në zonat malore. Toka e punueshme u rrit 18 për qind, numri i traktorëve u trefishua në 4.100.

Edhe pse në vitin 1959 u raportua një prodhim gruri prej 102.000 tonësh, qeverisë iu desh të importonte mbi 94.000 tonë grurë nga BRSS. Përqindja e punonjësve në industri gati u trefishua, nga 11 për qind në vitin 1950, në 29 për qind në vitin 1960, kurse numri i punëtorëve në bujqësi ra, nga 74 për qind në 58 për qind. Përqindja e të ardhurave kombëtare nga industria gjatë kësaj periudhe u dyfishua, nga 23.7 për qind, në 55.6 për qind, kurse të ardhurat nga bujqësia ranë, nga 76.3 për qind, në 44.4 për qind. Tirana zuri të anonte gjithnjë e më shumë nga Pekini, dhe në tetor 1960 Tirana dhe Pekini nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit në fushat tekniko-shkencore, në bujqësi dhe në industrinë e lehtë. *(Jacques, Shqiptarët, fq. 516-520)*

*Plani i tretë pesëvjeçar (1961-1965)*

Në vitin 1960 industria kontribuonte më shumë se 50 për qind në PBB-në e vendit. Aleatët kinezë kishin dhënë ndihma për zhvillim: një ndihmë prej 2.5 milionë dollarësh dhe një hua prej 12.5 milionë dollarësh në vitin 1954, si dhe një tjetër hua prej 13.75 milionë dollarësh në vitin 1959. Kina pranoi të jepte një hua rreth 125 milionë dollarësh në vitin 1961 për përfundimin e rreth 25 projekteve industriale, të braktisura nga sovjetikët.

*Industria.* Gjatë kësaj periudhe përfunduan një sërë projektesh të rëndësishme industriale: fabrika gjigante e çelikut në Elbasan, uzina për përpunimin elektrolitik të bakrit në Rubik, fabrika e sodës kaustike në Vlorë, disa fabrika letre, uzina e makinave bujqësore në Durrës, shkolla, spitale, maternitete, qendra pushimi e qendra kulturore. Eksportet shqiptare në BRSS ranë në zero, pasi tani u drejtuan të tëra nga Kina.

*Bujqësia*. Bujqësia kishte më pak përparësi se industria. Për bujqësinë u caktuan vetëm 15 për qind të fondeve, kurse për industrinë 49 për qind. Në zona të ndryshme të vendit u ndërmorën

katër projekte për hapjen e tokave të reja, duke rritur sipërfaqen e tokës bujqësore. Prodhimi ushqimor u rrit rreth 51 për qind mbi nivelin e mëparshëm. Gjatë këtyre viteve, tonazhi i grurit dhe i misrit të importuar nga Kina arriti 14.900 tonë në vitin 1961, 89.000 tonë në vitin 1962 dhe 130.000 tonë në vitet 1963 dhe 1964. Ekspertët e bujqësisë u përpoqën ta rrisnin prodhimin në dy drejtime, bujqësi ekstensive, duke rritur sipërfaqen e punueshme, si dhe bujqësi intensive, duke rritur prodhimin. (*Jacques, Shqiptarët, fq. 523-525).*

*Plani i katërt pesëvjeçar (1966-1970)*

Në vitet 1960-1975, rreth 60-70 për qind e tregtisë së jashtme shqiptare zhvillohej vetëm me Kinën dhe prishja përfundimtare e tyre në vitin 1978, në vend që të stimulonte kërkimin e partnerëve të tyre të vendit, u transformua në një autarki totale.

Edhe këtë radhë partneriteti stalinist ndihmoi në mbështetjen e pesëvjeçarit të ardhshëm, me një hua prej 214 milionë dollarësh amerikanë në qershor 1964. Në vitin 1968 u dha një ndihmë tjetër, me një sasi të paspecifikuar, ndonëse të dhënat ishin për një sasi më të madhe se 123 milionë dollarët e marrë në vitin 1961.

Kina e shpëtoi situatën me një “hua” prej 130 milionë dollarësh, të destinuar për përpunimin e mineralit të bakrit, kromit dhe hekur-nikelit, si dhe për nxjerrjen e naftës dhe të qymyrit, me qëllim që të arrihej pavarësia ekonomike.

Gjatë këtij pesëvjeçari u siguruan pajisjet për furnizimin e 1759 fshatrave me energji elektrike. Kjo kërkoi mbi 20.000 km tela dhe 300.000 shtylla. Në vitin 1970 përfundoi elektrifikimi i çdo qyteti dhe fshati në Shqipëri. Zgjerimi i rrugëve automobilistike, i rrjetit telefonik dhe i energjisë elektrike në të gjitha fshatrat dha një ndihmesë të madhe në përmirësimin e çdo faze të kulturës e të jetës fshatare dhe e ndihmoi pa masë regjimin për sheshimin e dallimeve themelore midis qytetit e fshatit.

Në Shqipëri kishte rreth 5.000 km rrugë të asfaltuara dhe me zhavorr. Hekurudha e parë shqiptare u lidh me Tiranën më 16 nëntor 1968. Nga fundi i vitit 1970 kishte rreth 220 km linjë hekurudhore, që shtrihej në drejtim verior nga Durrësi në Shkodër dhe në jug në drejtim të Elbasanit. Pallati madhështor i Kulturës, që kishte nisur gjashtë vjet më parë, u përurua më 17 nëntor 1966 si qendër kulturore e kryeqytetit. Tërmetet e nëntorit dhe të dhjetorit 1967 shkatërruan 3.500 shtëpi, kurse tërmeti i prillit 1969 rreth 6.500 ndërtesa, të cilat kërkonin riparim të menjëhershëm.

Pasojat sociale të këtyre fatkeqësive kërkuan nga qeveria ndërtimin e 73.000 apartamenteve dhe të 1.600 shtëpive të reja, si dhe riparimin e 11.000 të tjerave në një kohë rekord.

*Bujqësia.* Tashmë e gjithë toka ishte vënë nën kontrollin e shtetit. Për këtë fushë u caktuan pak më shumë fonde nga investimet shtetërore. 16 për qind në vend të 15 për qind, dhe më pak për industrinë: 46.6 për qind, në vend të 49 për qind. Programi për hapjen e tokave kishte mbetur prapa objektivave të caktuar. Gjatë këtij pesëvjeçari pati një rritje të prodhimit të sendeve ushqimore, prapambetje u pa në prodhimin e orizit, pambukut dhe duhanit.

(*Jacques, Shqiptarët, fq. 525-528)*

*Plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975)*

Gjatë kësaj kohe pati edhe një ngjarje ndërkombëtare, pasi në vitin 1972, kryetari Mao priti presidentin amerikan Riçard Nikson për një vizitë në Pekin. Mbrojtja e përbashkët kundër Bashkimit Sovjetik dhe nevoja e Kinës për teknologji moderne ishin arsyet që çuan në zgjerimin e marrëdhënieve miqësore me botën perëndimore.

*Industria.* Edhe këtë pesëvjeçar pjesën më të madhe të investimeve shtetërore do ta kishte industria, rreth 65.7 për qind, ndërkohë që bujqësisë iu dha vetëm 1/6 e kësaj sasie. Zhvillimi industrial ishte i kënaqshëm. Hidrocentrali i Vaut të Dejës mbi lumin Drin, me 225.000 kw,

përfundoi në vitin 1971. Një hidrocentral i dytë më i madh, me 500.000 kw dhe me digën më të lartë të llojit të vet në Evropë, u ndërtua mbi lumin Drin në Fierzë, afër Pukës, dhe u quajt “Drita e Partisë”.

Eksportimi i energjisë elektrike nisi të sillte të ardhura në vitin 1972. Një projekt i dytë i madh, që ndodhej në fazën e përfundimit, ishte kombinati metalurgjik në Elbasan, i quajtur “Çeliku i Partisë”, i cili prodhoi çelik për herë të parë në vitin 1975. Projekti i tretë ishte rafineria e naftës në Ballsh, me një kapacitet prej një milion tonësh në vit. Kjo do të mundësonte zhvillimin e një industrie petrokimike, që do të plotësonte nevojat shqiptare dhe do të punonte gjithashtu për eksport.

U shënuan edhe zhvillime të tjera, si: kombinati i tekstileve në Berat, laboratori i fizikës bërthamore, i dhuruar nga Kina në vitin 1970 për universitetin shtetëror, qendra e parë e kompjuterizuar elektronike, stacioni i parë televiziv në vitin 1971, kurse në vitin 1973 i të gjithë vendit në rrjetin kombëtar telefonik. Gjithashtu u shpejtua puna për lidhjen e të gjitha fshatrave me rrugë të mira dhe me ujë të pijshëm. Përparime u bënë në zgjerimin e hekurudhës, nga Elbasani, në minierat e hekur-nikelit në Përrenjas.

Objektivi i prodhimit industrial për vitin 1973, që ishte caktuar 61 për qind më i lartë se ai i vitit 1970, nuk u arrit. Megjithatë pati një rritje prej 52 për qind. Gjatë tridhjetë vjetëve të Çlirimit, prodhimi i naftës bruto u rrit 72 herë, i mineraleve 106 herë, prodhimi i makinerive 235 herë, i materialeve të ndërtimit 153 herë, i industrisë ushqimore 56 herë, i industrisë së lehtë 65 herë, e kështu me radhë. Me rritjen e zhvillimit industrial, Shqipëria ishte në gjendje të përpunonte më shumë lëndë të para për eksport, të cilat përbënin një të tretën e eksporteve në vitin 1950 dhe dy të tretat në vitin 1973.

*Bujqësia.* Gjatë këtij pesëvjeçari bujqësia çaloi. Ajo mori përqindjen më të vogël të fondeve, vetëm 11.7 për qind, kurse përqindja më e lartë i kaloi industrisë, me 65.7 për qind. Në vitin 1973, rreth 56 për qind e tokës bujqësore u përfshi në sistemin e ujitjes. Përparësi kishin bimët industriale të tilla si: pambuku, panxhari i sheqerit, duhani, luledielli për përdorim të brendshëm në drithërat e bukës. Gjatë këtij pesëvjeçari objektivat nuk u realizuan: pati vetëm 33 për qind rritje, në vend të 65 për qind që ishte parashikuar. (*Jacques, Shqiptarët, fq. 533-537)*

*Plani i gjashtë pesëvjeçar (1976-1980)*

Objektivat bujqësorë që miratoi Kongresi për pesëvjeçarin e gjashtë ishin më të ulët, por më realistë. U parashikua një rritje prej 38 për qind, në vend të 65 për qind të pesëvjeçarit të mëparshëm, që nuk u arrit kurrë. Nga investimet shtetërore për bujqësinë u caktuan 11.7 për qind e fondeve, kurse si gjithmonë, fondet për industrinë ishin gjashtë herë më shumë.

Në aspektin demografik, popullsia e Shqipërisë u rrit, nga 1.000.000, sipas statistikave të vitit 1945, në 2.594.600 në janar 1979. Popullsia ishte fare e re, pasi mosha mesatare llogaritej 19 vjeç; 42 për qind ishin nën 15 vjeç, 37 për qind midis 15 e 39 vjeç, 16 për qind midis 40 dhe 64 vjeç, dhe vetëm 5 për qind mbi 65 vjeç.

Që prej vitit 1976 u adoptuan tri kufizime: u ndalua çdo lloj kredie dhe borxhi nga jashtë, në mbështetje të nenit 28 të Kushtetutës së vendit, me përjashtim të atyre që konsideroheshin absolutisht të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe nevojat sociale. Sistemi bankar gjatë socializmit ishte një sistem i centralizuar plotësisht dhe deri në vitin 1976 përbëhej nga një bankë e vetme, Banka e Shtetit Shqiptar. Në vitin 1977 u krijua Banka Bujqësore, si një bankë e veçantë nëpërmjet shkëputjes së një seksioni të Bankës së Shtetit Shqiptar, që mbulonte ofertën për fonde të sektorit bujqësor.

*Industria.* Tri projekte gjigante, në Fierzë, Elbasan dhe Ballsh, nuk u përfunduan në vitin 1975. Kombinati metalurgjik në Elbasan "Çeliku i Partisë" nisi prodhimin e çelikut në vitin 1976, kurse në vitin 1980 ai punonte me kapacitet të plotë për përpunimin e mineraleve dhe prodhimin e shufrave të çelikut, me mbi 60 forma e dimensione të ndryshme dhe me një kapacitet vjetor prej 800.000 tonësh çelik. Hidrocentrali i Fierzës "Drita e Partisë" mbi lumin Drin, ishte më i madhi në Shqipëri në atë kohë. Diga e tij, rreth 180 metra e lartë, formonte një liqen artificial rreth 70 km të gjatë, i cili kërkoi zhvendosjen dhe rindërtimin e qytetit të bukur të Kukësit e të 28 fshatrave. Prodhimi i energjisë elektrike u trefishua, me futjen në punë të hidrocentralit në dhjetor të 1980.

Gjatë këtij pesëvjeçari nxjerrja e qymyrgurit u rrit me 63 për qind. Përparime pati gjithashtu në nxjerrjen dhe përpunimin e kromit, bakrit, lëndëve kimike, materialeve të ndërtimit, letrës dhe drurit. Shqipëria tani u bë vendi i tretë prodhues i kromit në botë, pas Bashkimit Sovjetik dhe Afrikës së Jugut. Në vitin 1950, punonjësit e industrisë përfaqësonin 11.2 për qind të popullsisë, kurse në vitin 1976 kjo shifër u rrit në 36.2 për qind. Prodhimi industrial u orientua në drejtim të eksporteve të kromit, hekur-nikelit, bakrit, naftës dhe energjisë elektrike. Rruga e vetme për plotësimin e nevojave të brendshme ishte importi.

*Industria.* Prodhimi bujqësor ishte 21.4 për qind më i lartë se në fillim të tij. Drejtuesit e planit vazhduan përqendrimin te bujqësia intensive dhe bujqësia ekstensive. U ushtrua një trysni e madhe për transformimin e kooperativave bujqësore nga pronësia e grupit në pronësi të mbarë popullit, në mënyrë që të zhdukeshin dallimet midis fshatarësisë dhe klasës punëtore. *(Jacques, Shqiptarët: 544-547).*

Por vitet '80, ashtu si edhe në shumë vende të tjera lindore me ekonomi socialiste, regjistruan dhe fillimin e rënies me shpejtësi të niveleve të rritjes ekonomike. Rritja ekonomike vjetore që

arrinte mesatarisht në 5-6 për qind në vitet 1970-1980, ra në 1 për qind në dhjetëvjeçarin 1980-1990. Ekuilibrat makroekonomikë ishin tronditur rëndë edhe si pasojë e subvencioneve gjithnjë e më të mëdha, që përpiqeshin të mbulonin mungesën e efiçencës së sektorit publik; deficiti buxhetor kishte arritur nivele të larta të papërballueshme: 5.9 për qind në vitin 1988, 9.5 për qind në vitin 1989 dhe 16.6 për qind në 1990-ën. *(Civici, Shteti apo Tregu: 314)*

*Plani i shtatë pesëvjeçar (1981-1985)*

Për herë të parë po planifikohej një plan pesëvjeçar, për të cilin nuk do të kishin as ndihma e as kredi të huaja. *(Jacques, Shqiptarët: 553)*

*Industria.* Zuri vend qendror edhe gjatë pesëvjeçarit të shtatë. Hidrocentralit gjigant me 600.000 kw, që ishte në ndërtim e sipër, i vunë emrin "Enver Hoxha". Më 25 mars, njëra nga turbinat prej 80 tonësh, e importuar nga Franca, u instalua nga inxhinierët shqiptarë që do të përfundonin projektin. Kombinati i Çelikut në Elbasan u zgjerua, në mënyrë që të vinte në përdorim një furrnaltë të dytë e një linjë derdhjeje çeliku, të prodhonte tuba çeliku të madhësive të ndryshme, fletë çeliku të lehta e të rënda.

*Bujqësia.* Të dyja degët kryesore të ekonomisë konsideroheshin si shtylla ku mbështeteshin sukseset ekonomike. Bujqësisë iu caktuan vetëm 29 për qind e investimeve shtetërore. Shteti bëri investime të mëdha në kooperativat bujqësore, në mënyrë që të çonte në zvogëlimin gradual të pronës kooperativiste dhe të rriste pronësinë shtetërore derisa gjithçka të bëhej pronë e mbarë popullit. Prodhimi i drithërave të bukës u rrit në 267.000 tonë. Prodhimi i frutave u shtua jashtë mase; u mbollën rreth 200.000 rrënjë fiq afër Beratit, 300.000 rrënjë gështenja në Tropojë, 15.000 ha vreshta në Tiranë. *(Jacques, Shqiptarët: 556-558).*

### 3.4. Kriza totale e sistemit socialist

Ekonomia shfaqi shenjat e një krize totale gjatë viteve 1980-1990. Mallrat e konsumit të gjerë filluan të mungonin në masë, duke kaluar në sistemin e taloneve ushqimore për popullsinë, eksportet u ulën, ndërkohë që kërkesa për importe të nevojës së parë shtohej vazhdimisht. Disekuilibrat makroekonomikë u thelluan, deficiti buxhetor u rrit së tepërmi, duke arritur në 16.6 për qind të PBB-së, dhe rritja ekonomike modeste prej 1-2 për qind, e verifikuar në periudhën 1980-‘85, u bë negative gjatë viteve 85-‘90. Në fillim të vitit 1991, borxhi i jashtëm e kaloi masën e 30 për qind të PBB-së. Vendi ra në një krizë të thellë ekonomike e financiare.

Për të shpëtuar nga kjo situatë u pa e nevojshme vendosja e disa reformave pragmatike. Ato konsistonin në mundësinë e kooperativave bujqësore që të përcaktonin vetë disa kuota prodhimesh e çmimesh, futjen e disa mekanizmave të rinj të kërkesës dhe ofertës në treg, pranimin e disa investimeve të huaja që ndikojnë drejt në zhvillimin e ekonomisë dhe bujqësisë, të drejtën për të ndërtuar shtëpi private, krijimin e një buxheti të pavarur për 26 rrethet administrative të vendit etj. *(Civici, Shteti apo Tregu: 314-315)*

*Industria e Re.* Deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore zhvillimi industrial i Shqipërisë kishte qenë i papërfillshëm. Shumica e popullsisë, 87 për qind e saj, merrej me bujqësi, duke lënë vetëm 13 për qind për industrinë, tregtinë, transportin, bankat, arsimin, mjekësinë etj. Shqipëria duhej të mbështetej gjerësisht tek importi, i cili e zhyti në borxhe të mëdha. Hoxha mori një sërë masash për transformimin e vendit të prapambetur agrar në një vend “bujqësor-industrial” dhe pastaj në “industrial-bujqësor”. Si fillim, ai shpronësoi pa shpërblim të gjithë pronën private, shtetëzoi të gjithë industrinë, duke e vënë atë dhe çdo degë tjetër të ekonomisë nën pronësinë dhe kontrollin absolut të shtetit. Së dyti, ai vendosi kontrollin shtetëror të centralizuar mbi fondet dhe planin.

Gjatë çdo pesëvjeçari, mbi 50 për qind e investimeve të përgjithshme shkonte për zhvillimin e industrisë, veçanërisht të asaj të rëndë. Vendi mori pamjen e një kantieri të vërtetë ndërtimi. Me kalimin e viteve industria kontribuonte vetëm 7 për qind në të ardhurat kombëtare: në vitin 1960, 18.6 për qind, në vitin 1970, 28 për qind, kurse në vitin 1980, 44 për qind. Kjo rritje industriale përmirësoi mirëqenien materiale të popullsisë. Së treti, numri i madh i uzinave industriale, ishte shpërndarë racionalisht në të gjithë vendin mbi bazën e disa kritereve.

*Arritje të veçanta.* Numri i mineraleve me vlerë tregtare, nga gjashtë që ishte në fillim, u rrit në mbi 40. Shqipëria ishte vendi i tretë në botë pas Afrikës së Jugut dhe Bashkimit Sovjetik në nxjerrjen e mineralit të kromit. Ajo prodhonte një të tretën e bakrit botëror, kurse 80 për qind e telave të bakrit eksportohej. Kombinati metalurgjik në Elbasan, më i madhi dhe më moderni në Ballkan, ishte shndërruar në një qytet industrial me mbi 10.000 punëtorë. Risi e veçantë ishte sistemi hekurudhor bashkëkohor, i cili tashmë lidhte shumicën e qendrave industriale në vend.

*Bujqësia e re.* Deri në Luftën e Dytë Botërore shtatë familje të pasura zotëronin 3.7 për qind të tokës, familje të tjera të pasura, që përbënin 5 për qind të popullsisë, kishin 23 për qind, shteti zotëronte 13 për qind, kurse familjet fshatare kishin në pronësi 60 për qind të tokës. Pjesa tjetër kishin pak ose aspak tokë.

*Kolektivizimi.* Ashtu si me industrinë, edhe me bujqësinë Hoxha veproi duke e vënë atë nën kontrollin e plotë të shtetit.

Investimet e mëdha shtetërore për tharjen e kënetave dhe të moçaleve e zgjeruan sipërfaqen e tokës bujqësore. Ajo u rrit dy herë e gjysmë më shumë se ç'kishte qenë në Shqipërinë e paraluftës, ku rreth 50 për qind e kësaj rritjeje u përftua nga kanalizimi i ultësirave. Projekti më i

madh për rritjen e tokës bujqësore u realizua në fushën e Myzeqesë, përgjatë bregdetit Adriatik, duke përfituar rreth 116.000 ha tokë. Bujqësia e re kishte revolucionarizuar jetën në bujqësi.

Regjimi i Tiranës ia kishte përkushtuar sukseset bujqësore politikës së drejtë marksiste-leniniste. Në fushën e bujqësisë ishin derdhur rreth 29 për qind e investimeve shtetërore të pesëvjeçarit dhe prodhimi shënoi një rritje mesatare vjetore prej më shumë se 5 për qind. Kjo shifër ishte dy herë më e lartë se rritja e popullsisë dhe premtonte për një nivel më të lartë jetese. *(Jacques, Shqiptarët: 572-575)*

### 3.5. Reformat ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit dhe rritja ekonomike, përcaktimi i strategjisë më të mirë.

Ndryshimet politike të menjëhershme i hapën rrugën fillimit të transformimit të ekonomisë shqiptare, nga një ekonomi e centralizuar me planifikim qendror, drejt një ekonomie të hapur tregu të tipit perëndimor. Dy vitet e para, 1991-1992, përbëjnë periudhën më të vështirë të ekonomisë shqiptare të 50 viteve të fundit, gjatë së cilës, PBB-ja ra në 50 për qind, rritja ekonomike arriti një shifër negative rekord prej -13 për qind, çmimet e produkteve bazë u rritën 5-6 herë vetëm brenda vitit 1991, prodhimi industrial dhe bujqësor pothuajse u paralizuan, deficiti buxhetor e kaloi shifrën prej 50 për qind të PBB-së, inflacioni u rrit me ritme të shpejta duke arritur në 400 përqind në fund të vitit ‘91, borxhi i jashtëm u rrit mbi 600 milionë dollarë, papunësia kapi nivele mbi 50 për qind të popullsisë së aftë për punë etj.

Në vitin 1992, qeveria shqiptare nënshkroi marrëveshjen e parë me FMN-në në kuadrin e detyrimit për të aplikuar paktin e politikave liberale rigoroze të axhustimit strukturor, duke siguruar edhe një kredi *stand-by.* Reformat e para u përqendruan:

- ✓ në shkrirjen e sektorit kooperativist dhe në ndarjen falas të tokës bujqësore në favor të popullsisë rurale,
- ✓ krijimin e një agjencie kombëtare privatizimesh,
- ✓ ristrukturimin e disa prej ndërmarrjeve kryesore industriale për t'i përgatitur për privatizim.
- ✓ liberalizimin e çmimeve,
- ✓ zhvleftësimin e lekut dhe vendosjen e një përqindjeje këmbimi reale,
- ✓ liberalizimin e tregtisë së jashtme dhe vendosjen e një tarife doganore prej 10 për qind.

  *(Civici, Shteti apo Tregu: 315-316)*

*Reformat ekonomike-financiare të ndërmarra gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri:*

- ✓ politikë monetare restriktive, të shoqëruar me krijimin e një banke qendrore të pavarur, zgjerimin në përgjithësi të shërbimeve bankare dhe eliminimin e exedentit financiar të trashëguar,
- ✓ politikë buxhetore rigoroze, ndërtimin e një sistemi të ri fiskal dhe tatimor si dhe kontrollin rigoroz të inflacionit,
- ✓ liberalizim i tregut të brendshëm të kapitaleve, krijimi i një tregu efiçent kapitalesh,
- ✓ liberalizim i tregtisë së jashtme,
- ✓ rritje e ofertës së brendshme,
- ✓ nxitje e prodhimit të brendshëm industrial e bujqësor etj.

*(Civici, Shteti apo Tregu: 316)*

*Rritja ekonomike, cila do të ishte strategjia më e mirë?*

Rritja ekonomike mund të arrihet, ose më saktë nxitet në disa mënyra, si p.sh.:

- ✓ nëpërmjet borxheve dhe kredive nga jashtë
- ✓ nëpërmjet eksporteve të lëndëve të para
- ✓ nëpërmjet ristrukturimit ekonomik.

Si pjesa e borxheve, edhe ajo e eksporteve nga jashtë, gjykohen të jenë me nivel risku dhe jo aq të qëndrueshme. Rritja ekonomike e bazuar në lëndët e para dhe eksporti i tyre kur është fjala për sektorin me fason vlerësohet si jo e qëndrueshme. Mënyra e tretë, që sipas të huajve në botë, pra nga shembujt ka prodhuar një rritje afatgjatë. Meqenëse duam të nxisim rritjen ekonomike, duhet të mos mbetemi te politikat themelore të programeve strukturore, si stabiliteti makroekonomik, qëndrueshmëria buxhetore etj., por të fokusohemi drejt politikave prodhuese e më tepër drejt politikave energjetike. Të jemi të prirur drejt futjes në mënyrë masive të teknologjive të reja. Duhet të synohet drejt biznesit privat, ristrukturimi dhe modernizimi i tij. Politikat favorizuese vazhdojnë të bëhen për uljen e taksave, thjeshtësimin e sistemit tatimor e fiskal, por kjo nuk mjafton. Shqetësuese është "cilësia" e këtij biznesi. *(Civici, Shteti apo Tregu: 326-328)*

### 3.6. Treguesit kryesorë ekonomikë gjatë 1990-2000

Cilido që i shqyrton ritmet e rritjes së ekonomisë shqiptare për periudhën nga viti 1951 deri në vitin 1990, vëren se ato bien në mënyrë tendenciale, pesëvjeçar pas pesëvjeçari.

Në fund të vitit 1996 u duk një përkeqësim i ri i gjendjes ekonomike të vendit. Me fillimin e vitit 1997, këto tendenca u thelluan gjithnjë e më tepër, duke e çuar vendin drejt një kolapsi të ri ekonomik dhe shpërthimi social që shënoi shokun e dytë për ekonominë shqiptare.

Aspekti më i dukshëm i kësaj krize është shembja e institucioneve informale financiare që filloi në fund të nëntorit 1996. Këto institucione shtriheshin në territorin e tërë Shqipërisë dhe kishin

grumbulluar gjatë një periudhe 2-4 vjeçare kursimet e mbi 1/3 të numrit të përgjithshëm të familjeve shqiptare, të cilat vlerësohen në rreth 1,2 miliard USD *(Malaj, Mema "Karakteristikat dhe efektet e tregut jo zyrtar financiar", Ekonomia dhe tranzicioni, 1998)* .

Në mars të vitit 1999 ekonomia shqiptare pësoi një shok të tretë nga ardhja e rreth 500.000 refugjatëve kosovarë, që u shpërngulën me dhunë nga politika e spastrimit etnik, e ndjekur nga regjimi i Milloshevitçit. Infrastruktura e brishtë e vendit u dobësua më tej nga fluksi i papritur i popullsisë. Pa ndihmën e shërbimeve publike të afta për të përballuar një situatë të tillë, shqiptarët u përkujdesën për nevojat e refugjatëve me bujari dhe mikpritje.

Një karakteristikë tjetër e tranzicionit ekonomik në Shqipëri është ekstraversioni i tij, domethënë konsumi i brendshëm është më i madh se prodhimi, ndërsa diferenca mbulohet nga transfertat private të emigracionit shqiptar dhe ndihma e organizmave ndërkombëtarë. Ndërsa dërgesat e emigracionit shqiptar gjatë viteve 1991-2000, si mesatare vjetore, kanë qenë rreth 400-450 milionë USD.

Nga pikëpamja e injektimit të flukseve financiare, e krahasuar me ekonomitë e tjera në tranzicion të Evropës qendrore e lindore, si pasojë e përmasave të vogla dhe emigracionit të madh, Shqipëria është i vetmi vend që përngjan në këtë aspekt me Gjermaninë e lindjes. Të gjitha këto dukuri janë shoqëruar me ndryshime të thella në strukturën e GDP-së.

Disekuilibri i ri u shfaq edhe në zhvillimin rajonal të vendit, që erdhi si pasojë e krizës dhe e zhvillimit të pabarabartë ekonomik. 70 për qind e investimeve direkte të huaja janë përqendruar në aksin Tiranë - Durrës, ndërsa pjesa tjetër në zonat perëndimore dhe jugore të vendit. Investimet direkte të huaja dhe krijimi i ndërmarrjeve të reja nga kapitali vendas, kanë qenë faktori kryesor që ka përcaktuar hapjen e vendeve të reja të punës, nivelin e të ardhurave të

popullsisë, ritmet e zhvillimit ekonomik e social sipas rretheve etj. *(Vlerësimi i situatës sociale dhe ekonomike në Rajonet e Shqipërisë, UNICEF, 2000: 15-16)*

## 3.7. Konkluzione

Ky kapitull kishte si synim të ofronte një paraqitje në lidhje me urbanistikën e atyre viteve të periudhës 1912-2015 dhe treguesit kryesorë ekonomikë. Shqyrtimi i literaturës ndihmoi në qartësimin e periudhave të ndryshme që vendi ynë ka kaluar dhe faktorëve që ndikuan në ekonomi.

Nga kjo analizë e thellë, u vu re vështirësia e hasur gjatë periudhave të ndryshme kohore, si në periudhën e regjimit komunist, ashtu edhe në periudhën e regjimit socialist, tranzicioni dhe reformat e ndërmarra.

# KAPITULLI III: ZHVILLIMI URBAN DHE TREGUESIT EKONOMIKË-FINANCIARË/ QYTETI I TIRANËS

## Pjesa II: Qyteti i Tiranës dhe koncepti "Zhvillim i Qëndrueshëm"

### 3.8. Ekonomia e Tiranës dhe perspektiva e saj

Transformimet e para të mëdha që Tirana ka pësuar në fushën ekonomike filluan në vitin 1947, me ndërtimin e Fabrikës së Përpunimit të Mishit dhe Qumështit, Fabrikës së Këpucëve e kështu me radhë. Në vitin 1951, u ngrit industria e parë moderne, Kombinati Tekstil në Yzberisht, i cili fillimisht numëronte 5.000 punëtorë. Kombinati i përpunimit të drurit "Misto Mame" dhe termocentrali "Hidro Dajti" u ndërtuan gjithashtu në të njëjtin vit. Dy vjet më vonë, u ndërtuan fabrikat "Dinamo" dhe "Partizani", për prodhimin e pjesëve metalike të këmbimit. Më vonë u ndërtuan: Fabrika e Qelqit (1957), Fabrika e Porcelanit (1959), furrat silikat të tullave "Ali Kelmendi", Kombinati Ushqimor (1960), Kombinati i Auto-Traktorëve (1966), Kombinati Poligrafik (1970) etj.

Falë kësaj rritjeje, në fillim të viteve '60, Tirana kishte humbur karakterin e një qyteti ku mbizotëronte prodhimi i vogël artizanal dhe ishte kthyer në një qytet modern industrial.

Veprimtaritë ekonomike të Shqipërisë janë të përqendruara gjithmonë e më shumë në korridorin urban Tiranë – Durrës, ku janë 50% të ndërmarrjeve të vendit, 90% të ndërmarrjeve të mëdha dhe 63% e xhiros së Shqipërisë. Rajoni gjeneron aktualisht rreth 47% të GDP-së totale të Shqipërisë.

Për vitin 2009, GDP-ja për frymë për prefekturën e Tiranës llogaritet në 545 mijë lekë (4,126 Euro ose 5,737 $) e cila zë një peshë prej 37.9% në strukturën e GDP-së ose 51.2% mbi mesataren e vendit. Disa nga faktorët kryesorë janë përqendrimi i vlerës së shtuar të sektorit të ndërtimit, shërbimeve (bankat, sigurimet, si dhe telekomunikacioni), kompensimi i punonjësve

është më i lartë mesatarisht në krahasim me prefekturat e tjera si dhe nga fluksi i punonjësve që vijnë nga prefektura të tjera. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012: 138 )*

### 3.9. Zhvillimi i territorit që prej 1990-ës

Sistemi i zhvillimit urban në Shqipërinë komuniste përbëhej dhe përcaktohej nga tri elemente bazë: ekonomi e centralizuar, planifikim i centralizuar dhe pronë e shtetëzuar.

Figura 3.7. Sistemi i planifikimit pas vitit 1990 – marrëdhëniet midis aktorëve dhe komponentëve




Burimi: (*Manuali teknik i planifikimit dhe i Kontrollit të Zhvillimit të vendimmarrësit, profesionistët dhe zhvilluesit, Toto et al, Tiranë 2012)*

- Një tjetër faktor ndikues në mënyrën e zhvillimit ishte edhe zgjerimi ose dendësimi i banesave ekzistuese, të cilat tani nuk mund t'i shërbenin të gjithë familjes, pasi hapësirat dhe sipërfaqet e tyre ishin të pamjaftueshme për numrin e anëtarëve. Kjo mendohet të ishte arsyeja kryesore se pse pas vitit 1990 evoluoi dhe fenomeni i "*shtesës*". Me "*shtesë*" duhet të kuptojmë zgjerimin e hapësirave të banesës ekzistuese në mënyrë horizontale apo vertikale.

Qytetet shqiptare vuajnë mungesën e hapësirave publike:

- kanë infrastrukturë të pamjaftueshme
- densifikim të qendrave dhe humbje të identitetit urban, si dhe në të njëjtën kohë, shpërhapje urbane në periferitë e tyre. Shpërhapja urbane solli si pasojë humbjen ose keqmenaxhimin e tokave bujqësore.

A janë kryer plane rregulluese për zhvillimin e sektorit urban? Historiku i Planeve Rregulluese në qytetin e Tiranës:

1. Plani i parë Rregullues i qytetit (1923)

2. Plani i dytë Rregullues i qytetit (1926)

3. Plani i tretë Rregullues i qytetit (1928)

4. Plani i katërt Rregullues i qytetit (1929)

5. Plani Rregullues i vitit (1957)

6. Plani rregullues i vitit (1990)

7. Më pas kemi Planin Strategjik për Tiranën e Madhe (2002, PADCO)

8. Plani i Qendrës së Tiranës, "Architecture Studio", 2004

9. Plani Rregullues i Tiranës (2008)

Ndërkohë që, për momentin, sektori ligjor i pasurive të patundshme duket që po e zgjeron aktivitetin e tij më shpejt sesa sektori informal. Progresi i tij kufizohet nga tre faktorë:

***a.*** *Mungesa e një "plani rregullues" (plani i përdorimit të truallit) të azhurnuar dhe norma të aprovuara specifike për shumicën e qyteteve.* Edhe kur planet ekzistojnë, ato u përkasin vetëm disa lagjeve në qendrën e qytetit dhe fokusohen më shumë në projektimin urban sesa në hartimin e udhëzimeve të qarta për përdorimin e tokës dhe vendosjen e rrugëve. Shumë specifikime, si kufizimet, gjerësia e rrugëve kryesore, norma e shfrytëzimit të sipërfaqes së ndërtimit dhe

lartësia maksimale, duhet të shikohen në veçanti për çdo projekt. Kjo praktikë rrit koston e ndërtimit, duke shkaktuar vonesa të gjata.

*b. Mungesa e programeve të financuara bashkiake për të ndërtuar infrastrukturën parësore.*

c. *Vështirësia për të siguruar truallin e pashfrytëzuar të ndërtimit, zyrtarisht dhe ligjërisht.*

Sipas *R. Erkan*, urbanizimi është një proces i cili përmban ndryshimet sociale, procesin e ambientimit dhe bashkimit ose unifikimin e migrantëve me masën qytetare.

Sipas *Durkheimit dhe Merton,* këto kompleksitete sociale formojnë urbanizimin anomik. Urbanizimi anomik formohet si pasojë e humbjes së normave dhe si pasojë e parregullsisë (sipas Merton). Struktura sociale pëson një transformim të dukshëm në vetvete. Gjendja anomike e formuar prej ndryshimeve të strukturës sociale dhe kulturore të jetës së qytetit, si dhe mospërputhja e këtyre dy strukturave, formon atë që Merton e quan parregullsi në strukturën e qytetit, e cila reflekton edhe në procesin e urbanizimit.

Sipas INSTAT-it (2004), popullsia në rrethet e Tiranës dhe Durrësit në njëzet vitet e ardhshme do të rritet, nga 700.000 në 1.200.000 banorë. Kjo rritje prej 70 për qind i dedikohet vendosjes së vazhdueshme të migrantëve që vijnë nga pjesa tjetër e vendit, e kombinuar kjo me një rritje natyrore të popullsisë ekzistuese në rajon.

Popullsitë në jug dhe Shqipërinë e Mesme (pa përfshirë Tiranën dhe Durrësin) numëruan rreth 1 milion banorë në vitin 2001. Si pasojë e mungesës së migracionit të brendshëm, të dyja do të rriten në 1.2 milion banorë – më pak në jug dhe më shumë në Shqipërinë e Mesme - si pasojë e riprodhimit diçka më të vogël në ish-rajon.

Veriu, një rajon me një numër të madh emigracioni, do të ketë një rënie në popullsinë e tij deri në vitin 2021 në 340.000 banorë në qoftë se emigracioni vazhdon me ritmet aktuale.

Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit urban. Pjesa e popullsisë në rrethet Tiranë dhe Durrës do të rritet ndjeshëm, nga më pak se një e katërta, në më shumë se një të tretën e popullsisë së të gjithë vendit. Rëndësia relative e secilit prej tri rajoneve të tjera do të bjerë, më pak në Shqipërinë e Mesme, por më shumë në Shqipërinë e jugut, dhe akoma më tepër në atë të veriut. Më tepër se kurrë, popullsia shqiptare do të përqendrohet në pjesën qendrore të vendit.

### 3.10. Të dhëna të përgjithshme mbi qytetin e Tiranës

Tirana ka një pozitë rajonale gjeografike të favorshme. E vendosur mes pikave me vlerë të madhe territoriale e kombëtare, qyteti gjendet 40 km larg detit dhe pranë malit të Dajtit. Në perëndim të Tiranës ndodhet porti i Durrësit, më i madhi në Shqipëri. Në veri ndodhet qyteti historik i Krujës, me kështjellën dhe muzeun e Gjergj Kastriotit, ndërsa 25 km në veriperëndim të qytetit, në Rinas, gjendet aeroporti "Nënë Tereza", i rindërtuar në vitin 2007.

Figura 3.11. Pozita gjeografike e Tiranës




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012, fq. 8)*

Figura 3.12. Vija kufizuese e qytetit të Tiranës




Rrethi i Tiranës kufizohet: në jug me rrethin e Peqinit, në juglindje me rrethin e Elbasanit, në verilindje me rrethin e Bulqizës, në verilindje e veri me rrethin e Matit, në veri e pjesërisht në veriperëndim me rrethin e Krujës, në perëndim me rrethin e Durrësit dhe së fundi, në jugperëndim me rrethin e Kavajës.    Burimi: (Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 9)

Tirana është qendra kryesore e Prefekturës së Tiranës dhe e Rrethit me të njëjtin emër. Qarku i Tiranës ka një sipërfaqe totale prej 1288 km $^{2}$. Qyteti (brenda vijës kufizuese) zë një sipërfaqe prej rreth 41.8 km$^{2}$, nga 3 km $^{2}$ që ishte në 1920-ën, dhe përfaqëson 3.4% të sipërfaqes së rrethit. Qyteti kufizohet nga komunat e Dajtit, Farkës, Vaqarit, Kasharit, Bërxullit, Kamzës e Paskuqanit.

Tirana si qytet, u themelua në 1614-ën nga Sulejman Pasha, me origjinë nga fshati Mullet. Fillimisht ai ndërtoi një xhami, një furrë dhe një hamam. Struktura e Tiranës mbështetet kryesisht në funksionin rezidencial, administrativ, tregtar, të cilave gjatë periudhës së socializmit iu vesh edhe funksioni industrial.  *(Politika e Zhvillimit të Territorit 2012: 10-11)*

### *3.10.1. Historia e urbanizimit në Tiranë dhe historiku i planeve rregulluese*

Tirana është një nyje e fortë komunikacioni e lidhur me skajet më të largëta të vendit, me shtetet fqinje dhe në përgjithësi me botën e jashtme. Qyteti lidhet edhe me detin, duke qenë prej

Durrësit, portit kryesor të Shqipërisë, jo më shumë se 40 km larg. Rreth saj ndodhen qyteti i Krujës 32 km, Kavajës 48 km dhe Elbasanit 54 km. Rindërtimi i saktë i strukturës së Tiranës, për mungesë dëshmish e burimesh historike është i vështirë.

- *Bërthama e parë* historike e qytetit lindi me xhaminë e vjetër të Sulejman Pashës, dhe me një furrë, një banjë publike dhe një han, - tri objekte shërbimesh që ndikuan në zgjerimin e pazarit.

- *Bërthama e dytë* urbanistike u krijua në fillim të shek. XVIII rreth Xhamisë së Firës, e vendosur rreth 600 m në veriperëndim të bërthamës së parë, e cila u rindërtua në vitin 1859, duke u quajtur kësaj radhe Xhamia e Beshirit, sipas emrit të tregtarit që e ndërtoi.

- *Bërthama e tretë* u vendos në verilindje të bërthamës së parë. Ajo filloi të ndërtohet njëkohësisht me Xhaminë e Zajmit në 1775-ën dhe u shemb për nevoja urbanistike në takimin e "Rrugës së Dibrës" me rrugën "Thanas Ziko".

- *Bërthama e katërt* nisi të ndërtohej në kohën e themelimit të xhamisë së Haxhi Et'hemit, e cila u vendos rreth 200 m në perëndim të xhamisë së vjetër. Kjo strukturë u rrethua me banesa, kopshte, varre etj. (*Miho, K., 1987, Trajta të Profilit Urbanistik të Qytetit të Tiranës, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, f. 52)*

Qyteti i Tiranës lindi në shekullin XVII. Në qendër të qytetit konvergonin tri rrugë kryesore: "Rr. e Elbasanit", "Rr. e Dibrës" dhe Rr. e Kavajës. Atë çka shohim ne sot, të cilën e njohim si qendra e Tiranës moderne, e cila është konceptuar si një "hapësirë monumentale" përfaqësuese e "forcës dhe Rilindjes" së Shqipërisë, të kombit dhe shtetit shqiptar, duke zëvendësuar kështu dëshmitë e pakta të origjinës tiranase si Pazari i vjetër, me objekte të rëndësishme si: Pallati i Kulturës, Hotel Tirana, Muzeu Historik Kombëtar, sheshi "Skënderbej", dhe një grup apartamentesh

banimi të reja. Ndërtesat e vetme historike të marra nën mbrojtje ishin, Xhamia e Et'hem Beut dhe Kulla e Sahatit, kompleksi i Ministrive si dhe disa shtëpi tipike tiranase.

(*Politika e Zhvillimit të Territorit 2012: 10-11)*

Aksi kryesor që buron prej kësaj qendre, i konsideruar si boshti themelor i qytetit, u konceptua në hapat e parë të urbanizimit të tij, gjatë përgatitjes së planeve rregulluese të fillimshekullit XX.

Ky aks u krijua dhe do të shërbente si një nyje lidhëse mes qytetit të vjetër dhe qytetit modern. Bulevardi përbën njëkohësisht qendrën monumentale dhe institucionale të Tiranës. Ai është i orientuar sipas drejtimit veri-jug dhe përfundon në dy pole të rëndësishme: stacioni hekurudhor i qytetit dhe kompleksi universitar, që shërben edhe si porta e Parkut të Liqenit.

Shpërndarja në hapësirë e këtyre funksioneve bazohet në karakterin monocentrik të qytetit, karakter i cili është trashëguar historikisht. Rreth zonës së qendrës, përgjatë sektorëve hapësinorë të krijuar në segmente të ndryshme kohore, është përqendruar zona e banuar, e cila, për sa i përket zënies territoriale, përbën formacionin dominues të qytetit. Përtej zonës së banuar, në periferitë e largëta të Tiranës janë vendosur zonat industriale, te cilat kanë cenuar edhe zonat e terrenet me karakter bujqësor, të ndodhura po në periferitë e largëta të qytetit, duke zhvilluar banimin informal e të paorganizuar.

Ekonomia si forcë bazë e zhvillimit njëkohësisht të një qyteti dhe të një vendi, ka pësuar lëvizje, nga ajo primare e sekondare në terciare. Ajo pjesë e vogël e ekonomisë sekondare, e cila rilindi nga fundi i viteve '90 e më pas, u përqendrua në aksin Tiranë - Durrës. Ajo bëri të mundur krijimin e një korridori të rëndësishëm ekonomik jo vetëm për Tiranën, por edhe për pjesën tjetër të vendit. Tirana e fillimshekullit transmeton deri në ditët e sotme, një teksturë planimetrike të çrregullt, të shtrirë e të copëtuar. Brenda kësaj endjeje urbane mund të dallojmë dy zona: zona e

banimit, e tërhequr më tepër nga interesat e ngushta të pronësisë e mungesë të një kontrolli të centralizuar, shtrihej e shpërndahej kudo, pa një kufi të përcaktuar;  dhe Pazari, zona ekonomike qendrore e Tiranës.

Të dyja zonat e mësipërme, ajo e banimit dhe zona ekonomike qendrore, lidheshin dhe kufizoheshin nga një sërë rrugësh e rrugicash. Shpërndarja e çrregullt e rrjetit rrugor ka qenë një dukuri karakterizuese e qyteteve; banesat shpesh vendoseshin të tërhequra nga vija e ndërtimit, por edhe në kënde të ndryshme ndaj aksit rrugor.

Duke ruajtur karakterin monocentrik të trashëguar prej qytetit historik, konceptet urbane të fillimit, prezantuan krijimin e një aksi të fuqishëm veri-jug, i cili gjenerohet nga qendra historike e konturohet nga objektet që do të mbartin funksionet e reja. Në pjesën kryesore të aksit u vendosën godinat administrative në mënyrë të përqendruar. Shndërrimi në kryeqytet, solli për Tiranën edhe një rritje të konsiderueshme të popullsisë, e si rrjedhojë rritjen e nevojës për strehim dhe domosdoshmërinë e ndërtimit të banesave.

Krijimi i hapësirave të reja ndërtuar sipas rregullit të ri hapësinor-kuadratik për qytetin e Tiranës, i prezantuar në pjesën juglindore të rrjedhës së Lanës, nuk e ndryshoi apo përmirësoi në thelb karakterin e qytetit, i cili mbeti i shtrirë e me një shfrytëzim irracional të territorit. Tirana u shtua e pasurua me tërësinë e objekteve sociale, kulturore, arsimore, sportive, të nevojshme për funksionimin e saj si kryeqytet.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua strukturës së hapësirave të gjelbra të qytetit, si nga elementi i kopshteve private, e që mbështetej disi në lulishtet e pakta të krijuara brenda qytetit nga italianët. Struktura e re e gjelbërimit u mbështet në boshtin kryesor të qytetit, të cilit iu veshën hapësira të

mëdha të gjelbëruara. Parku i madh i qytetit ishte një hapësirë tjetër e gjelbër që u konceptua si një ambient çlodhës-argëtues.

Transformimi i sistemit shoqëror në fillimet e viteve ‘90 solli ndryshime në strukturën e qytetit, i cili, nga një forcë e madhe ekonomike-industriale, u shndërrua në qendër të ekonomisë terciare vendase. Tregtia u bë baza e ekonomisë së re.

Tirana, sikundër edhe qytetet e tjera të Shqipërisë, gjatë atyre viteve u evidentua me banimin e pakontrolluar informal, i cili u vendos më tepër në tokat bujqësore dhe hapësirat e lira periferike, pa suportin e një infrastrukture të përshtatshme inxhinierike dhe sociale.

Lëvizja e popullsisë solli rritjen e intensitetit të ndërtimit brenda Unazës së qytetit si dhe shtrirjen e ndërtimeve të reja drejt periferisë e zonave industriale. Shtrirja urbane e fragmentuar solli izolimin e zonave të veçanta si dhe një zhvillim të pabalancuar.

(*Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 12-14)*

Tirana në vitin 1920 ishte kryeqyteti dhe qendra më e madhe e vendit, me sipërfaqe prej 305 ha dhe popullsi 15.000 banorë. Pazari, siç folëm edhe më sipër, ishte qendra e qytetit, ndërsa zona e banimit, e cila zinte 98,2% të sipërfaqes së qytetit, shtrihej kryesisht në veri e lindje të tij. Rrjeti i çrregullt rrugor përbëhej nga rrugë e rrugica të ngushta dhe të shtrembra.

*1. Plani i parë Rregullues i qytetit (1923)*

Plani i parë Rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1923. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti strategjik ishte krijimi i një rrjeti të ri rrugor kuadratik në jug e në perëndim të Pazarit, i cili do të harmonizohej me rrjetin ekzistues me anë të zgjerimit dhe sistemimit të rrugëve përbërëse të këtij

të fundit. Ky plan theksonte akset kryesore të qytetit, si: “Rrugën e Kavajës”, “Rrugën e Durrësit”, “Rrugën e Barrikadave” etj.

*2. Plani i dytë Rregullues i qytetit (1926)*

Plani i dytë Rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1926. Ai bazohej në idetë e hedhura nga plani i parë i Tiranës, duke e rishikuar atë. Në këtë plan u materializua për herë të parë ideja e një aksi të fuqishëm veri-jug.

*3. Plani i tretë Rregullues i qytetit (1928)*

Plani i tretë Rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1928 nga arkitektë austriakë. Ky ishte plani i parë konceptuar gjatë periudhës së mbretërisë si dhe plani i parë urbanistik që merr në konsideratë të gjithë territorin e qytetit. Plani, i hartuar në shkallën 1:5000, përcakton qartë vendosjen e një sistemi rrugor modern kuadratik në të gjithë qytetin, përfshirë pjesën e vjetër të tij.




Figura 3.13. Plani Rregullues i vitit 1929

Burimi: (*Politika e Zhvillimit të Territorit 2012: 17)*

*4. Plani i katërt Rregullues i qytetit (1929)*

Plani i katërt Rregullues i Tiranës u hartua në vitin 1929. Në këtë plan, hartuar në shkallën 1:5000, aksi i bulevardit zgjatej në veri drejt stacionit aktual të trenit, ku mendohej të ndërtohej stadiumi i ardhshëm i qytetit, ndërsa në jug drejt pallatit mbretëror. Plani përcaktonte kufijtë e

qytetit, brenda të cilave përfshihej një sipërfaqe prej 450 ha, si dhe konturonte zonën e qendrës, ku përfshiheshin bulevardi dhe akset rrugore kryesore. Në fillim të vitit 1930 nisën punimet për ndërtimin e bulevardit "Zogu I", "Rrugës së Durrësit" dhe të godinave të ministrive pranë sheshit qendror.

*Plani Rregullues i qytetit i vitit 1929*

Gjatë vitit 1930, Tirana njohu një zhvillim të madh si qendër administrative dhe ekonomike, duke arritur një popullsi 30.000 banorë. Për pasojë lindi edhe nevoja e zgjerimit të kufijve të qytetit. Qyteti, që në vitin 1937 kishte 35.000 banorë, në fillimet e punës për hartimin e planit rregullues kishte arritur në 40.000 banorë, e në përfundim të planit në 75.000 banorë.

Tirana konceptohej si një qytet-park shumë i gjelbëruar. Parimi kryesor për zhvillimet e reja do të ishte të bërit sa më pak shpronësime, për të ruajtur dhe vlerësuar godinat ekzistuese dhe fizionominë e qytetit. Ndërtimet intensive deri në 5 kate, do të lejoheshin vetëm në zonën administrative përgjatë bulevardit, përgjatë "Rr. së Durrësit", "Rr. së Kavajës", pranë Pazarit të vjetër si dhe në zonat përreth. Në këto objekte do të vendoseshin zyra, dyqane, banka etj. Qyteti do të zgjerohej në veri përtej lumit të Tiranës, duke krijuar një zonë-satelit të lidhur me pjesën tjetër nga rrugë dhe ura.

Zonat e gjelbra, me sipërfaqe 132 ha, do të shtriheshin kryesisht në lindje dhe në jug të qytetit. Zona sportive, me sipërfaqe 33 ha, do të vendosej në pjesën lindore, ndërsa parku i madh i qytetit, me sipërfaqe 22 ha, do të shtrihej mbi kodrat. Zonat industriale do të zhvilloheshin në veriperëndim e jugperëndim, dhe ndërmjet tyre do të ndërtohej qyteza e punëtorëve.

Stacioni hekurudhor, i vendosur në jugperëndim të qytetit, do të ishte përfundimi i linjës hekurudhore që do të lidhte Tiranën me Durrësin dhe pjesën lindore të Shqipërisë. Një degëzim i hekurudhës do të lidhte qytetin me zonën industriale.

Zona e shërbimeve përfshinte zonën e spitaleve, të vendosur në verilindje të qytetit, zonën e varrezave, si dhe zonën e panaireve, të vendosur në veriperëndim.

Aeroporti do të ndërtohej në zonën perëndimore e do të kufizohej nga Unaza e jashtme e qytetit, "Rruga e Durrësit" dhe "Rruga e Kavajës". Sistemi rrugor i propozuar nga plani ishte ai radial-unazor, ku kuartallet e formuara ndërmjet unazave dhe radialeve përshkohen nga rrugë dytësore sipas një skeme kuadratike. Në pjesën jugore të qytetit ku mungonin radialet, skema ishte thjesht kuadratike.

Plani propozonte sistemimin e Lanës, e cila do të ndërpritej nga aksi i bulevardit, me drejtim pingul me këtë të fundit. Rrjeti unazor i qytetit përbëhej nga Unaza e madhe, Unaza e mesme, Unaza e vogël dhe disa Unaza pjesore. Parashikohej gjithashtu, një aks i ri paralel me pjesën perëndimore të Unazës së madhe, i cili do të përfundonte te stacioni i trenit.

Transformimi urbanistik i Tiranës do të bazohej mbi ekuilibrin *pronë private-interes publik* dhe një sistem ekonomik që funksiononte sipas logjikës së tregut të lirë.



6. *Plani Rregullues i vitit 1957*

Pas luftës, Tirana kishte 59.900 banorë, ndërsa në vitin 1955 numëroheshin rreth 108.200 banorë.

Figura 3.14. Plani rregullues italian (1940-1943)

Burimi: (*Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 20)*

Plani rregullues i 1957-ws kishte si objektiva kryesorë:

- Rritjen e dendësisë së banimit në qytetin ekzistues; ndryshimin e planit të zonimit duke rishpërndarë zonën industriale dhe atë të banimit; përmirësimin dhe shtimin e rrjetit rrugor ekzistues;

- Ruajtjen e disa zonave si monumente kulture;

- Shfrytëzimin racional të truallit.

Plani parashikonte zgjerimin e qytetit në drejtim të lindjes, faktor ky që diktoi zgjatjen dhe përmirësimin e rrugëve radiale. Sistemi rrugor i propozuar bazohej në situatën ekzistuese, së cilës i shtoheshin dy Unaza, njëra e brendshme dhe tjetra e jashtme, me gjatësi 8 km, nga të cilat, e para nuk u realizua ndërsa e dyta mbeti e papërfunduar. Aksi i bulevardit vazhdonte të ishte boshti ideal i funksionimit të qytetit.

Zonat industriale parashikoheshin të vendoseshin në veri e perëndim të qytetit, ndërsa gjelbërimi u mendua të zhvillohej kryesisht në jug, ku do të krijohej një zonë-park prej rreth 190 ha, ndërsa brenda qytetit synohej realizimi i standardit 8 $m^2$ gjelbërim/banor.

Zona e banimit do të zgjerohej në hapësirat e reja të caktuara. Plani parashikonte që brenda Unazës së parë ndërtesat të ishin me lartësi 3-4 kate dhe densitet 350 banorë për ha, ndërsa jashtë këtij Unaze ndërtesat do të ishin 1-3 kate.



Figura 3.15. *Plani rregullues i vitit 1957* Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 21)*

Lagjet e reja të krijuara pavarësisht zgjidhjes urbanistike, krijuan monotoni dhe varfëri nga ana arkitektonike.

Gjithashtu, blloqet me parafabrikat të ndërtuara në vitet ‘80, dhe sidomos ndërtimet me kontribut vullnetar të realizuara në vitet ‘70-‘80, që në pjesën më të madhe bëheshin pa studime urbanistike, deformuan në mënyrë të ndjeshme strukturën e qytetit.

7. *Plani Rregullues i vitit 1990*

Hartimi i këtij plani ishte bërë shumë i domosdoshëm, për shkak të rritjes së kërkesës për banim, zgjerimit të paparashikueshëm dhe ndërthurjes së zonës industriale me zonat e banimit, të planifikuara më 1957-wn dhe jo më aktuale.

Në vitin 1985, Tirana zinte një sipërfaqe prej 1540 ha. Plani i ri parashikonte zgjerimin e qytetit në 3238 ha dhe zhvillimin e tij sipas një strukture polifunksionale e policentrike.

Qyteti ndahej në këto zona funksionale:

- Zona banimi, 1902 ha;
- Zona industriale, 524 ha;
- Zona e objekteve shoqërore, ku përfshiheshin dhe shkollat e universitetet, me sipërfaqe 116 ha;
- Zona spitalore, 53 ha;
- Zona e ambasadave, 20 ha;
- Zona të veçanta, me sipërfaqe 18 ha;
- Zona e varrezave publike, 45 ha;
- Zona e Varrezave të Dëshmorëve, 5 ha;
- Pallati i Brigadave, 35 ha;
- Zona e pushimit dhe zona e gjelbër, 439 ha;

- Zona shërbimesh, 293 ha;

- Zonë bujqësore, duke përfshirë këtu serat e fidanishtet, 80 ha;

Në shpërndarjen e zonave industriale dhe ekonomike viheshin re tri fenomene:

- Vendosja e zonave ekonomike brenda territoreve të banimit, si dhe vendosja e ndërmarrjeve ekonomike në godina ekzistuese të adaptuara për qëllime prodhimi, fenomene këto që sillnin probleme të rëndësishme e delikate;

- Zonat industriale periferike kishin mundësi shumë të mira lidhjeje me rrugët interurbane dhe linjën hekurudhore, si dhe ishin lehtësisht të aksesueshme nga punonjësit falë Unazave e rrugëve tërthore. Këtu bëjnë pjesë: Kombinati i Tekstileve, Kombinati Ushqimor, Kombinati i Drurit, Kombinati i Materialeve të Ndërtimit, Zona e Industrisë Ushtarake etj.

- Ndërthurja e zonave industriale me zonat e banimit, duke krijuar shpesh konflikt të dyanshëm me funksionet e tyre.

Plani rregullues i vitit 1990 tentonte spostimin dhe përqendrimin e zonave industriale në hapësira të veçanta, në veri, në perëndim e në lindje të qytetit, larg zonave të banuara.

*Objektivat e planit:*

- Plotësimi i kërkesave për banim të banorëve deri në vitin 2005;

- Përcaktimi i hapësirave të reja për zhvillimin industrial, zgjidhja e problemit të ndotjes së shkaktuar nga këto të fundit, si dhe shtimi e përmirësimi i rrjetit rrugor përkatës;

- Rishikimi dhe rivlerësimi i pjesës më të madhe të zonave të banimit, të përcaktuara si me zgjidhje të papërshtatshme. Nga 960 ha zonë e banuar, vetëm 460 ha konsideroheshin të zgjidhura drejt. 500 ha të tjera do të bëheshin objekt i planeve të detajuara të rivlerësimit, të cilat

duhej të gjenin ose krijonin, nëpërmjet prishjeve, hapësirat e nevojshme për shërbime brenda zonave në fjalë.

- Ulja e dendësisë së banimit nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së zonave të banuara.

Qëllimi ishte të kalohej nga dendësia 224 banorë/ha e vitit 1988, në 170 banorë/ha në vitin 2005, me gjithë zhvillimin dinamik demografik të qytetit. Plani Rregullues parashikonte që popullsia e Tiranës do të kalonte, nga 253.000 banorë më 1990-ën, në 317.000 banorë në vitin 2005.

- Përshtatja e rrjetit rrugor ekzistues me nevojat në rritje të qytetit. Sistemi do të mbetej radial-unazor, me gjithë problemet që shkaktonte në trafik me zgjerimin e qytetit. Planet rregulluese bëheshin për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të qytetit.

Figura 3.16. Skema e zonimit, Plani Rregullues i vitit 1990




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 26)*

Figura 3.17. Skema e rrjetit rrugor dhe vija kufizuese e qytetit, Plani Rregullues i vitit 1990




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 26)*

Propozimet ishin të ndryshme për sa i përket zhvillimit të qytetit, si nga studioja "*Regional Consulting 2005",* e më pas të tjera përsëri.

*Rregullorja e Zonimit të Qytetit të Tiranës (viti 1996)*

Rregullorja përpiqej të disiplinonte edhe ndërtimet e jashtëligjshme, të cilat vitet e fundit kishin zënë hapësirat publike, si p.sh.: ndërtimet komerciale përgjatë Lanës dhe në shumicën e shesheve qendrore. Sipas studimit, të gjitha strukturat e vendosura në hapësirat publike duhej të ishin me karakter të përkohshëm dhe, në çdo rast, të pajiseshim me lejet e posaçme pranë organeve të pushtetit vendor.

Figura 3.18. Planimetria e qytetit të Tiranës me funksionet e propozuara, Rregullorja e Zonimit 1996




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 34)*

*Më pas kemi Planin Strategjik për Tiranën e Madhe (2002, PADCO)* Disa nga përfundimet kryesore të Planit Strategjik ishin:

*I. Popullsia*

Regjistrimi i kryer në vitin 2001 tregonte se rajoni i Tiranës së madhe kishte një popullsi prej 491.000 banorësh. Plani Strategjik parashikonte që, kjo vlerë do të arrinte në 714.000 - 858.000 banorë në vitin 2017. Për të përballuar këtë rritje të popullsisë në rajon, studimi propozonte që të preferohej rritja e dendësisë së qendrave të banuara përkundrejt shtrirjes së qytetit.

Ai prezantonte një metodë të re të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit urban, për implementimin e të cilit kërkohej qartësimit i roleve dhe përgjegjësive të secilit pjesëmarrës nga sektori publik në procesin e planifikimit. Studimi rekomandonte mënyra bashkëpunimi midis

shoqatave të komunitetit dhe përfaqësuesve të sektorit privat, të mbështetura me ndryshimet e posaçme në legjislacionin e qeverisjes vendore, e cila duhej t'i afrohej modelit të decentralizuar.

*II. Propozimet e përdorimit të tokës*

Plani Strategjik përcaktonte në vija të përgjithshme përdorimin e tokës në rajonin e Tiranës së madhe.

III. *Propozimet për lartësinë e ndërtesave*

Propozimet mbi lartësitë e ndërtesave ishin vendosur në varësi të gjerësisë së rrugëve, raporteve me ndërtesat dhe kufijve të pronës. Bashkia e Tiranës do të mbështeste përdorimin miks dhe lartësitë mesatare, edhe për ndërtimet në qendër, të cilat do të ishin të kufizuara në 6 kate. Në këtë formë do të ruhej mjedisi i mirë për këmbësorët, pa e rënduar sistemin rrugor dhe rrjetin e infrastrukturës në qendër të qytetit.

*IV. Sistemi rrugor*

Plani parashikonte zgjerimin dhe shtrirjen e qendrës në hapësirën brenda Unazës së dytë të qytetit. Në studim propozohej ndërtimi i një Unaze të tretë dhe të katërt. Jashtë kufirit të Unazës së katërt nuk do të lejoheshin ndërtime, përkundrazi, zona do të trajtohej me një brez të gjelbër.

Plani parashikonte zhvillimin e disa kategorive të rrugëve në funksion të lehtësimit të trafikut dhe transportit:

- *Kategoria e parë – Unazat kryesore të qytetit*

Njëra nga Unazat përkonte me Unazën e jashtme parashikuar nga plani i 1990-ës, prej së cilës ishte ndërtuar vetëm segmenti perëndimor. Unaza e tretë e qytetit rritej në perimetër krahasuar me 1990-ën, duke përfshirë një sipërfaqe më të madhe brenda saj. Në veri, ajo shtrihej deri në Bathore, duke përfshirë Paskuqanin. Në lindje do të përfshinte zonat rrotull Kodrës së Priftit dhe Liqenit të Farkës, ku kishte mjaft zhvillime informale. Në jug do të përfshinte Selitën, parkun

dhe Liqenin e Tiranës në kufi me Saukun etj. Në një farë mënyre, studimi përcaktonte kufirin e ardhshëm administrativ të Bashkisë Tiranë.

Unaza orbitale, ose Unaza e katërt e qytetit, do të realizonte lidhjen e qytetit me aksin rrugor perëndimor Tiranë - Durrës, aksin verior Tiranë - Shkodër dhe atë juglindor Tiranë - Elbasan, duke shmangur hyrjen e trafikut në qytet. Kjo Unazë, qendra e së cilës nuk do të përkonte me qendrën e qytetit, do të mbulonte të gjitha territoret në veriperëndim të Tiranës, duke përfshirë Kombinatin me rrethinat e tij dhe zonat e zhvilluara rishtazi në Bashkinë Kamëz.

- *Kategoria e dytë - Tangencialet*

Dy tangencialet më të rëndësishme që propozoheshin ishin: segmenti verior Babrru – Allias - “Rruga Bardhyl” - Brryli - rruga “Ali Demi”, deri te “Rruga e Elbasanit” dhe segmenti Zall-Herr, rruga e Kamzës, Bërxull, Yzberisht, Kombinat.

- *Kategoria e tretë - Rrugët distriktuale*

Ato do të ishin akset kryesore që depërtonin nga Unazat brenda zonave kryesore të qytetit.

*Kategoria e rrugëve të veçanta:*

- *Lidhja e shpejtë me aeroportin e Rinasit*

Skema e re krijonte një lidhje alternative më të shkurtër me aeroportin e Tiranës dhe korridorin e veriut, përmes zgjatimit të bulevardit në veri, drejt Paskuqanit. Një degëzim i bulevardit do të kalonte në lindje të Bashkisë Kamëz, përgjatë lumit të Tërkuzës, duke u orientuar më pas në verilindje, drejt aeroportit.

- *Rrugët prioritare për transportin publik*

Në këto rrugë do të kalonin linjat e autobusëve Porcelan – “Rruga Bardhyl” - Sauk - Partizani i Panjohur, Kafe Flora - fabrika “Coca-Cola”, Kodër-Kamëz - Yzberisht.

- *Rrugët me një drejtim lëvizjeje*

“Rruga e Kavajës” dhe një sërë rrugësh kryesore në pjesën perëndimore të qendrës bëheshin me një drejtim lëvizjeje të detyruar për automjetet.

Planifikohej edhe ndërtimi i dy linjave të tramvajit. Këto linja do të lidhnin aeroportin e Rinasit me Kamzën deri në Bërxull, prej ku ndaheshin në dy drejtime kryesore:

Plani Strategjik evidentonte dy zona, që mendohej të kishin mundësi të mëdha zhvillimi ekonomik:

- Korridori i Paskuqanit ose zona e zgjatimit të aksit të bulevardit, ku propozoheshin blloqe të larta me funksion tregtar dhe rezidencial

- Zona industriale e Bërxullit

Figura 3.19. Sistemi rrugor i propozuar nga Plani Strategjik i Tiranës së Madhe




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 37)*

Figura 3.20. Sistemi rrugor i propozuar nga Plani Strategjik i Tiranës së Madhe,

*Unaza e tretë dhe Orbitalja*




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 37)*

*Studimi i Zhvillimit Rajonal Tiranë-Durrës (Viti 2002, GTZ)*

Studimi bazohej në konceptin e një rajoni të integruar urban Tiranë-Durrës, që duhej zhvilluar sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes së matur demografike. Rajoni Tiranë-Durrës karakterizohej nga një numër avantazhesh e dobësish, të lidhura: me demografinë, situatën shoqërore, strukturën, zhvillimin ekonomik, zhvillimin hapësinor, përdorimin e tokës, transportin, infrastrukturën inxhinierike, infrastrukturën sociale, kushtet natyrore dhe mjedisin, zhvillimin rural, kuadrin e përgjithshëm ligjor dhe institucionet.

Zhvillimi i shpejtë i tij duhej të rregullohej nga plani i përdorimit të tokës dhe nga një sistem i mirëpërcaktuar administrimi.

Figura 3.21. Studimi i Zhvillimit Rajonal Tiranë-Durrës, Struktura administrative dhe hapësinore

Studimi francez i qendrës (2004)




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 37)*

Studimi i qendrës u hartua nga studioja franceze *"Architecture Studio*". Projekti kishte për qëllim t'i jepte një përmasë të re qendrës së kryeqytetit nëpërmjet një sistemi të ri rregullash.

Zona e studimit përfshinte qendrën e qytetit, me shtrirje deri te kompleksi i universitetit në jug, Lumi i Tiranës në veri, sheshi "Avni Rustemi" në lindje dhe rruga "Kont Urani" në perëndim. Studimi përforconte më tej akset kryesore të zhvillimit dhe propozonte një zhvillim perspektiv të peizazhit urban në koherencë me nevojat e një Tirane më të madhe.

**Disa nga propozimet e këtij studimi pjesor ishin:**

- Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i karakterit multifunksional të qendrës së qytetit.

- Zhvillimi dhe rregullimi i rrjetit rrugor, me anë të krijimit të rrugëve të reja dhe zgjerimit e përmirësimit të atyre ekzistuese. Këto ndryshime do të përmirësonin dukshëm trafikun dhe do të

ndanin më qartë zonat brenda qytetit. Krahas rrugëve për automjete, parashikohej edhe hapja e rrugëve të reja këmbësore në brendësi të blloqeve të banimit dhe hapësirave të gjelbëruara.

- Sistemimi i rrjetit të kanalizimeve, i cili do të lehtësohej nga krijimi dhe rinovimi i disa akseve kryesore rrugore.

- Përmirësimi i sistemit publik të transportit, duke përcaktuar trajektore dhe korsi të veçanta për linjat urbane të autobusëve në rrugët kryesore dhe dytësore. Një hapësirë e veçantë do të rezervohej për këto mjete edhe brenda stacionit të madh intermodal, ku do të mund të kombinoheshin edhe mjetet e ndryshme të transportit për të hyrë e dalë nga qyteti.



Figura 3.22. Plani i Qendrës së Tiranës, “Architecture Studio”, 2004

Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 42)*

- Rritja e densitetit në lagjet tregtare e të banimit, nëpërmjet ristrukturimit të plotë ose të pjesshëm të tyre. Në këto njësi, ndërtesat e reja do të vendoseshin buzë rrugëve, për të lejuar rritjen e densitetit dhe krijimin e hapësirave të gjelbra rekreative në brendësi.

- Ruajtja e lartësisë mesatare të godinave në sheshin “Skënderbej”, me përjashtim të kullave.

- Ruajtja e godinave monumentale dhe integrimi i tyre me qytetin, nëpërmjet përcaktimit të një grupi ndërtesash në mbrojtje dhe vendosjes së rregullave për ndërtimet e reja në afërsi të objekteve monumentale.

- Krijimi i hapësirave të gjelbra brenda zonave ekzistuese dhe në territore të reja.

Plani i qendrës së Tiranës kishte edhe disa mangësi, që e bënin atë të parealizueshëm në një përqindje të lartë. Disa prej këtyre mangësive paraqiten më poshtë:

- Mungesa e njohurive të plota mbi pronat publike;

- Mungesa e një detyre të plotë projektimi, për vlerësimin e problematikave të territorit në studim dhe orientimin e qartë mbi funksionet dhe fizionominë e qendrës së qytetit;

- Shtrirja e studimit mbi një sipërfaqe shumë të madhe, në të cilën përfshiheshin zona me fizionomi dhe problematika të ndryshme, duhej të sillte trajtime specifike për secilën zonë, gjë që nuk ndodhi;

- Studimi përfshinte pjesë nga territori i disa njësive bashkiake, pa përcaktuar rolin e këtyre organeve vendore në realizimin e studimit;

- Studimi nuk propozonte një sistem të ri rrugor në funksion të zhvillimit perspektiv të qytetit, por vetëm rehabilitimin e sistemit ekzistues;

- Nuk bëhej një vlerësim i plotë i karakteristikave tradicionale të Tiranës së vjetër dhe nuk mbahej qëndrim për disa nga objektet me vlera historike dhe arkitektonike në qytet. Në studim nuk përcaktoheshin rregulla për mënyrën e ndërhyrjes në objektet ekzistuese, të cilat mbeten të pandryshuara;

- Studimi nuk merrte parasysh mendimet e grupeve të interesit, si: banorët, pronarët e trojeve, zhvilluesit etj. Për këtë arsye, disa zona nuk mund të zhvillohen, pasi mungon interesi ekonomik.

- Mungesa e një sistemi të plotë rregullash për trajtimin e sipërfaqeve të lira, që mbeten pas realizimit të ndërtimeve të reja;

- Studimi kishte mospërputhje me sistemin ligjor në fuqi, si p.sh.: distanca midis objekteve, lartësia e kateve etj.

*Plani Rregullues i Tiranës (2008)*

Plani Rregullues i vitit 2008 u hartua nga studioja zvicerane "Urbaplan" në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Studimi nuk u miratua në të gjitha instancat, për shkak të mangësive të paraqitura.

Objektivat parësorë të planit:

- Zhvillimi i qytetit bazuar në konceptin e Tiranës së madhe dhe zgjerimi i tij përgjatë korridorit urban Tiranë - Durrës;

- Afirmimi i rolit të Tiranës si kryeqytet i vendit, nëpërmjet përforcimit të funksioneve qendrore ekzistuese dhe krijimit të atraktivave të reja;

- Integrimi i vendbanimeve informale periurbane dhe integrimi i banorëve të tyre në qytet.

Plani Rregullues i vitit 2008 përpiqej të kufizonte shtrirjen e qytetit nëpërmjet dendësimit të tij. Zhvillimi i blloqeve me intensitet të lartë do të kërkonte plotësimin e rrjetit rrugor ekzistues, për të përballuar rritjen e kërkesës për lëvizshmëri në zonën urbane.

Studimi propozonte rehabilitimin e blloqeve të banesave ekzistuese, duke kufizuar ndërtimet e reja dhe ofruar shërbime komunitare.

Pronarët e objekteve në mbrojtje duhej të kompensoheshin për humbjen e së drejtës për të zhvilluar pronat e tyre, nëpërmjet disa mekanizmash të posaçëm.

Në qytet propozohej krijimi i disa poleve, të vendosura në ish-hapësirat industriale, ku do të përqendroheshin aktivitete të kombinuara. Këto pole, zhvillimi i së cilave ndahej në katër faza, do të luanin një rol të rëndësishëm në strukturimin perspektiv të qytetit.

Zhvillimi urban i zonave ekonomike dhe sociale sipas planit:

- Zona perëndimore e qytetit paraqiste mundësi të mira për dendësim, duke qenë e lidhur mjaft mirë me akset rrugore kryesore.

- Zona jugore, e cila ofronte më pak hapësirë për zhvillime të reja, duhej t'i nënshtrohej një ndërhyrjeje të rëndësishme për të gjithë qytetin, që ishte ndërtimi i segmentit jugor të Unazës;

- Zona veriore ofronte potenciale të mëdha zhvillimi, sidomos në hapësirat përreth stacionit të trenit dhe te ish-zonat industriale përgjatë Lumit të Tiranës.

- Në zonën lindore, megjithëqë kishte hapësira për zhvillim, aksesibiliteti i dobët i bënte të pamundura investimet e mëdha dhe të menjëhershme. Ndërtimi i segmentit lindor të Unazës së madhe rezultonte i domosdoshëm për integrimin e kësaj pjese të qytetit.

Plotësimi i sistemit rrugor me Unaza të shumëfishta ishte aspekti më kryesor në zhvillimin e sistemit rrugor në Tiranë. Përfundimi i Unazës së madhe përbënte një kusht të domosdoshëm për shfrytëzimin e potencialit të zonave në zhvillim si dhe për kontrollimin e shtrirjes urbane.

Plani përpiqej të përcillte një tendencë të re multimodale të lëvizshmërisë, e cila do të kufizonte trafikun e mjeteve të motorizuara dhe do të përmirësonte cilësinë e mjedisit në zonat qendrore urbane. Lëvizja e banorëve dhe frekuentuesve të qytetit duhej të bazohej kryesisht në rrjetin e transportit publik me autobusë dhe tramvaj.

Mangësitë e këtij dokumenti të planifikimit po i paraqesim më poshtë:

I. Zhvillimi i pabalancuar i qytetit të zonuar sipas hapësirash shumë të vogla, sidomos në pjesën e qendrës. Në shumë raste, kapacitetet ndërtimore të parcelave të gjendura karshi njëra-tjetrës paraqisnin diferenca të mëdha.

II. Plani jep parashikime dhe përcakton kritere edhe për zhvillimin e disa zonave të gjendura nën juridiksionin e komunave kufitare, pa marrë miratimin e këtyre të fundit.

III. Rrjeti rrugor i propozuar, megjithëqë paraqitet si objektiv primar i studimit, përmban më pak rrugë se rrjeti rrugor i Planit Rregullues të vitit 1990, parashikimet e të cilit ishin hartuar në kushtet e një sistemi social-ekonomik dhe të një popullsie tërësisht të ndryshme.

IV. Mungesa e azhurnimit të të dhënave ekzistuese.

V. Mungesa e relievit të azhurnuar topografik, mbi të cilin duhej të vendoseshin të gjitha hartat me studimin e gjendjes ekzistuese dhe me propozimet e planit.

Figura 3.23. Zonimi funksional i qytetit, "Urbaplan", 2008




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 45)*

Plani Rregullues i hartuar për Tiranën në vitin 2008, nuk u miratua kurrë tërësisht, duke mbetur një studim teorik e i paaplikuar.

Figura 3.24. Polet e rëndësishme të zhvillimit, "Urbaplan", 2008




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 46)*

Figura 3.25. Fazat e zhvillimit dhe zonat prioritare, "Urbaplan", 2008




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 46)*

Figura 3.26. Sistemi rrugor i propozuar, “Urbaplan”, 2008




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 47)*

***Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës së Madhe, 2012***

Studimi u hartua nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës, në vitin 2012. Ai mbulon të gjithë Zonën e Tiranës Metropolitane (ZTM), ku përfshihen territoret e urbanizuara aktuale e perspektive të Bashkisë Tiranë, dhe shtatë bashkive e komunave kufitare.

Studimi synon nxitjen e hartimit të planeve tematike urbane dhe plan-zbatimeve të tyre, bazuar në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor, kryesisht në këta katër sektorë parësorë të infrastrukturës urbane:

- Rrugët dhe Transporti Urban;

- Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta;

- Sistemi i Furnizimit me Ujë;

- Kanalizimet/ Sistemi i Kullimit.

**Parimet udhëheqëse të projektit:**

- Ruajtja dhe forcimi i tipareve natyrore të territorit në fjalë, nëpërmjet strukturimit të elementeve dhe peizazhit urban të Tiranës dhe kufizimit të ndërtimeve të larta;

- Zgjerimi dhe forcimi i dy korridoreve ekologjike të Lumit të Lanës dhe Lumit të Tiranës;

- Forcimi i boshtit kryesor veri-jug si bosht historik i qytetit;

- Rritja dhe përforcimi i boshtit interurban Tiranë - Durrës;

- Krijimi i një parku të madh urban në skajin verior të bulevardit;

- Strukturimi i drejtpeshuar i strukturave urbane përgjatë Unazës së jashtme. Qyteti i Tiranës që në fillesat e tij është zhvilluar sipas një modeli koncentrik, ku trafiku përqendrohet në qendër të qytetit. Strukturat hapësinore metropolitane në qytet janë formuar përgjatë korridoreve rrugore kryesore, të ndara në radiale dhe Unaza.

- *Korridoret radiale*

Rrjeti rrugor në Tiranë do të ketë nëntë korridore radiale: (1) Korridori i Durrësit, (2) Korridori i Kamzës, (3) Korridori i Kavajës, (4) Korridori i Komunës së Parisit, (5) Korridori i Elbasanit, (6) Korridori i ish-Uzinës Traktori, (7) Korridori i Dajtit, (8) Korridori i Tufinës dhe (9) Korridori i Paskuqanit. Çdo korridor është shërbyer nga të paktën një rrugë parësore. Rrugët unazore dhe rrugët radiale themelore përbëhen nga rrugët kryesore, duke u shërbyer nënqendrave të mëdha ekzistuese dhe të planifikuara në Tiranë. Përveç kësaj, duhet të ndërtohen edhe rrugë dytësore, të cilat plotësojnë rrjetin themelor rrugor.

Korridori i Paskuqanit, i cili shkon drejt veriut, duke kaluar, nga qendra përgjatë shëtitores "Zogu I", duhet të shtrihet deri në Paskuqan. Përgjatë këtij korridori janë planifikuar strehime të mëdha dhe zhvillime të tjera, të cilat do të përkojnë me drejtimet e zhvillimit të Bashkisë së Tiranës.

- *Korridoret unazore*

Tirana klasifikohet si "qytet qendër rajonale" nga këndvështrimi i shkallës së popullsisë. Ajo duhet të ketë një rrjet rrugor të përshtatshëm me funksionet e një metropoli.

Struktura rrugore e propozuar paraqet tri korridore të mëdha unazore: (10) Korridori i Unazës së Brendshme, (11) Korridori i Unazës së Mesme dhe (12) Korridori i Unazës së Jashtme.

Figura 3.27. Zhvillimi i korridoreve rrugore në Tiranë, JICA, 2012




Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 49)*

Studimi propozon ndërtimin e një terminali të tillë, ku të përfshihen linjat e autobusëve ndërurbanë, furgonëve dhe linjat ndërkombëtare. Investimi duhet të pajiset me mjediset e nevojshme, si: tualete, biletari, dhoma pritjeje, dyqane, restorante, vendqëndrime për taksitë dhe

parkime. Infrastruktura gjykohet e arsyeshme të vendoset diku në Unazën e jashtme, për të siguruar sipërfaqe të mjaftueshme ndërtimi dhe lehtësimin e hyrjes së automjeteve në/nga jashtë Tiranës. Më e rëndësishmja: terminali i ri duhet të lidhet me disa autobusë të qytetit dhe linja të tjera të transportit publik për transferimin për në qendër të Tiranës apo në drejtime të tjera.

Masat e parashikuara për përmirësimin e transportit mbi shina:

- Përmirësimi i hekurudhës ekzistuese;

- Zhvillimi i një sistemi të ri të tranzitit masiv mbi shina, nëpërmjet dy linjave të tramit: lindje-perëndim (Kinostudio – Kombinat) dhe veri-jug (Terminali i Transportit Intermodal – Qyteti Studenti).



Figura 3.28. Masa e zbatimit të Studimeve Pjesore të miratuara deri në vitin 2011

Burimi: *(Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012: 56)*

Pjesa më e madhe e truallit të studimeve pjesore në fjalë është përdorur për zhvillime rezidenciale. Pavarësisht përqindjes së realizimit të ndërtimeve, problematike mbetet mungesa në realizimin e hapësirave publike dhe hapësirave të gjelbra brenda blloqeve. Rrjeti rrugor dhe infrastruktura, thuajse përherë kanë mbetur të pandryshuar edhe pas zhvillimit, i cili në shumë

raste ka sjellë ndryshime të rëndësishme në intensitetin ndërtimor dhe dendësinë e banimit të zonave.

(*Politika e Zhvillimit të Territorit, 2012)*




**3.11. Industria e ndërtimit dhe faktorët që ndikuan në zhvillimin e qytetit të Tiranës.**

Grafiku 3.8. Klasifikimi i ndërtimit të banesave në Shqipëri sipas rajoneve

Burimi: *("Albania Real Estate Report 2009", i përgatitur nga "Century 21 Albania")*

Tirana ka pasur një bum të vërtetë në sektorin e ndërtimit gjatë 25 viteve të fundit. Aktualisht, sektori i ndërtimit zë rreth 4.28% të tregut ekonomik të qytetit. Ai numëron 1.143 firma ndërtuese dhe prodhuese të materialeve të ndërtimit dhe rreth 80% të gjithë firmave ndërtuese në vend. Përqindjen më të lartë në veprimtarinë ndërtimore e zë ngritja e ndërtesave të banimit, me rreth 60%. Aktualisht në Tiranë janë të ndërtuara rreth 115.000 banesa dhe apartamente, ku 54% e tyre janë ndërtuar para viteve '90 dhe 46% pas viteve '90.

Ajo çka vihet re është që, në qytetin e Tiranës ka një përqendrim shumë të madh ndërtimesh; ato përbëjnë rreth 15.20% të totalit të ndërtimeve në gjithë Shqipërinë. Në tri dekadat e fundit para viteve 1990, çdo vit ndërtoheshin mesatarisht 165 godina të reja. Tre të katërtat (77%) e këtyre godinave ishin shtëpi për një familje dhe shumica e pjesës tjetër (22% e totalit) ishin banesa multifamiljare me lartësi 4–6 kate.

Në periudhën pas vitit 1996, numri i ndërtimeve të reja për çdo vit është 24-fishuar, duke arritur në 3.953 godina, ku rreth 95% janë shtëpi për një familje. Nga ana tjetër, është përshpejtuar ndërtimi i objekteve të larta, ku rreth 3/4 e këtyre objekteve në Tiranë janë ndërtuar në 10-vjeçarin e fundit. Sipas rezultateve paraprake të "Census 2011", të publikuara nga INSTAT-i, në qytetin e Tiranës ka 46.401 ndërtesa dhe 154.788 banesa. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012: 143 )*

*Faktorët që ndikuan në zhvillimin e industrisë së ndërtimit*

Në situatën në të cilën ndodhej më parë Shqipëria, problem ishte strehimi i popullsisë. Kjo situatë bëri të mundur rikonstruksionin e ndërtesave dhe rritjen e ekonomisë shqiptare.

Në vitet 1998 e në vijim, filluan ndërtimet e godinave shumëkatëshe të banimit, tregtare, të rrugëve të reja. Ato kryesisht jo vetëm në metropolin Tiranë-Durrës dhe Vlorë, por edhe në qytete të tjera periferike.

Kjo industri ka njohur dy faza:

*Faza e parë,* që përbën edhe burimin e kësaj industrie, ishte ajo e viteve '90, ku karakteristikë ishte rikonstruksioni i banesave dhe ndërtimi i apartamenteve të banimit.

*Faza e dytë,* ishte periudha pas viteve 2000, e cila karakterizohet nga një zhvillim cilësor i kësaj industrie, nga shtrirja e prodhimeve të saj jo vetëm për blloqe banimi, por edhe ndërtime moderne. Ky sektor ka qenë dhe do mbetet një sektor kyç në ekonominë shqiptare.

Gjatë viteve të fundit kemi një rënie në sektorin e ndërtimit. Ky fenomen ka ndodhur si rezultat i studimit të rajoneve pjesore. Vëzhgimi i Matjes së Standardeve të Jetesës (VMSJ) tregon se, jo më pak se një e katërta e ndërtesave për banim janë ndërtuar pas viteve 1990.

Megjithëse sektori i ndërtimit zë vetëm 10 për qind të PBB-së, ai ka qenë burimi kryesor i rritjes së prodhimit. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar në zhvillimin e industrisë së ndërtimit janë:

- ✓ sistemi i infrastrukturës rrugore dhe aeroportuale i trashëguar ishte tërësisht i amortizuar dhe, për më tepër, krejt i papërshtatshëm për të përballuar fluksin e jashtëzakonshëm të lëvizjes së automjeteve dhe mjeteve të tjera që erdhi pas vitit '90;
- ✓ lëvizja migruese e popullsisë, nga zonat rurale drejt atyre urbane;
- ✓ zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe rritja e zhvillimit të industrive prodhuese ka bërë të mundur që të shtohen kërkesat për ndërtime industriale;
- ✓ problemet e pronësisë, sidomos pas viteve '93-'94 në lidhje me pronësinë mbi tokën dhe truallin, ka pasur probleme të dy ose më shumë pronarëve.

Burimi: *(Vlerësimi i situatës sociale dhe ekonomike në rajonet e Shqipërisë, dhjetor 2000)*

## 3.12. Vlerësimi social-ekonomik në qytetin e Tiranës

*3.12.1. Të dhëna mbi institucionet arsimore*

Sistemi arsimor i shtrirë në territorin e Bashkisë së Tiranës përbëhet nga një sistem i plotë çerdhesh, kopshtesh, shkollash dhe universitetesh publike dhe jopublike. Ato janë të shpërndara në të gjitha njësitë bashkiake të Tiranës. Menaxhimi i infrastrukturës arsimore të qytetit të Tiranës, me përjashtim të arsimit të lartë, realizohet nga Bashkia e Tiranës, duke filluar që nga viti 2003, bazuar në projektin-pilot për arsimin publik në Tiranë.

Sistemi arsimor është i ndarë në tri kategori:

- Sistemi parashkollor – në të cilin bëjnë pjesë çerdhet dhe kopshtet;

- Sistemi arsimor parauniversitar – në të cilin bëjnë pjesë shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale;

- Sistemi i arsimit të lartë - në të cilin listohen universitetet publike dhe ato private.

Rrjeti i institucioneve arsimore publike përbëhet nga shkolla të tipave të ndryshëm, duke përfshirë shkollat me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar. Kriteret për hapjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Sistemi arsimor publik përbëhet nga:

A- Arsimi parashkollor publik, që është niveli i parë i sistemit arsimor publik (kopshtet, grupmosha 3-6 vjeç).

B - Arsimi i detyruar publik, 6-15 vjeç, sistemi 9-vjeçar, struktura e re (5 +4).

Shkolla e arsimit të detyruar publik përfshin dy cikle:

- ciklin fillor; nga klasa 1-5

- ciklin e lartë, nga klasa 6-9

Cikli i lartë është vazhdim logjik dhe i natyrshëm i ciklit fillor.

Cikli fillor dhe cikli i lartë kanë tipare organizative dhe pedagogjike specifike, të cilat përcaktohen nga Ministria e Arsimit.

C- Arsimi i mesëm publik, 15-18 vjeç (gjimnaz dhe profesional).

D- Arsimi special publik (Instituti i fëmijëve që nuk shikojnë dhe fëmijëve që nuk dëgjojnë).

Në qytetin e Tiranës, aktualisht sistemi i plotë arsimor përbëhet nga këto objekte:

| | |
|---|---|
| Çerdhe publike | 29 |
| Kopshte publike | 42 |
| Kopshte jopublike | 22 |
| Shkolla 9-vjeçare publike | 62 |
| Shkolla 9-vjeçare jopublike | 43 |
| Shkolla të mesme të përgjithshme | 15 |

| | |
|---|---|
| Shkolla të mesme profesionale | 8 |
| Universitete publike | 5 |

Shumica e mjediseve mësimore janë rikonstruktuar mbas vitit 2000, dhe konkretisht, janë 37 shkolla publike 9-vjeçare të rikonstruktuara mbas vitit 2000, dhe pjesa tjetër prej 16 shkollash, të rikonstruktuara në periudhën 1995-1999. Nga shkollat e mesme, vetëm 3 shkolla janë rikonstruktuar në periudhën 1996-1999, dhe pjesa tjetër e tyre janë rikonstruktuar pas vitit 2000. Objektet arsimore në qytetin e Tiranës, megjithëse janë të shpërndara në të gjithë territorin e tij, nuk janë të bazuara në kërkesat që ka popullsia për këto objekte. Kjo ndodh për arsyen kryesore se, qyteti i Tiranës në 25 vitet e fundit e ka trefishuar popullsinë e tij, si rezultat i migrimit të popullsisë, nga zonat rurale të të gjithë Shqipërisë drejt Tiranës. Ky fenomen ka sjellë krijimin e zonave informale në të gjithë kurorën periferike të Tiranës si dhe rritjen e dendësisë së popullsisë së zonave urbane tradicionale të saj. Kjo rritje e popullsisë gjatë këtyre viteve, nuk është shoqëruar edhe me përmirësimin progresiv të infrastrukturës në përgjithësi dhe të asaj arsimore në veçanti.

Për këtë arsye, rezulton se në Tiranë infrastruktura arsimore është pothuajse ajo e fillimit të viteve '90. Kjo ka sjellë që, gjendja e shkollave të rezultojë e mbipopulluar në maksimum dhe në shumë raste mësimi të zhvillohet me dy turne. Shumica e rikonstruksioneve të realizuara në infrastrukturën arsimore, si në atë shkollore, ashtu edhe në atë parashkollore, kanë qenë të pjesshme dhe nuk kanë ndërhyrë në ndërtimin e shtesave në godinat ekzistuese. Krijimi i shkollave dhe kopshteve private e ka lehtësuar disi këtë gjendje në shkollat publike, por numri i nxënësve dhe fëmijëve në këto shkolla është relativisht i vogël dhe ka ndikim jo të konsiderueshëm në përmirësimin e gjendjes.

Zgjidhja përfundimtare dhe e plotë e infrastrukturës arsimore të Tiranës mund të arrihet nëpërmjet dy rrugëve kryesore:

- ✓ rikonstruksioni i plotë, duke përfshirë dhe shtesat e mundshme të objekteve shkollore ekzistuese;
- ✓ ndërtimi i shkollave të reja.

Në Tiranë nevojitet dhe ndërtimi i 17 shkollave të tjera të reja. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012 )*

*3.12.2. Institucionet shëndetësore*

Në qytetin e Tiranës, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet 20 qendrave shëndetësore, të shpërndara në 11 njësitë bashkiake, në 13 klinika e poliklinika të specialiteteve, në 15 qendra të planifikimit familjar (nga të cilat, 11 funksionojnë brenda qendrave parësore) dhe në 4 spitale tretësore, të cilat ofrojnë shërbime për gjithë popullsinë dhe kanë karakter nacional. Sistemi shëndetësor parësor ofron shërbim shëndetësor bazë, si diagnostikim, imunizim, shërbim prenatal, planifikim familjar dhe monitorim të rritjes së fëmijës. Në këtë sistem punojnë 472 mjekë ose 1.3 mjek për çdo 1.000 banorë, dhe 2.129 infermiere e mami ose 4.6 infermiere e mami për 1.000 banorë. Ky nivel shërbimi është 2.5 herë më pak se në vendet e Evropës lindore e qendrore. Niveli i shpërndarjes së personelit mjekësor është i ndryshëm në njësitë bashkiake. Përveç rrjetit publik, në Tiranë vepron një rrjet privat shërbimesh mjekësore. Sot numërohen rreth 24 klinika private mjekësore të specializuara, 414 klinika, laboratorë dentarë e shërbime stomatologjike dhe 332 farmaci.

Edhe pse qyteti i Tiranës është i mbuluar me shërbime mjekësore në nivel më të mirë në krahasim me rrethet e tjera, në zona të veçanta të qytetit, e sidomos në periferinë e tij, ka një situatë problematike të shërbimeve për shëndetin.

*Vdekshmëria foshnjore*

Niveli i vdekshmërisë foshnjore në Tiranë rezulton i përafërt me nivelin kombëtar; ai luhatet në 15-20 vdekje foshnjore për 1.000 lindje të gjalla. Megjithatë, duke e parë këtë fenomen në ecurinë e tij, këto 10 vitet e fundit vihet re një zvogëlim i ndjeshëm, duke rënë, nga mbi 23 vdekje për 1.000 lindje të gjalla në vitin 1999, në shifra më të ulëta se 15 vdekje për 1.000 lindje tw gjalla, ndërkohë që për vite të veçanta kjo shifër ka qenë edhe më e vogël se 12 vdekje për 1.000 lindje të gjalla.

*Personeli shëndetësor*

Shërbimi shëndetësor parësor është i organizuar në nivel drejtorie të kujdesit të shëndetit parësor në qendër të Qarkut dhe drejtorie të shëndetit publik të qyteteve. Shërbimi bazë shëndetësor në zonat urbane dhe ato rurale sigurohet nga mjekët e përgjithshëm. Në përputhje me standardet e aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë, në zonat urbane këta janë: mjekë të përgjithshëm për të rritur, mjekë të përgjithshëm për fëmijët e moshave 0-14 vjeç, dhe mjekë të përgjithshëm për të gjitha moshat. Ndërsa, për sa u përket zonave rurale, komunave e fshatrave, kemi vetëm kategorinë: mjekë të përgjithshëm për të gjitha moshat. Në varësi të kategorive përkatëse dhe zonave ku ata operojnë, janë përcaktuar dhe normat e ngarkesës ose intervali i pranueshëm i numrit të banorëve për një mjek. Kështu, mjeku i përgjithshëm për të gjitha moshat në qytet konsiderohet me një ngarkesë normale në rastet kur kemi një mjek për 2.000 banorë, ndërsa ngarkesa maksimale e lejuar është një mjek për 3.000 banorë. Në zonat rurale, ky tregues është përkatësisht 1.700 dhe 2.600 banorë për një mjek.

Shtrirja e Tiranës në 20 vitet e fundit kërkon dy nivele interpretimi dhe veprimi:

- Zona Metropolitane e Tiranës (qyteti + komunat dhe bashkitë ndërkufitare) përbën njërin prej entiteteve;

- Rajoni Urban Tiranë–Durrës dhe zhvillimet demografike e ekonomike në këtë rajon kanë çuar në krijimin e një entiteti tjetër funksional urban që mbulon të gjithë territorin.

Tirana është rritur si një metropol mesdhetar, – një faktor i ri në gjeografinë politike, ekonomike dhe kulturore të Europës juglindore.

Ky pozicionim i ri ndërkombëtar nënkupton dy pasoja për Tiranën:

- *nxitje të zhvillimit për shërbime kulturore të qytetit;*

- *përcaktim dhe forcim të rolit ekonomik të qytetit në lidhje me kontekstin e tij ndërkombëtar strategjik.*

Potenciali aktual i zhvillimit të Shqipërisë ndikohet fuqimisht nga:

- *Porti i Durrësit, i cili aktualisht trajton 80% të kapacitetit të transportit detar të Shqipërisë dhe është në proces rritjeje domethënëse;*

- *Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës, i cili e ka rritur kapacitetin e tij në rreth 1.5 milion pasagjerë.*

Si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe sociale të 20 viteve të fundit, në Shqipëri është rritur ndjeshëm numri i fluturimeve dhe operatorëve ajrorë.

- Rrjeti rrugor ndërkombëtar, ku veçanërisht ndërtimi i Korridorit VIII ndëreuropian, përfundimi i autostradës Durrës - Prishtinë dhe Rrugës së Arbrit do të rrisin ndjeshëm rolin e Tiranës në rajon. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012 )*

### *3.12.3. Zhvillimi i Turizmit në Tiranë*

Turizmi në Tiranë ka pasur një bum të vërtetë cilësor dhe sasior në vitet e fundit. Këtë e tregon më së miri hapja e hoteleve, hosteleve dhe njësive të tjera akomoduese ekonomike, mesatare dhe luksoze. Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë, sot në Tiranë zhvillojnë aktivitetin e tyre rreth 110 njësi të tilla akomoduese. Në Tiranë

ndodhen tri hotelet më të mëdha të vendit: "Tirana International Hotel", një hotel katëryjesh me 166 dhoma, i administruar nga menaxherë shqiptarë, i cili ndodhet në qendrën komerciale të Tiranës, i rrethuar nga dyqane, bare dhe restorante; "Sheraton Tirana Hotel & Towers", me 151 dhoma, me pesë yje, i cili ndodhet pranë kompleksit argëtues dhe tregtar në zemër të Tiranës; dhe "Rogner Hotel Europapark", me 138 dhoma, me pesë yje, administruar nga rrjeti hotelier austriak "Rogner", i cili ofron kushte perëndimore jetese.

Sipas Agjencisë Kombëtare të Turizmit, gjatë vitit 2010, Shqipërinë e vizituan rreth 2 milionë e 420 mijë shtetas të huaj. Gjithnjë sipas kësaj agjencie, rreth 45% e vizitorëve kishin ardhur për tw kaluar pushimet. Por numri i këtyre vizitorëve sa vjen e rritet. Kështu, sipas burimeve nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, numri i turistëve që kanë vizituar vendin tonë gjatë vitit 2011 ishte 2.733.655.

Numrin më të madh të vizitorëve e përbëjnë kosovarët, me 46%, të ndjekur nga maqedonasit 12%, malazezët dhe grekët 6%, italianët 5%, anglezët dhe gjermanët me nga 3%. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012 )*

### *3.12.4. Tirana - qyteti i qendrave më të mëdha tregtare në vend*

Në Tiranë operojnë njëmbëdhjetë qendra tregtare, të cilat kanë tërhequr firma shumë të njohura në arenën ndërkombëtare, në fusha të ndryshme të ekonomisë. Gjithashtu, shërbejnë edhe si qendra argëtimi, ofrojnë ambiente biznesi për zyra, salla konferencash dhe hotele, si dhe ndikojnë edhe në nxitjen e turizmit në Tiranë, pasi rreth 90% e vizitorëve të kryeqytetit (vendas dhe të huaj) i vizitojnë rregullisht këto qendra.

| **Qendra biznesi** | **Sip (m²)** | **Numri i dyqaneve** | **Sipërfaqja e dyqaneve (m²)** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| European Trade Center (ETC) | 5 000 | 65 | 12-130 |
| Torre Drin | 800 | 19 | 40 |
| Kullat Binjake | 2 050 | 23 | 16-500 |
| Qendra Kristal | 10 500 | 40 | 35-1500 |
| Sheraton Shopping Center | 2 650 | 20 | 15-400 |
| Condor Center | 10 000 | 80 | 35-1500 |
| Aba Bussines Center | 8 500 | 8 | 1 100 |
| City Park Center | 200 000 | # | 75 000 |
| Casa Italia | 20 000 | 41 | 23-2000 |
| TEG | 90 000 | # | # |
| Megatek | 20000 | # | # |

Tregjet publike lindën si një nevojë urgjente për të sistemuar tregtarët ambulantë, të cilët tregtonin në rrugë e ku të mundnin, si dhe për të plotësuar nevojat tashmë në rritje të qytetarëve.

Aktualisht në qytetin e Tiranës zhvillojnë aktivitetin:

- 44 tregje gjithsej (formale dhe informale), nga të cilat, 38 tregje shumice dhe 6 tregje pakice. - 6 tregje tregtojnë materiale industriale, 24 fruta-perime, 5 veshmbathje dhe 8 janë përcaktuar si tregje të përziera. - 13 tregje formale, nga të cilat, 12 pakice dhe 1 shumice. Sipërfaqja totale është 25,584 $m^2$, në të cilën janë të vendosur 3.409 tezga gjithsej dhe 470 tregtarë. Përqindja e shfrytëzimit llogaritet në 33.1, - 31 tregje informale, prej të cilave 26 shumice e 5 pakice, me një sipërfaqe totale 16.720 $m^2$. Në këto tregje janë të vendosur 5.585 tezga dhe 967 tregtarë. Përqindja e shfrytëzimit llogaritet në 122.49.

14 tregje administrohen nga Bashkia e Tiranës, e cila tashmë ua ka deleguar administrimin e tregjeve publike njësive bashkiake. Bashkia e Tiranës vetëm në disa raste është pronare e truallit në të cilin janë ndërtuar këto tregje. Të gjitha tregjet janë të ndërtuara me Vendime të KRRT-së së qytetit si dhe me VKB. *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012:147 )*

### *3.12.5. Zonat e gjelbra në Tiranë*

Pozicionimi gjeografik, klimaterik dhe fiziko-territorial e kanë vendosur Tiranën në listën e qyteteve të privilegjuara nga natyra. Ajo ka formën e një amfiteatri të zhytur mes gjelbërimit, që formon kurora e malit të Dajtit dhe e kodrave të vendosura në të tria anët e tjera. Vetë struktura dhe etapat e ndërtimit të qytetit kanë qenë favorizuese për përçimin e gjelbërimit në brendësi të qytetit, në formën e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara masivisht. Në strukturën përbërëse të qytetit dallohet qartë një ndarje midis pjesës veriore (e ndërtuar në mënyrë të dendur) dhe jugore të tij (ku janë vendosur përgjithësisht parqet dhe lulishtet). Të vendosura brenda qytetit ose në afërsi të tij, ato përbëjnë pikat më të vizituara nga qytetarët. Sipërfaqja kryesore e gjelbër dhe atraktive për banorët e kryeqytetit është Parku i Tiranës, i krijuar në vitet ’60, me një sipërfaqe 288 ha. Sipërfaqe të tjera të gjelbëruara në Tiranë janë Parku Rinia, parku përballë parlamentit, lulishtja në afërsi të Bankës së Shqipërisë, një sërë lulishtesh të shpërndara në brendësi të blloqeve të banimit si dhe parku përgjatë Lanës, i cili u është rikthyer banorëve të kryeqytetit.

Parku i Tiranës, i vendosur në jug të qytetit, konturon fundin e bulevardit, duke krijuar një kurorë të gjelbër tepër të dallueshme nga çdo pikë e qytetit. Me një gjelbërim të dendur dhe të shumëllojshëm, ai rrethon Liqenin Artificial të Tiranës dhe krijon hapje nga perëndimi, ku pozicionohen Kompleksi i Pishinave dhe Kompleksi Sportiv Dinamo. Parku, si një ambient edhe rekreativ, është pajisur me mobilimin e nevojshëm urban, duke siguruar një vendqëndrim dhe një potencial për aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore. Plani i Qendrës së Tiranës

parashikon krijimin e një hapësire të gjelbër lineare në veri të qytetit si linjë kryesore e gjelbërimit në qytet, duke takuar ujëmbledhësin e Paskuqanit, që do të mendohet si nyja tjetër gravitacionale e gjelbërimit (paralele me parkun e Liqenit) ose “parku verior”.

Parku Rinia, i vendosur shumë pranë qendrës së qytetit, pas rikonstruksionit është frekuentuar gjithmonë e më shpesh. Karakterizohet nga një mobilim i lehtë urban dhe nga një hapësirë bari integrale si pjesë e peizazhit.

Parku i Namazgjasë, nga i cili për momentin funksionon vetëm parku përballë parlamentit, mendohet të zgjerohet drejt perëndimit dhe të takohet me bulevardin, duke ndërhyrë në mënyrë organike ndërmjet objekteve të ndërtuara në këtë pjesë.

Lulishtet, si ajo në afërsi të Bankës së Shqipërisë, edhe të tjerat të vendosura në brendësi të blloqeve rezidenciale, kanë veçori dekorative dhe një mobilim urban të ngjeshur në funksion të qytetarëve.

Sot Tirana është zgjeruar shumë dhe në të përfshihen zona të gjelbra si: zona nën malin e Dajtit, zona e Selitës, zona e Saukut etj. Shumë sipërfaqe të gjelbra ndodhen brenda institucioneve të ndryshme, që nga ministritë, spitalet, shkollat, kopshtet, çerdhet etj. Brenda tyre gjendet një numër shumë i madh drurësh, shkurresh e lulesh.

Në qytetin e Tiranës infrastruktura e gjelbër prej 1.996.432 $m^2$ ndahet në:

- Parqe e lulishte të qytetit, 277.304 $m^2$ (pa përfshirë 6.220 $m^2$ sipërfaqe të zënë);

- Parqe periferike, 1.719.128 $m^2$ (Parku i Madh i Tiranës, Varrezat e Dëshmorëve të Kombit dhe Kopshti Zoologjik).

Parku i Dajtit është një ndër zonat më të rëndësishme në Shqipëri, për shkak të trashëgimisë së pasur dhe shumëllojshmërisë së faunës së egër. Kjo vjen si rezultat i gjerësisë gjeografike dhe lartësisë mbi nivelin e detit, shumëllojshmërisë së numrit të tipave të ndryshëm të landshafteve dhe shoqërimeve bimore, dhe variacioneve të kultivimit tradicional të tokës, të cilat i kanë dhënë formë landshaftit të ditëve të sotme. Shumë nga hapësirat e Parkut Kombëtar të Dajtit kanë një rëndësi ruajtjeje kombëtare dhe ndërkombëtare, me disa lloje të konstatuara vetëm në pak habitate në botë. Struktura e ambienteve të gjelbëruara që funksionojnë si parqe, rekreacione dhe lulishte publike për qytetin e Tiranës shtrihet e gjitha në një sipërfaqe totale 2.761.538 m², e ndarë në rreth 61 struktura të gjelbra, ndër të cilat më të rëndësishmet janë:

- Sipërfaqja e gjelbër në qendër të Tiranës zë një hapësirë rreth 240.026 m²;

- Parku i madh bashkë me Liqenin Artificial shtrihen në një sipërfaqe të konsiderueshme prej 1.590.000 m². E ndarë nga kjo sipërfaqe ndodhet, si i vetmi në Shqipëri, Kopshti Zoologjik, me sipërfaqe 59.600 m²;

- Varrezat e Dëshmorëve; edhe kjo një sipërfaqe kryesisht e gjelbër, e cila shtrihet në 249.700 m²; - Parku Rinia, i kthyer në sipërfaqe të gjelbër vetëm pak vite më parë, i cili zë një sipërfaqe prej 30.000 m². *(Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, 2012 )*

*3.12.6. Investimet e Huaja Direkte dhe efektet e tyre*




**Grafiku 3.9. Shpërndarja territoriale në Shqipëri e Investimeve të Huaja Direkte**

Burimi: (Banka e Shqipërisë, 2011)

Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, ajo që evidentohet në Investimet e Huaja Direkte është se ato janë përqendruar kryesisht në rrethin e Tiranës dhe në Durrës, ku zënë rreth 67% të totalit të kompanive me kapital të huaj dhe të përbashkët.

IHD-të janë të përqendruara në këto dy qytete sepse, Durrësi ka portin më të madh në vend, ndërsa Tirana është kryeqyteti i vendit. Një përqendrim i tillë ndikon në lëvizjen e popullsisë, nga zonat më të varfra rurale, në zonat më të pasura urbane, në drejtim të qyteteve të mëdha. Siç shihet nga grafiku më sipër, për vitin 2010, shpërndarja territoriale e Investimeve të Huaja Direkte është kryesisht e përqendruar në Tiranë, me 55% të kapitalit, Durrës, me 12% të kapitalit, dhe më pas në qytetet e tjera. Në tabelën e mëposhtme paraqitet xhiroja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik deri në 2008-ën, shprehur në përqindje. *Grafiku 3.10.* Xhiroja e filialeve të huaja sipas aktivitetit ekonomik deri në 2008-ën, shprehur në%.




Burimi: (*INSTAT, 2010)* Referuar vitit 2008, xhiroja e filialeve të huaja në vitin 2009 ishte 50% më e lartë në çmime nominale. Rritja ishte mbi mesataren në ndërtim dhe manifakturë. Në prodhim, xhiroja e filialeve të huaja mbeti pothuajse e pandryshuar, në sektorin e tekstileve, veshmbathjeve dhe artikujve të lëkurës, ndërsa në prodhimin e mineraleve jometalore pati lulëzim, edhe pse zhvillimi industrial ka qenë, në vija të përgjithshme, mjaft i mirë. Lulëzimi i sektorit të ndërtimit përbënte motorin kryesor të rritjes, duke ndikuar te minierat, guroret dhe materialet e ndërtimit. Rritja ekonomike mori një stimul më të madh nga privatizimi i komunikacionit dhe IHD-të në industrinë e naftës. *( Zoto. O. Doktoratura: 61)*

### 3.13. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe koncepti i tij

Në një botë në ndryshim, ky mendim i ri aktual, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ka avantazhin për të ofruar shtigje të reja për vendimmarrësit për të eksploruar dhe ndezur debatin për atë zhvillim të qëndrueshëm që duhet të jetë. Tani që euroja është bërë realitet, Bashkimi Europian është më shumë se kurrë i prekur nga nevoja për t'u ofruar qytetarëve një lloj të zhvillimit i cili të mund të përmbushë nevojat e së tashmes, por pa komprometuar kapacitetin e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre. Kjo është për shkak se, ky mendim i ri ekonomik e vë qytetarin në qendër të vëmendjes për vendimmarrësit politikë.

Ekonomia e re që është duke u ndërtuar sot, është shumë ndryshe nga ekonomia e re pas krizës së viteve '30, sepse tenton të paraqesë ide të reja rreth asaj se si të organizojmë themelet e një ekonomie të qëndrueshme, në këtë çast kritik të historisë dhe kur ka shenja të qarta se ekonomia globale nuk mund të lëvizë drejt rritjes industriale, pa përfunduar në fatkeqësi totale. Zhvillimi i qëndrueshëm është përcaktuar në mënyra të ndryshme.

"Zhvillim i qëndrueshëm" është një term i përdorur gjerësisht nga politikanët në të gjithë botën, edhe pse nocioni është ende mjaft i ri dhe i mungon një interpretim uniform. Koncepti "zhvillim i qëndrueshëm" është ende duke u zhvilluar dhe përkufizimi i termit është vazhdimisht duke u rishikuar, zgjeruar. Zhvillimi i "qëndrueshëm" ndoshta mund të quhet ndryshe "i barabartë dhe i balancuar", që do të thotë se, në mënyrë që zhvillimi të vazhdojë pafundësisht, atë duhet ta balancojnë interesat e ndryshëm, si grupe njerëzish, brenda të njëjtit brez dhe në mesin e brezave; të jetë kështu njëkohësisht i stimuluar në tri fusha të mëdha të ndërlidhura me njëra-tjetrën, si: fushat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Pra, zhvillimi i qëndrueshëm është në lidhje me kapitalin e vet, i definuar si barazia e mundësisë për mirëqenien, si dhe për gjithëpërfshirjen e objektivave.

Ekonomia e re reflekton kërkesën në rritje në mbarë botën për mënyra të reja të jetës ekonomike, duke ruajtur Tokën dhe burimet e saj, dhe fuqizimin e njerëzve për të plotësuar nevojat e tyre dhe nevojat e të tjerëve. Në thelb, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është i ndërthurur me konceptin e kapacitetit bartës. Shqetësimet e ndryshme të shoqërisë sonë janë për shkak të veprimeve të pamatura të njerëzve për të ndihmuar qëndrueshmërinë. Zhvillimi i qëndrueshëm integron tre faktorë të rëndësishëm të qëndrueshmërisë: problemet ekonomike, sociale dhe mjedisore. Autori i mjedisit, Jonathon Porritt thotë:

*"Ekonomia është, në radhë të parë, një subsistem i shoqërisë njerëzore... i cili është në vetvete, në radhë të dytë, një subsistem i tërësisë së jetës në Tokë (biosferë). Dhe, nuk ka subsistem që mund të zgjerohet përtej kapacitetit të sistemit të përgjithshëm në të cilin ajo është pjesë".*

Ose ekonomisti i Bankës Botërore Amerikane Ekologjike, Herman Daly, i cili pyeti: *"Çfarë është një sharrë pa një pyll?"*

Karta e Tokës shkon përtej përcaktimit të qëndrueshmërisë, dhe kërkon të përcaktojë vlerat dhe drejtimin e nevojshëm për ta arritur atë: "Ne duhet të bashkohemi së bashku për të lindur një shoqëri të qëndrueshme botërore bazuar në respektin për natyrën, të drejtat universale të njeriut, drejtësinë ekonomike, kulturën dhe paqen. (*P. Soubbotina. Tatyana, The World Bank Washington, D.C. Beyond Ecnomic Growth: 8)*

### 3.14. Konkluzione

Ky kapitull ofroi informacion në lidhje me qytetin e Tiranës, si evoluoi në aspektin demografik, në aspektin e zhvillimit urban dhe në aspektin e ekonomisë. Në të u paraqitën të dhëna të ndryshme, që te planet urbane të viteve 1945-2015. Studimet që ishin kryer në Tiranë nga studio të ndryshme të huaja për qendrën e qytetit. U panë disa aspekte të zhvillimit, si: ndikimi i

ekonomisë, arsimimi, shëndetësia, Investimet e Huaja Direkte, sektori i ndërtimit etj. Ishte e nevojshme të bëhej një paraqitje historike kryesisht për qytetin që kemi marrë në studim.

# KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

## 4.1. Shfrytëzimi i kuadrit teorik në funksion të realizimit të studimit empirik

Teoritë mbi urbanizimin janë të shumta. Një pjesë e mirë e tyre është përfshirë në kuadrin teorik të këtij punimi. Megjithatë, në funksion të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave bazë të këtij studimi, vetëm një pjesë e kuadrit teorik do të shfrytëzohet në mënyrë më të detajuar, te pjesa e studimit empirik, mbledhjes, përpunimit dhe interpretimit të të dhënave. Konkretisht, çështjet kryesore të kuadrit teorik që do të shërbejnë si instrumente për të realizuar analizën e të dhënave empirike janë:

*Së pari*, pjesa e kuadrit teorik që shpjegon teoritë e urbanizimit përbën një nga elementët më të rëndësishëm në këtë punim.

*Së dyti,* lidhja që ekziston midis urbanizimit dhe ekonomisë. Kjo bën të mundur të realizohet pjesa e parë e studimit empirik, e cila ka të bëjë me identifikimin e faktorëve që ndikojnë te lidhja midis tyre. Ndërkohë, pjesa e dytë në kapitullin e tretë përqendrohet te qyteti i Tiranës dhe zhvillimi i tij.

Së treti, indikatorët e matjes së nivelit të urbanizimit do të jenë pjesë integrale e këtij studimi.

## 4.2. Burimet e informacionit

Rikujtojmë edhe një herë, se pyetjet kërkimore të këtij punimi janë:

1. *Në ç'mënyrë urbanizimi kontribuon në zhvillimin e një vendi?*
2. *A ekziston një lidhje midis urbanizimit dhe ekonomisë, dhe e anasjellta?*
3. *Si ndikojnë Investimet e Huaja Direkte në urbanizimin e një vendi?*

4. *Ku është më e lartë jetëgjatësia e banorëve, në zonat urbane apo në ato rurale?*
5. *Ku janë më të zhvilluara ndërmarrjet, në zonat urbane apo në ato rurale?*
6. *Rezultatet që do të arrijmë në këtë studim, a do të garantojnë suksesin e duhur në aspektin urbanistik?*

*Ndërkohë, hipotezat bazë të këtij studimi janë:*

*1. Rritja e shkallës së urbanizimit çon në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe anasjelltas.*

*2. Ndonëse janë zvogëluar hendeqet mbi stilin e jetesës midis fshatit dhe qytetit në Shqipëri, ekziston një epërsi në cilësisë e jetesës dhe në jetëgjatësinë e banorëve nëpër qytete.*

*3. Investimet e Huaja Direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në rritjen e urbanizimit në Shqipëri.*

*4. Konsumi i energjisë elektrike nuk ndikon pozitivisht në urbanizim dhe anasjelltas.*

Dy burimet kryesore të informacionit për testimin e këtyre hipotezave janë:

Fillimisht është bërë një rishikim intensiv i literaturës ekzistuese në lidhje me urbanizimin dhe zhvillimin. Më pas ai është zgjeruar me shqyrtimin e literaturës që trajton faktorët që ndikojnë në urbanizim. Të dhënat dytësore përfshijnë libra, artikuj, raporte etj. Bazuar në të dhënat dytësore, është zhvilluar një kuadër analitik për të analizuar urbanizimin dhe ndikimin në rritjen ekonomike, duke krijuar një model konceptual.

### 4.3. Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit

Ky punim ka karakter vlerësues. Metodat bazë sipas të cilave do të realizohet një analizë e tillë vlerësuese kanë të bëjnë me korrelacionin ndërmjet variablave si dhe analizën e regresionit. Të dhënat janë marrë nga *INSTAT-i dhe Banka Botërore* dhe i përkasin periudhës 2000-2014.

Ky material shërben për t'u dhënë një ilustrim të përgjithshëm analizës ekonometrike dhe metodologjisë së përdorur në këtë studim nëpërmjet programit "E-views".

*1. Generalized Method of Moments (GMM)*

Pika fillestare e vlerësimit të GMM-së është lidhja teorike që parametrat duhet të përmbushin. Ideja është zgjedhja e parametrave në mënyrë që lidhja teorike të përmbushet me afërsi sa të jetë e mundur. Lidhja teorike zëvendësohet nga pjesa tjetër homologe dhe vlerësimet janë zgjedhur për të minimizuar distancën midis vlerave teorike dhe atyre aktuale.

GMM është një vlerësues robust; ndryshe nga vlerësimi maksimal, nuk i nevojitet informacioni i distribucionit ekzakt. Në fakt, vlerësues të ngjashëm në econometrics mund të konsiderohen raste të veçanta të GMM-së. Lidhja teorike që parametrat duhet të përmbushin janë kushtet ortogonale midis disa funksioneve (mundësisht jolineare) të parametrave f ($(\theta)$_) dhe bashkësisë së variablave të ndryshëm.

$$E\left[f(\theta)' Z\right] = 0$$

Vlerësuesi GMM zgjedh vlerësimet parametër në mënyrë që korrelacionet mostër midis instrumenteve dhe funksionit f janë afër zeros ose sa më afër të jetë e mundur, të përcaktuara nga kriteri i funksionit:

$$J(\theta) = (m(\theta))' Am(\theta)$$

Ku m( $(\theta)$ ) = f ( $(\theta)$ )0 Z dhe A është matriksi i baraspeshës.

*1.1. J-statistik* është vlera e minimizuar e funksioneve objektive, ku raportohet (2) e ndarë nga numrat e observimit. J-statistics mund të përdoret për të nxjerrë teste hipotezash nga vlerësimi GMM. Një aplikim i thjeshtë i J-statistics është të testojë vlefshmërinë e kufizimeve të dallueshme.

Nën hipotezën e pavlefshme që kufizimet e dallueshme përmbushen, J-statistic shumëzim nimrin e regresioneve është asymptotically X (në katror) me grada lirie të barabarta me numrat e kufizuar të dallueshëm. Nëse ekuacioni përjashton instrumente të dyshimta, J-statistic do jetë zero.

*1.2. Koeficienti i përcaktimit* (R2) është një statistikë që do të japë disa informata në lidhje me të dhënat e modelit. Në regresion, koeficienti i përcaktimit është masa statistikore: ai tregon se sa mirë linja e regresionit mat në mënyrë reale datën e pikës. R2 nga formula 1 tregon se regresioni, linja është sipas të dhënave

*1.3. Koeficienti i determinacionit*

Koeficienti i përshtatur i determinacionit është modifikimi i R(në katror), i cili përshtatet për numrin e termave të shpjegueshëm në një model. Ndryshe nga R(në katror), R(në katror) e përshtatur rritet vetëm nëse termi i ri përmirëson modelin më shumë se do të pritej nga rastësia. R(në katror) mund të jetë negative(në ekuacione të varfra të regresionit) dhe do të jetë më pak ose e barabartë me R(në katror). Si e tillë, duhet të kujdesemi që të interpretohen dhe të raportohen statistikat.

R(në katror) e përshtatur është veçanërisht e përdorshme në zgjedhjen e tipareve të modeleve të ndërtimit. R(në katror) nuk është përherë më mirë se R(në katror): R(në katror) e përshtatur është llogaritur bazuar në një bashkësi, jo në tërë popullsinë. Për shembull, nëse njësia e analizës është një gjendje dhe ne kemi të dhëna për të gjitha qarqet, atëherë R(në katror) e përshtatur nuk do të nxjerrë më informacione sesa R (në katror).

*1.4. Vlera e variablës së varur është e mesmja e observimeve të variablës së varur*

*1.5. Vlera e S.D variables së varur është deviacioni standard i vlefshëm*

*1.6. S.E* e regresionit është masë përmbledhëse e sasisë së gabimeve të ekuacionit. Vlerësimi i paanshëm është i përllogaritur si rrënja katrore e shumës së katrorëve të mbetur pjesëtuar nga numrat e observimeve të përdorshme minus numrin e regresorëve. Kjo përllogaritje duhet të jetë afër zeros

*1.7. Shuma residuale e katrorëve është shuma e katrorëve të residualëve*

*1.8. Prob (F-statistic)*

Për të testuar suksesin e modelit të regresionit, mund të performojmë një test në R(në katror). Zakonisht, pranojmë që modeli i regresionit është i domosdoshëm kur Prob (F statistic) është më i vogël se niveli i dëshiruar, si për shembull 0.05.

*1.9. Statistika Durbin Watson*

Statistika Durbin Watson është një test statistik i përdorur për të gjetur autokorrelacionin e residualëve nga analiza regresive. Vlera e saj shkon nga 0 në 4. Vlera e 2-shit tregon që nuk paraqitet asnjë autokorrelacion. Nëse statistika Durbin-Watson është më pak se 2, ka evidencë të një korrelacioni serial pozitiv, dhe vlerat shumë më të larta se 2 janë tregues të korrelacionit

serial negativ. Nëse statistika Durbin Watson është më e vogël se 1.0, mund të paraqitet problem. Vlera të mëdha të statistikës Durbin-Watson tregojnë që termat suçesivë të gabuar janë të ndryshëm në vlerë nga njëri-tjetri, ose të lidhur negativisht. Sa më pak ose sipër 2-shit, është e nevojshme për kuptimin; varet nga numrat e observimeve të përdorshme dhe numrat e variablave të pavarur.

Testi i Durbin Watson përdoret për korrelacionet seriale të radhës së parë, në residualët e regresionit të serisë së kohës. Vlera e 2.0 për statistikën Durbin Watson tregon që nuk ekziston korrelacion serial, por ky rezultat është i vendosur drejt gjetjes që, nuk ekziston korrelacion serial.

**Augmented Dickey Fuller Test për Unit Root Test**

Për të trajtuar problemin e autokorrelacionit ka zhvilluar testin që quhet ADF, test i mbështetur në tri ekuacione ose modele kryesore si më poshtë:

<u>Modelet</u>

$\Delta Yt = B1 + ZYt\text{-}1 + ai + et$ (ekuacioni 1) - Vetëm me Intercept ose ka vetëm konstanten.

$\Delta Yt = B1 + B2t + ZYt\text{-}1 + ai + et$ (ekuacioni 2) – Me trend dhe me Intercept ose me konstante.

$\Delta Yt = ZYt\text{-}1 + ai + et$ (ekuacioni 3) - Pa trend dhe pa Intercept ose konstante.

<u>Hipoteza</u>

Hipoteza zero Ho: Variabli nuk është stacionar ose ka rrënjë, *unit root*

Hipoteza alternative H1: variabli është stacionar

Për të testuar nëse të dhënat ose variablat e disponueshëm për modelin janë stacionare apo jo do të përdorim testin ADF.

*1.10. Determinanti i kovariancës residuale*

Determinanti i kovariancës residuale është determinanti i kovariancës residuale. Nëse determinanti i kovariancës residuale të matriksit është zero, vlerat janë profiçente. Por, nëse një krahasim midis dy determinantëve të çdo kovariance residuale të matriksit tregon një vlerë >100 për VAR original dhe një vlerë afër zeros për log-VAR, atëherë një kovariancë e ndërlidhur lineare duket e papërshtatshme, vlera e zeros duhet të jetë nga kovariancat shumë të ulëta (por këto janë shkaktuar nga transformimet në njësitë-log dhe nuk duhet të bazohet në përmirësim real të modelit.

2. Maximum Likelihood Estimation është një metodë statistikore e njohur, e përdorur për të llogaritur mënyrën më të mirë për të përshtatur një model matematikor në disa të dhëna. Modelimi i të dhënave të botës reale duke përllogaritur ngjashmërinë maksimale, ofron një mënyrë për alterimin e parametrave të lirë të këtij modeli për të prodhuar një ngjashmëri optimale.

Ngjashmëria e funksioneve të log-ut janë bazat e vlerave të derivuara për parametrat, me datat e dhëna. Ndërkohë që, format e këtyre dy funksioneve janë të ndryshme, kanë pikë maksimale të së njëjtës vlerë. Në fakt, vlera e *p,* që korrespondon në këtë pikë maksimale, është përkufizuar si MLE. Kjo vlerë është pak a shumë relative me vlerat e tjera. Ky është një koncept i thjeshtë dhe ka cilësi statistike.

*2.1. Forma e ngjashmërisë së log-ut*

Forma e ngjashmërisë së log-ut është e rëndësishme në konceptim. Funksionet e ngjashmërisë së log-ut janë relativisht në të njëjtin nivel dhe mund të interpretohet që vlerat e p-së janë afërsisht të ngjashme. Ato janë relativisht të ngjashme. Kjo është shumuar si gabim në standard. Nëse funksioni i ngjashmërisë së log-ut është i të njëjtit nivel, kjo tregon paqartësi të konsiderueshme dhe është e reflektuar në erroret standarde.

Në anën tjetër, nëse funksioni i ngjashmërisë së log-ut është afër pikës maksimale, kjo tregon që disa vlera të *p-s*ë janë relativisht shumë të krahasueshme me njëra-tjetrën. Eshtë një gradë e qartësisë së konsiderueshme dhe është reflektuar në variancë dhe errore standarde. Funksioni i ngjashmërisë së log-ut në pikën maksimale është i rëndësishëm ashtu siç është forma e funksionit në pikën maksimale.

*2.2. Format e ngjashmërisë* së log-ut janë mundësia log (d.m.th. vlera maksimalisht të funksionit të ngjashmërisë së log-ut) pjesëtuar me numrin e vrojtimeve. Maksimizimi i formave të ngjashmërisë së log-ut është e njëjtë si në maksimizimin e mesatares së formave të log-ut. Kjo statistikë është e dobishme për të krahasuar modele.

*2.3. Informacioni akaik kriterion (AIC*) është një masë e mirësisë së një modeli statistikor të vlerësuar. Është e bazuar në konceptin e entropisë. AIC është një mënyrë operacionale e tregtimit të kompleksitetit vlerësuar në një model sipas të dhënave. Modeli i preferuar është ai me vlerën më të ulët AIC. Metodologjia AIC synon të gjejë modelin që shpjegon më mirë të dhënat në një minimum prej parametrave të lirë. Në të kundërt, qasja më tradicionale e modelimit fillon nga një hipotezë zero. AIC penalizon parametra të lirë në krahasim me kriterin Shvarc.

*2.4. Informacioni i kriterit Bayesian (BIC)* është një kriter statistikor për modelin e përzgjedhur. BIC është nganjëherë i quajtur edhe kriteri Shvarc, ose kriteri i Shvarc (SIC). Është quajtur

kështu për shkak të Gideon E. Shvarc (1978), i cili dha një argument Bayesian për adoptimin e tij. Duke pasur parasysh dy nga modelet e vlerësuara, modeli me vlerën më të ulët i BIC është më i preferuar.

BIC është një funksion në rritje i shumës së mbetur të shesheve dhe një funksion në rritje i numrit të lirë të parametrave që vlerësohen (për shembull, në qoftë se modeli i vlerësuar është regresion linear, ajo është numri i regresioneve duke përfshirë konstante).

Ky është një variacion i pashpjegueshëm në variablin e varur, është numri shpjegues i variablave konsevatorë të rritur në vlerën e BIC. BIC më i ulët nënkupton më pak variabla shpjegues të mirë ose të dyja. BIC penalizon parametrat e lirë më fort, se ka kriterin e informacionit akaik.

### *2.5. Informacioni i kriterit Hannan-Quinn*

Idealisht, AIC dhe SBIC duhet të jenë sa më të vegjël (vini re se të gjithë mund të jenë negativë). Në mënyrë të ngjashme, informacioni i kriterit i Hannan-Quinn (HQIC) duhet të jetë aq i vogël sa të jetë e mundur. Prandaj, modeli i zgjedhur duhet të jetë ai me vlerën më të ulët të kritereve të informacionit të testit.

### *2.6. Kovarianca e mbetur determinante*

Maksimizimi i ngjashmërisë së vlerës është ekuivalent me minimizimin përcaktues të matricës të mbetur së kovariancës. Kështu, përcaktues të mbetur të matricës kovariance nuk janë mbetjet e veta të minimizuara. Sa më e vogël si vlerë, aq më përcaktues i mirë do të jetë vlerësimi.

*3. Tabela përmbledhëse*

| Tipi | Optimalja | E pranueshmja |
|---|---|---|
| R(në katror) dhe vlera e rregulluar R katror | ---1 | > 0.8 |
| J-statistik | ---0 | <0.1 |
| Vlera e variablës së varur | ---- + ∞ | > 100 |
| S.E. e regresionit | ---0 | Zgjedhim vlerën më të ulët |
| Shuma residuale e vlerës | ---0 | Zgjedhim vlerën më të ulët |
| Prob (F statistik) | ---0 | <0.05 |
| Durbin Watson statistik | ---2 | 1.8<DW<2.2 |
| Kovarianca e mbetur determinante | ---0 | Zgjedh vlerën më të ulët |
| Forma e ngjashmërisë së log-ut | --- +∞ | >103 |
| Format e ngjashmërisë mesatare të log-ut | --- +∞ | >10 |
| AIC | -∞ | Zgjedh vlerën më të ulët |
| SIC | +∞ | Zgjedh vlerën më të ulët |
| HQIC | +∞ | Zgjedh vlerën më të ulët |

## 4.4. Përmbledhje e kapitullit

Kemi shpjeguar kështu pjesën e kuadrit teorik që është shfrytëzuar për këtë studim, metodologjinë e punimit, metodat dhe instrumentet e studimit. Gjithashtu, në këtë kapitull u shpjeguan burimet e informacionit, mënyra e mbledhjes së të dhënave. Ndërkohë, kapitulli vijues konsiston në analizën e të dhënave empirike dhe testimin e hipotezave të punimit.

# KAPITULLI V. ANALIZA DHE INTERPRETIME TË DHËNASH "QYTETI DHE EKONOMIA"

Në këtë kapitull do të trajtohen elementët që lidhin qytetin, në rastin konkret Tiranën, me zhvillimin ekonomik. Më konkretisht, objektivi ynë është që të vërtetohet një lidhje virtuoze midis urbanizmit dhe zhvillimit ekonomik.

Nga pikëpamja teorike, logjika e gjeografisë dhe e qytetit bazohet mbi mekanizmat e avantazheve krahasuese, që ka të bëjë me faktorët prodhues të një vendi, të cilët janë: kapitali dhe puna (Davis dhe Henderson, 2003).

Nëse do të përpiqeshim të shihnim me anë të dy hartave shpërndarjen gjeografike të banorëve në Bashkimin Evropian dhe shpërndarjen e aktiviteteve ekonomike në po të njëjtin territor, do të vinim re se ka një raport të qartë midis urbanizimit dhe zhvillimit ekonomik.

Figura 5.1. përfaqëson aktivitetet ekonomike, ndërsa figura 5.2. sqaron dendurinë e popullsisë për çdo rajon





Logjika e gjeografisë ekonomike bazohet në dy lloje forcash: forcat e shpërndarjes dhe ato të përqendrimit. Forcat e përqendrimit çojnë në përqendrimin e aktivitetit ekonomik, ndërsa ato të

shpërndarjes e bëjnë të leverdisshme largimin e ndërmarrjeve nga njëra-tjetra (Combes, Overman 2004).

*Forcat e shpërndarjes*

Çmimi i tokës përfaqëson një shembull domethënës dhe klasik të këtyre forcave, pasi çmimi i tokës është baza e çmimit të shtëpive, zyrave, magazinave dhe industrive. Çmimet më të larta ndodhen pikërisht në zonat urbane, dhe në rastin tonë në Tiranë. *Ceteris paribus* (duke mos ndryshuar faktorë të tjerë), firmat dhe punëtorët do të preferonin të vendoseshin në zona më pak të zhvilluara nga pikëpamja ndërtimore, pasi këto zona do të kishin edhe çmime më të ulëta. Elementët e tjerë të shpërndarjes janë hapësirat e mbipopulluara që krijohen në lagje të ndryshme të qytetit dhe degradojnë cilësinë e jetesës, duke rritur nivelin e stresit, ndotjen e ajrit dhe të burimeve ujore, si dhe ndotjen nga zhurmat.

Një tjetër forcë që duhet marrë parasysh është e ashtuquajtura forcë e konkurrencës lokale. Me këtë term nënkuptojmë faktin se, firmat dhe aktivitetet ekonomike kanë të gjitha interesat të ndërtohen dhe zhvillohen në vende ku ka sa më pak konkurrencë në aktivitetin e tyre. Në përpjekje për t'iu shmangur konkurrencës lokale, firmat shpërndahen gjeografikisht, me kushtin që, në pikat e shpërndarjes të ketë treg dhe të ketë rentabilitet në transportin e materialeve dhe shërbimeve drejt tregjeve të zotuara.

*Forcat e përqendrimit*

Këto lloj forcash krijohen kur përqendrimi i aktivitetit ekonomik në një zonë të caktuar inkurajon përqendrimin e mëtejshëm në një lidhje shkak-pasojë të ekonomisë. Ndodh që, për afërsinë ndaj tregut aktivitetet të përqendrohen në zona të caktuara. Shembull: në qytete ka aktivitete të shumta tregtare në fushën ushqimore, pasi ka më shumë banorë se në fshatra, ku një pjesë e

produkteve ushqimore mund të prodhohen në mënyrë vetiake. Një tjetër arsye përqendrimi është se firmat në qytete mund të gjejnë njerëz të kualifikuar dhe burime njerëzore të afta të përmbushin nevojat e firmës. Tjetër element që përforcon përqendrimin dhe krijon distrikte të specializuara industriale është kur secila firmë prodhon pjesë të një produkti përfundimtar dhe ka leverdi të transportit, burimeve njerëzore dhe të planifikimit të tij.

Shembull: në zonën Kamëz – Fushë-Krujë janë përqendruar 98 fabrika mobilierish, të cilat shfrytëzojnë një infrastrukturë të përbashkët dhe kompetencat e krahut vendas të punës.

Të tjera arsye që lidhen me forcat e përqendrimit janë: afërsia me institucionet dhe me shërbimet që ato japin, prezenca me aktivitete shërbimi në favor të aktiviteteve fillestare. Shembull: një ndërmarrje në një qytet të madh ka më shumë gjasa të gjejë një studio avokatie të mirë për ta mbrojtur nga pikëpamja ligjore, një sistem financiar me banka dhe shoqëri sigurimesh të shumta, të cilat mund të huazojnë kapitale për nevoja të ndryshme dhe ta mbrojnë nga risqet e aktivitetit ekonomik. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, infrastruktura rrugore, hekurudhore, portuale dhe aeroportuale është më e pranishme në qytetet e mëdha.

Infrastruktura është kusht jo thjesht për shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve (infrastruktura që ka lidhje me teknologjinë e informacionit), por është kusht edhe për furnizimin me lëndë të parë.

Në rastin konkret, Tirana është e lidhur me portin e Durrësit me anë të një autostrade dhe të një hekurudhe, si dhe lidhja me internetin nuk përbën problem për ndërmarrjet shqiptare. Pak kilometra në veriperëndim të qytetit ndodhet gjithashtu aeroporti i Rinasit, i cili ka lidhje ndërkombëtare pasagjerësh dhe mallrash.

Në dy hartat e mëposhtme kemi, në krahun e majtë një fotografi të Shqipërisë të marrë nga hapësira natën, ku shihet një vizë e hollë gjatë bregdetit dhe drita qendrore e Tiranës, që lidhet me qytetin e Durrësit dhe me aeroportin në veri.

Në pjesën e majtë, Tirana është e rrethuar nga shtiza të zeza, të cilat tregojnë infrastrukturën rrugore më të rëndësishme që çon drejt kryeqytetit, me germën **A** nënkuptojmë aeroportin dhe me germën **P** nënkuptojmë portin në Durrës.




Pas trajtimit teorik, objektivi ynë fillestar është të kuptojmë dhe provojmë nëse në Shqipëri dhe në qytetin e Tiranës kanë qenë më të forta forcat e shpërndarjes apo të përqendrimit të ndërmarrjeve.

Pas këtij elementi fillestar, do të shohim nëse ka një raport të dyfishtë dhe reciprok midis rritjes ekonomike dhe rritjes së urbanizimit. Do të zbulojmë gjithashtu, nëse popullsia në qytetet në Shqipëri gëzon një shëndet më të mirë në krahasim me atë në fshat, apo nëse në Tiranë ndotja ka

arritur nivele të tilla sa të shkurtojë jetën e qytetarëve në një masë më të ndjeshme në krahasim me popullsinë e fshatit.

Së fundmi, do të shohim lidhjet ekzistuese dhe ndërvepruese midis urbanizimit, Investimeve të Huaja Direkte, konsumit të energjisë elektrike dhe prezencës së ndërmarrjeve të mëdha e të vogla në raport me pjesën tjetër të vendit.

### 5.1. Urbanizimi dhe rritja ekonomike

Si element bazik dhe parësor vërtetues të epërsisë së forcave të përqendrimit është lidhja midis urbanizimit të Shqipërisë dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto. (Baldwin, Wyplosz, "The Economics of European Integration", 2012) .Të dhënat e analizuara janë marrë nga viti 1998 e më tej, si një tentativë për të gjetur lidhje në një vend paqësor, pa luftëra dhe trazira sociale, të cilat mundet të tjetërsojnë dhe të dizekuilibrojnë tendencat normale të ekonomisë dhe popullsisë. Gjatë viteve të analizuara, numri i shqiptarëve që banojnë në qytet është rritur, nga 1.270.214 banorë, në 1.632.744 banorë. Në të njëjtën kohë, Prodhimi i Brendshëm Bruto ka kaluar, nga 409 miliardë lekë në 13.9 miliardë lekë. Në të dyja rastet kemi një rritje që shkon drejt tendencave të ngjashme, por nevojitet një analizë shkencore për të vërtetuar konsistencën dhe efektin shkak-pasojë midis dy agregateve.

Tabela 5. 3. Vlerat ndër vite të Urbanizimit dhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto në Shqipëri

| Vitet | Urbanizmi | PBB |
|---|---|---|
| 1998 | 1270214 | 409208.000 |
| 1999 | 1279853 | 471578.000 |
| 2000 | 1289391 | 523043.400 |
| 2001 | 1298584 | 583368.600 |
| 2002 | 1327220 | 622710.800 |
| 2003 | 1354848 | 694097.500 |
| 2004 | 1381828 | 751021.600 |
| 2005 | 1407298 | 814796.700 |
| 2006 | 1430886 | 882208.800 |

| | | |
|---|---|---|
| 2007 | 1452398 | 967670.000 |
| 2008 | 1473392 | 1080675.900 |
| 2009 | 1495260 | 1143936.500 |
| 2010 | 1519519 | 1239644.600 |
| 2011 | 1546708 | 1300624.100 |
| 2012 | 1575836 | 1335488.300 |
| 2013 | 1604648 | 1350554.883 |
| 2014 | 1632744 | 1393539.899 |

Burimi: *INSTAT (2015)*

Grafiku 5.4. Urbanizimi dhe PBB në krahasim




Burimi: *INSTAT (2015)*

Duke marrë parasysh se krahasimi midis banorëve dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto të shprehur në lekë ka vështirësitë e veta, pasi dy agregatet nuk kanë të njëjtën njësi matëse, kemi marrë vitin 1998, si vit bazë për të krahasuar agregatet me veten e tyre nga viti në vit. Nga tabela rezulton se, popullsia në qytete është rritur me 28.5% nga viti 1998, ndërsa PBB-ja është rritur me 240.5% nga viti 1998.

Tabela 5.5. Evolucioni i Urbanizimit dhe PBB-së në krahasim me veten

| **Viti** | **Urbanizimi** | **PBB** |
|---|---|---|
| 1998 | 1 | 1 |
| 1999 | 1.008 | 1.152 |
| 2000 | 1.015 | 1.278 |
| 2001 | 1.022 | 1.426 |
| 2002 | 1.045 | 1.522 |
| 2003 | 1.067 | 1.696 |

| | | |
|---|---|---|
| 2004 | 1.088 | 1.835 |
| 2005 | 1.108 | 1.991 |
| 2006 | 1.126 | 2.156 |
| 2007 | 1.143 | 2.365 |
| 2008 | 1.160 | 2.641 |
| 2009 | 1.177 | 2.795 |
| 2010 | 1.196 | 3.029 |
| 2011 | 1.218 | 3.178 |
| 2012 | 1.241 | 3.264 |
| 2013 | 1.263 | 3.300 |
| 2014 | 1.285 | 3.405 |

Burimi: *INSTAT (2015),* Autori

Për të identifikuar vlerën e koeficientit të "përkthimit" të Urbanizimit është përdorur programi e-views dhe është analizuar regresioni nëpërmjet metodës së katrorëve minimalë (*Least Squares*). Dy variablat e analizuar në regresion janë, Urbanizimi (me akronim Urb) dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto (i cili specifikohet me akronimin PBB). Në këtë rast është marrë si variabël i varur Urb dhe variabël i pavarur vlera e PBB-së në lekë, nga viti 1998 deri në vitin 2014.

Hapi tjetër është interpretimi i rezultateve statistikore referuar vlerësimit të parametrave të analizuar nga programi.

Modeli i propozuar në këtë punim përfaqësohet nga ekuacioni i mëposhtëm:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 X_t + \varepsilon_t$$

Ku me $y_t$ (variabli i varur) shënojmë numrin e personave që banojnë në qytetet shqiptare në periudhën **t**, kurse me $x_t$ (variabli i pavarur) vlerën e Produktit të Brendshëm Bruto me çmime konstante për periudhën **t** të shprehur në lekë**.**

**<u>Hipoteza e ngritur</u> (H0) me anë të kësaj analize është se rritja e shkallës së urbanizimit çon në rritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe anasjelltas.**

Në regresionin e parë shohim se probabiliteti i koeficentit të variablit të pavarur (PBB) është 0.000, i cili është më i vogël se 5%. Ky rezultat do të thotë se variabli është sinjifikativ, pra kjo është një variabël i rëndësishëm për të shpjeguar variablin e varur (Urb). Në këtë rast variablat kanë një lidhje të drejtë me njëri-tjetrin, pasi shenja e koeficientit është pozitiv.

Gjithashtu, po të shohim **F-statistic,** rezulton (831.4486) me prob (F-statistic) =0.00000, një p-value <5%, që do të thotë se është domethënëse ose, e thënë ndryshe, F-statistic është sinjifikativ.

Dependent Variable: URB
Method: Least Squares
Date: 08/25/15 Time: 18:07
Sample: 1998 2014
Included observations: 17

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | 0.876070 | 0.009248 | 94.73085 | 0.0000 |
| PBB | 0.112240 | 0.003893 | 28.83485 | 0.0000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.982279 | Mean dependent var | 1.127176 |
| Adjusted R-squared | 0.981097 | S.D. dependent var | 0.093344 |
| S.E. of regression | 0.012833 | Akaike info criterion | -5.763388 |
| Sum squared resid | 0.002470 | Schwarz criterion | -5.665363 |
| Log likelihood | 50.98880 | Hannan-Quinn criter. | -5.753645 |
| F-statistic | 831.4486 | Durbin-Watson stat | 1.342193 |
| Prob(F-statistic) | 0.000000 | | |

Estimation Command:
=========================
LS URB C PBB

Estimation Equation:
=========================
URB = C(1) + C(2)*PBB

Substituted Coefficients:
=========================
URB = 0.876069586967 + 0.11223981862*PBB

**Hipoteza e ngritur H0 vërtetohet sipas ekuacionit të mëposhtëm.**

Nga regresioni rezultojnë vlerat e konstantes dhe të koeficentit të variablit të pavarur si dhe lidhje pozitive midis PBB-së dhe Urbanizimit.

**URB = 0.876069586967 + 0.11223981862*PBB**

**Sipas ekuacionit, rezulton se një rritje me 1% të Prodhimit të Brendshëm Bruto në Shqipëri shkakton një rritje prej rreth 0.11% të Urbanizimit.**

Kjo gjë do të thotë se, rritja ekonomike ka një lidhje të qartë me rritjen e qyteteve shqiptare, me në krye Tiranën. Sa më e fuqishme të jetë rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, aq më shpejt fshatrat shqiptare do të humbasin banorët e tyre dhe qytetet do të rriten.

Në rastin e mëposhtëm do të kërkojmë të verifikojmë edhe lidhjen e kundërt, që do të thotë se, nuk është vetëm rritja ekonomike që tërheq banorët drejt qyteteve, por edhe rritja e numrit të popullsisë në qytete i rrit ato si tregje, dhe kjo gjë shkakton nga ana e kërkesës krijimin e impulseve për rritje ekonomike. Rritja ekonomike mundet të provokohet edhe nga kompetencat dhe kapitalet që personat e transferuar në qytet mundet të vënë në përdorim.

**Në regresionin e dytë** kemi vendosur si variabël të varur Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa si variabël të pavarur është marrë Urbanizimi (Urb). Nga analiza rezulton se, probabiliteti i koeficientit të variablit të pavarur (Urb) është 0.000, i cili është më i vogël se 5%. Ky rezultat do të thotë se variabli është sinjifikativ. Gjithashtu, edhe në këtë model variablat kanë një lidhje të drejtë me njëri-tjetrin, pasi shenja e koeficientit është pozitive. **F-statistic** rezulton (831.4486) me prob (F-statistic) =0.00000, një p-value <5%, që do të thotë se është domethënëse ose, e thënë ndryshe, F-statistic është sinjifikativ. Në rastin konkret, treguesi Durbin Watson rezulton 0.540246, shumë larg nivelit optimal 2. Kjo gjë do të thotë se, analiza jonë dhe rezultati i saj nuk mundet të jetë plotësisht të besueshme, pasi midis variablave ka evidencë të një korrelacioni serial pozitiv.

Dependent Variable: PBB
Method: Least Squares
Date: 08/25/15 Time: 18:06
Sample: 1998 2014
Included observations: 17

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | -7.627371 | 0.343209 | -22.22367 | 0.0000 |
| URB | 8.751608 | 0.303508 | 28.83485 | 0.0000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.982279 | Mean dependent var | 2.237235 |
| Adjusted R-squared | 0.981097 | S.D. dependent var | 0.824243 |
| S.E. of regression | 0.113322 | Akaike info criterion | -1.407034 |
| Sum squared resid | 0.192629 | Schwarz criterion | -1.309008 |
| Log likelihood | 13.95979 | Hannan-Quinn criter. | -1.397290 |
| F-statistic | 831.4486 | Durbin-Watson stat | 0.7 40246 |
| Prob(F-statistic) | 0.000000 | | |

Estimation Command:
=========================
LS PBB C URB

Estimation Equation:
=========================
PBB = C(1) + C(2)*URB

Substituted Coefficients:
=========================
PBB = -7.62737138515 + 8.75160805487*URB

Nga kjo analizë rezulton se vlerat e konstantes dhe të koeficientit të variablit të pavarur si dhe ekziston një lidhje pozitive midis Urbanizimit dhe PBB-së.

**PBB = -7.62737138515 + 8.75160805487*URB**

**Sipas ekuacionit, rezulton se një rritje me 1% të Urbanizimit shkakton një rritje prej rreth 8.75% të Prodhimit të Brendshëm Bruto në Shqipëri.**

Nuk duhet harruar se treguesi Durbin Watson nuk na lejon të kemi plotësisht besim në këtë rezultat. Si pasojë mund të themi, se evidencat janë më pak të forta në krahasim me analizën e parë.




Nga grafiku i mësipërm mund të vërejmë, se rritja ekonomike, thënë ndryshe, Prodhimi i Brendshëm Bruto krijon një efekt tërheqës kundrejt banorëve të zonave rurale dhe i shtyn ata të transferohen në qytete. Nga investimet e brendshme ose të huaja krijohen vende të reja pune dhe lind nevoja për krah pune. Pjesa dominuese e investimeve kryhet në sektorin industrial dhe atë të shërbimeve, jo në sektorin bujqësor. Pikërisht këto janë arsyet fillestare se përse në qytete krijohen oportunitete të reja pune, pasi investimi në shërbime dhe aktivitete prodhuese nuk vendoset në fshatra, por në qendra urbane.

Ndërsa prezenca e tyre në qytete nuk është një garanci për rritje ekonomike. Është e vërtetë, nga një krah, se vendndodhja e re i detyron banorët të konsumojnë dhe të kryejnë aktivitetet normale të jetë së tyre në qytet, dhe kjo gjë rrit dimensionin e tregut të qytetit dhe kërkesën agregate që nga qyteti lind, por nga krahu tjetër, jo domosdoshmërisht banorët e rinj mund të kenë kompetenca profesionale që mund të sjellin një vlerë të shtuar të lartë dhe, nuk është e thënë që banorët e rinj të kenë kapitale të bollshme për të investuar në ekonominë e qyteteve ku ata rishtas banojnë. Në këtë aspekt, qytetet shqiptare, me Tiranën në krye, rrezikojnë të bëhen qendra parazitare dhe jo qytete që rriten nga bashkëpunimi virtuoz, midis investimeve që tërheqin popullsi dhe popullsisë që investon dhe krijon zhvillim.

*Shembull*: Revolucioni Industrial Anglez midis vitit 1780 dhe vitit 1860 krijoi kushtet për një rritje të popullsisë së Londrës, nga 1 milion banorë në 3.4 milionë banorë.

Një proces i ngjashëm ka ndodhur me Parisin, kryeqytetin e Francës. Në këto qytete investimet në aparatet prodhuese dhe shërbime tërhoqën nga fshatrat qindra-mijëra banorë ish-fermerë. Kompetencat profesionale të marra në qytet dhe një mjedis ekonomik liberal lejuan të ardhurit e rinj që në një kohë jo shumë të gjatë të kishin mundësi të investonin në të tjera aktivitete prodhuese dhe shërbimi, ose së paku të krijonin pronësi për banim personal (investim i cili influencon pozitivisht industrinë e ndërtimit dhe nënsektorët e vet). Në këto qytete u krijua qarku virtuoz ku, banorët e rinj me kalimin e viteve nuk ngelën thjesht krah pune, por patën mundësi të provonin fatin e tyre dhe të krijonin vlerë të shtuar të re.

Rasti i kundërt është ai i Napolit (Itali) ose i La Paz (kryeqyteti i Bolivisë).

Që prej fillimit të 1550-ës e deri në vitin 1650, Napoli ka qenë qyteti më i madh i gadishullit italian, duke pasur një popullsi nga 150 deri në 400 mijë banorë. Në këtë rast rritja e popullsisë nuk u shkaktua nga investime në aparatin prodhues, por për arsye se vendbanimi u bë kryeqytet dhe në të kryen një sërë investimesh në oborrin mbretëror dhe në urbanistikën e qytetit, shumica e popullsisë u tërhoq nga fshatrat drejt qytetit pa një planifikim, por në mënyrë të natyrshme, pasi situata shëndetësore paraqitej më mirë. Në këtë rast, banorët e rinj nuk kishin shpresa konkrete për të gjetur një punë të re dhe për t'u aftësuar profesionalisht, por thjesht shpresonin të largoheshin nga mizerja, drejt kushteve ekonomike më të mira.

Përfundimi është se, rrotull qendrës së qytetit lindën lagje të shumta të paplanifikuara, ku mbretëronin dukuri negative si prostitucioni dhe krimi. Në këtë rast, rritja e popullsisë nuk solli

rritje të zhvillimit ekonomik dhe investime nga popullsia e re, por qyteti u bë më pak premtues edhe për investitorët e jashtëm, pasi u krijua për të një famë e keqe.

Nuk ndryshon shumë rasti i La Paz në Bolivi, por këtaj radhe fenomeni është ripërsëritur në shekullin XX. Fatmirësisht, nuk u krijuan gjithë ato dukuri negative si në rastin e Napolit, por rrotull qytetit origjinal, qendër shërbimesh dhe jo qendër prodhimi, u krijuan një sërë lagjesh, në të cilat banonin njerëz që bënin punë të rastësishme, pak të kualifikuara dhe jo të qëndrueshme. Këto dy raste tregojnë qartazi, se investimi fillestar në favor të përmirësimit të kushteve të qytetit dhe në favor të zgjerimit të tij urban, nuk ndiqen domosdoshmërisht nga një valë e dytë zhvillimi të provokuar nga rritja demografike.

Natyrshëm lind pyetja, nëse Tirana është pjesë e modelit zhvillimor të ngjashëm me rastet e Londrës dhe Parisit, apo nëse po ndjek dinamikën e Napolit dhe La Paz. Nga analiza fillestare rezulton se, ashtu siç pritej, rritja ekonomike ka sjellë një zgjerim të urbanizimit, por nuk mundet të jemi të sigurt mbi një raport reciprok, pasi siç rezulton nga analiza e dytë, rezultatet e modelit nuk janë aq bindëse sa në analizën e parë. Një shtjellim i mëtejshëm i përgjigjes do të jepet në pikën e tretë të këtij kapitulli.

### 5.2. Urbanizimi dhe cilësia e jetës

Në këtë pjesë të dytë të kapitullit do të vendosim theksin mbi raportin frytdhënës midis urbanizimit dhe rritjes së jetëgjatësisë të komunitetit që banon në qytet. Elementi dallues të rritjes së cilësisë së jetesës në qytete në krahasim me popullsinë që banonte në fshat, ka qenë fillimi i veprave të kanalizimeve në qytete dhe sistemimi dhe ndarja e ujërave të zeza nga ujërat e bardha, vendosja në çdo shtëpi të tualeteve dhe pajisja me ujë të rrjedhshëm. Këto elemente kanë

rritur ndjeshëm nivelin e pastërtisë së banorëve që kanë jetuar në qytet, duke zbutur ndjeshëm infeksionet dhe sëmundjet e ndryshme ngjitëse dhe vdekjeprurëse.

Një element i dytë epërsie është i përbërë nga fakti se, nëpër qytete normalisht grumbullohen produkte të ndryshme bujqësore, të cilat mund të blihen nga qytetarët në shumëllojshmërinë e tyre. Në këtë mënyrë banori i një qyteti mund të zgjedhë ato produkte të cilat rrisin jo thjesht shijen, por edhe shëndetin e blerësit, ndryshe nga popullsia rurale, e cila shpeshherë është e detyruar të konsumojë vetëm ato produkte që vetëprodhonte. Sistemi imunitar i popullsisë rurale si pasojë, është më i dobël dhe i paqëndrueshëm ndaj sulmeve infektive të baktereve dhe virozave. Në mënyrë të drejtëpërdrejtë, të gjitha qendrat shëndetësore, si spitale, klinika, ambulanca dhe farmaci, janë vendosur dhe hapur së pari në qendrat e mëdha urbane, për t'i shërbyer një numri të gjerë personash.

Në këtë mënyrë, popullsia urbane ka të gjithë mundësinë për të kryer kontrolle të vazhdueshme mbi shëndetin e vet, mundësi konkrete për t'u kuruar, dhe ka strukturat spitalore në dispozicion në një distancë të vogël në momentet e nevojës. Popullsia rurale historikisht është detyruar të shkojë në qytetin më të afërt për të kryer shërbimet shëndetësore, por kjo gjë për të është më e kushtueshme dhe më e vështirë për t'u realizuar në kohë.

Prezenca e një sistemi infrastrukturor të dendur dhe shpeshherë cilësor (rrugë, trotuare, shërbim transporti publik me autobusë, tramvaj, metropolitanë), si dhe struktura pune më të mbrojtura (zyra dhe mjedise të mbyllura dhe të kondicionuara), u lejojnë banorëve të qyteteve të lëvizin drejt destinacioneve të punës dhe të argëtimit në mënyrë të shpejtë, pa rreziqe që burojnë nga ndryshimi i motit. Popullsia rurale, në pjesën e saj më të madhe merret me bujqësi dhe, si pasojë, rruga drejt vendit të punës nuk është e shërbyer nga një infrastrukturë e veçantë dhe puna në

vetvete është në qiell të hapur, veç rasteve të rralla, tërësisht e varur nga ndryshimet meteorologjike.

*5.2.1. Urbanizimi dhe jetëgjatësia në Shqipëri*

Shqipëria gjatë shekullit të saj të pavarësisë ka përfaqësuar në mënyrë tipike vendin agrar, ku 80% e popullsisë merrej me aktivitet bujqësor, sipas censusit të kryer në vitin 1937. Ndonëse kanë kaluar shumë vite dhe vendi ynë ka pësuar ndryshime të thella, me ndërtimin e komplekseve industriale dhe rritjen e aktiviteteve të shërbimeve, deri në vitin 1989 ende 60% e krahut të punës në Shqipëri merrej me aktivitete bujqësore. Ia vlen për t'u theksuar që, sidomos gjatë viteve '80 popullsia rurale ka përballuar sakrifica të rënda për mbijetesën e vet, pasi ishte e kushtëzuar dhe ndonjëherë e detyruar të konsumonte vetëm bukë misri, në mangësi të grurit, që duhej të shkonte për banorët e qyteteve. Gjendja e fshatrave shqiptare ka qenë edhe më e keqe, nëse do të merrnim parasysh faktin që në Shqipëri deri në vitin 1990 ishin të asfaltuara vetëm 2.800 km rrugë dhe ekzistonin rreth 600 km hekurudhë funksionale. Nga këto shifra mund të kuptojmë, se me vështirësi asfalti lidhte qytetet shqiptare, dhe ishin vërtet të pakta qendrat e banuara në fshat të cilat mund të përdornin rrugë automobilistike për të shkuar në qytetin më të afërt dhe për të marrë shërbime mjekësore më të specializuara.

Gjatë viteve '90, me rënien e regjimit komunist u trondit thellë edhe struktura demografike e Shqipërisë. Banorët e fshatrave dhe qyteteve emigruan jashtë vendit, pa dallim vendbanimi, zone, feje, gjinie dhe moshe. Vetëm me fillimin e mijëvjeçarit të ri, me vështirësi u arrit një ekuilibër i përkohshëm, me një tendencë të qartë që tregon se, në mënyrë konstante, popullsia në qytetet shqiptare, duke filluar nga Tirana rritet, ndërsa në zonat rurale ajo vazhdon të ulet jo vetëm në përqindje ndaj totalit, por edhe në vlera absolute. Me kalimin e viteve, infrastruktura

fizike dhe ajo informatike në Shqipëri janë përmirësuar, dhe në këtë mënyrë janë ulur distancat dhe diferencat në stilin e jetesës midis qytetit dhe fshatit.

**Hipoteza e parashtruar në këtë pjesë është se, ndonëse janë zvogëluar hendeqet mbi stilin e jetesës midis fshatit dhe qytetit në Shqipëri, ekziston një epërsi në cilësisë e jetesës dhe në jetëgjatësinë e banorëve nëpër qytete.**

Në vitin 2001, nga rreth 1.3 milion banorë të cilët popullonin qytetet shqiptare, vetëm 63.500 nga këta, ose 4.91% të totalit tejkalonin moshën 70 vjeç. Norma e personave që tejkalojnë vijën e moshës 70 vjeç është rritur vazhdimisht gjatë viteve deri në vitin 2014, ku nga 1.65 milion qytetarë që ka Shqipëria, rreth 140 mijë, ose 8.56% janë më shumë se 70 vjeç. Rritja e popullsisë në moshë të tretë nga viti 2001 deri në vitin 2014 është rritur me 77.746 persona, ose me 3.56 % të popullsisë.

Nga këto të dhëna duket qartë, se numri i personave të moshës së tretë jo thjesht është rritur në vlera absolute, por edhe ndaj totalit të popullsisë. Mund të themi edhe pa një analizë fillestare, se zgjerimi i jetëgjatësisë në qytetet shqiptare është një fakt me të dhëna të qarta. Hapet këtu një çështje e lidhur me faktin se, edhe në zonat rurale pritet një rritje e numrit të personave që tejkalojnë moshën 70 vjeç. Vetëm nëse normat e jetëgjatësisë në qytetet shqiptare tejkalojnë në rritjen e tyre normat e rritjes së jetëgjatësisë në zonat rurale, do të kemi të provuar një epërsi të një cilësie të jetës më të lartë në qytete.

Tabela 5.6. Urbanizimi në Shqipëri

| Viti | Pop urbane | Mbi 70 | Norma |
|---|---|---|---|
| **2001** | 1293549 | 63532 | 4,91% |
| **2002** | 1326834 | 67655 | 5,10% |
| **2003** | 1355148 | 72463 | 5,35% |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **2004** | 1383149 | 77731 | 5,62% |
| **2005** | 1410807 | 83920 | 5,95% |
| **2006** | 1436663 | 90741 | 6,32% |
| **2007** | 1460745 | 97456 | 6,67% |
| **2008** | 1484218 | 103918 | 7,00% |
| **2009** | 1506881 | 110895 | 7,36% |
| **2010** | 1529906 | 118808 | 7,77% |
| **2011** | 1552709 | 126730 | 8,16% |
| **2012** | 1575566 | 134790 | 8,56% |
| **2013** | 1615832 | 138233 | 8,55% |
| **2014** | 1651402 | 141278 | 8,56% |

Burimi: *INSTAT (2015)*

Në regresionin e parë do t'i lidhim dy variablat duke u bazuar te vlerat e tyre origjinale. Në regresionin e mëposhtëm do të marrim si variabël të varur numrin e popullsisë urbane (i cili specifikohet në model me akronimin POP), ndërsa si variabël të pavarur moshën e popullsisë urbane (mbi 70 vjeç) në Shqipëri nga viti 2001 deri në vitin 2014.

Nga regresioni shohim se probabiliteti i variablit të pavarur (POP) është 0.000, i cili është më e vogël se 5%. Ky rezultat do të thotë se variabli është sinjifikativ. Ky është një variabël i rëndësishëm për të shpjeguar variablin e varur (moshën). Në këtë rast variablat kanë një lidhje të drejtë me njëri-tjetrin pasi, shënja e koeficientit është pozitiv.

Gjithashtu, po të shohim **F-statistic,** rezulton (686.1056) me prob (F-statistic) =0.00000, një p-value <5%, që do të thotë se është domethënëse ose, e thënë ndryshe, F-statistic është sinjifikative. Kurse vlera e Durbin Watson stat rezulton 1.722, e cila është mjaft afër vlerës optimale që është koeficienti 2, ku kjo vlerë tregon se nuk ka evidencë të një autokorrelacioni midis variablave.

Adjusted R-katror rezulton në nivelin 98%, që do të thotë se shpjegueshmëria e modelit është mjaft e lartë.

Dependent Variable: MOSHA
Method: Least Squares
Date: 08/29/15 Time: 14:52
Sample: 2001 2014
Included observations: 14

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | -259615.4 | 13841.06 | -18.75691 | 0.0000 |
| POP | 0.245963 | 0.009390 | 26.19362 | 0.0000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.982811 | Mean dependent var | 102010.7 |
| Adjusted R-squared | 0.981378 | S.D. dependent var | 27036.64 |
| S.E. of regression | 3689.469 | Akaike info criterion | 19.39592 |
| Sum squared resid | 1.63E+08 | Schwarz criterion | 19.48721 |
| Log likelihood | -133.7714 | Hannan-Quinn criter. | 19.38747 |
| F-statistic | 686.1056 | Durbin-Watson stat | 1.722880 |
| Prob(F-statistic) | 0.000000 | | |

Estimation Command:
=========================
LS MOSHA C POP

Estimation Equation:
=========================
MOSHA = C(1) + C(2)*POP

Substituted Coefficients:
=========================
MOSHA = -259615.406359 + 0.245963420784*POP

Nga regresioni rezultojnë vlerat e konstantes dhe të koeficientit të variablit të pavarur si dhe ekzistenca e lidhjes pozitive midis numrit të popullsisë urbane me numrin e personave që kanë tejkaluar moshën 70 vjeç si tregues jetëgjatësie.

**MOSHA = -259615.406359 + 0.245963420784*POP**

**Sipas ekuacionit, rezulton se një rritje me 1% të numrit të personave që banojnë në qytetet shqipëtare, shkakton një rritje prej rreth 0.246% të personave që tejkalojnë moshën 70-vjeçare.**

*5.2.2 Jetëgjatësia në zonat rurale*

Në vitin 2001 shumica e popullsisë shqiptare ka banuar në fshatra. Nga rreth 1.770 mijë banorë, vetëm 78 mijë persona ose 4.4% të totalit kanë tejkaluar moshën 70 vjeç. Ka pasur përmirësime infrastrukturore të ngadalta, por të vazhdueshme në fshatrat shqiptare, siç ka qenë shtrimi i rrugëve. Nga 387 komuna, vetëm 296 kanë qenë të lidhura me asfalt në fillim të vitit 2013, ndërsa në vitin 2009 komunat e lidhura me rrugë ishin 198. Nëse do shkonim deri në vitin 2005, qendrat administrative në të cilat kalonte asfalti nuk ishin më shumë se 145. Ndërtimi i ujësjellësve ka qenë një tjetër pikë domethënëse që ka ndihmuar dhe lehtësuar nivelin e pastërtisë së zonave rurale, ndërsa shtrimi i fibrave optikë ka lejuar që edhe familjet të cilat nuk banojnë në qytete të shfrytëzojnë informacionet e shumta që vijnë nga përdorimi i internetit dhe nga mjetet e tjera të telekomunikacionit.

Numri i banorëve të zonave rurale për vitin 2014 ka rënë në më pak se 1.250 mijë persona, ndërsa banuesit me më shumë se 70 vjeç kanë arritur kuotën e gati 100 mijë personave. Kjo gjë do të thotë se, rreth 7.9% të banorëve të fshatrave shqiptare kanë tejkaluar moshën 70 vjeç. Rritja e personave mbi moshën 70 vjeç në vlerë absolute ka qenë prej 20.403 njësish ose, thënë ndryshe, rreth 3.5% të totalit.

Nga këto shifra mund të konstatojmë se edhe në zonat rurale është rritur cilësia e jetës, por, a mjaftojnë këto shifra për të përmbushun hendekun me të dhënat e qyteteve? Nga të dhënat e analizuara rezulton se në qytetet shqiptare, personat mbi 70 vjeç në periudhën kohore 2001 – 2014 janë rritur, nga 4.91% në 8.56% të totalit të popullsisë, me një shtesë prej 3.64%, ndërsa në zonat rurale popullsia e moshës së tretë, në po të njëjtën periudhë kohore, është rritur, nga 4.42% në 7.92%, me një shtesë prej vetëm 3.5%.

**Duke marrë parasysh këto rezultate, mund të themi se në qytetet shqiptare, duke filluar nga Tirana, cilësia e jetesës (e shprehur me treguesin e jetëgjatësisë mbi 70 vjeç) është më e lartë në krahasim me rritjen e jetëgjatësisë në zonat rurale.**

Tabela 5.7. Popullsia rurale në Shqipëri

| Viti | Pop rurale | Mbi 70 | Norma |
|---|---|---|---|
| **2001** | 1769771 | 78166 | 4,42% |
| **2002** | 1730184 | 78188 | 4,52% |
| **2003** | 1689845 | 78338 | 4,64% |
| **2004** | 1651082 | 78497 | 4,75% |
| **2005** | 1608827 | 78290 | 4,87% |
| **2006** | 1566666 | 80218 | 5,12% |
| **2007** | 1521010 | 81010 | 5,33% |
| **2008** | 1474048 | 81290 | 5,51% |
| **2009** | 1429474 | 82328 | 5,76% |
| **2010** | 1388768 | 82569 | 5,95% |
| **2011** | 1354652 | 86004 | 6,35% |
| **2012** | 1326624 | 85827 | 6,47% |
| **2013** | 1282950 | 93551 | 7,29% |
| **2014** | 1244544 | 98569 | 7,92% |

Burimi: *INSTAT (2015)*

Në regresionin e dytë do t'i lidhim dy variablat duke u bazuar te vlerat e tyre origjinale. Në modelin e dytë marrim si variabël të varur numrin e popullsisë rurale (i cili specifikohet në model me akronimin PRUR), ndërsa si variabël të pavarur moshën e popullsisë rurale mbi 70 vjeç (me akronimin MRUR) në Shqipëri nga viti 2001 deri në vitin 2014.

Nga regresioni rezulton se probabiliteti i variablit të pavarur (PRUR) është 0.0001, i cili është më i vogël se 5%. Ky rezultat do të thotë se variabli është sinjifikativ, variabël ky i rëndësishëm për të shpjeguar variablin e varur (mrur). Në këtë rast variablat kanë një lidhje të zhdrejtë me njëri-tjetrin, pasi shenja e koeficientit është negative.

Gjithashtu, po të shohim F-statistic, rezulton (32.28873) me prob (F-statistic) =0.000102, një p-value <5%, që do të thotë se është domethënës ose, e thënë ndryshe, F-statistic është sinjifikativ.

Kurse vlera e Durbin Watson stat rezulton 1.530, i cili, ndonëse në limitet e veta, është i pranueshëm si tregues. Adjusted R squared rezulton në nivelin 70.6%, që do të thotë se shpjegueshmëria e modelit është mjaft e lartë.

Dependent Variable: MRUR
Method: Least Squares
Date: 08/29/15 Time: 14:53
Sample: 2001 2014
Included observations: 14

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | 129276.6 | 8182.436 | 15.79928 | 0.0000 |
| PRUR | -0.030755 | 0.005412 | -5.682317 | 0.0001 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.729051 | Mean dependent var | 83060.36 |
| Adjusted R-squared | 0.706472 | S.D. dependent var | 6180.998 |
| S.E. of regression | 3348.757 | Akaike info criterion | 19.20213 |
| Sum squared resid | 1.35E+08 | Schwarz criterion | 19.29342 |
| Log likelihood | -132.4149 | Hannan-Quinn criter. | 19.19368 |
| F-statistic | 32.28873 | Durbin-Watson stat | 1.530764 |
| Prob(F-statistic) | 0.000102 | | |

Estimation Command:
=========================
LS MRUR C PRUR

Estimation Equation:
=========================
MRUR = C(1) + C(2)*PRUR

Substituted Coefficients:
=========================
MRUR = 129276.586455 - 0.0307545168083*PRUR

Nga regresioni rezulton se në këtë rast do të kemi një lidhje jopozitive midis variablit të varur dhe atij të pavarur, pra midis numrit të popullsisë rurale me numrin e personave që kanë tejkaluar moshën 70 vjeç (të cilët banojnë në fshat) si tregues jetëgjatësie.

**MRUR = 129276.586455 - 0.0307545168083*PRUR**

**Sipas ekuacionit, rezulton se një ulje me 1% të numrit të personave që banojnë në fshatrat e Shqipërisë, shkakton një rritje prej rreth 0.03% të personave që tejkalojnë moshën 70-vjeçare.**

Rezultatet e mësipërme, të cilat tregojnë se në qytetet shqiptare rritja e jetëgjatësisë është më e shpejtë se në fshatra, nuk duhen marrë si të mirëqena dhe të përhershme. Nga pikëpamja teorike, mund të ndodhë që, me zhvillimin e dimensioneve të qyteteve cilësia e jetës të fillojë një kurbë rënëse, për arsye të ndotjes atmosferike, e cila godet më shumë popullsinë e qyteteve sesa banorët e fshatrave, siç duket në grafikun e mëposhtëm.

Në qytet rritja e numrit të makinave dhe e trafikut lëshon gazra të dëmshëm për mushkëritë dhe shëndetin, uji i rubinetit mund të pësojë ndotje si pasojë e një rrjeti të gjerë shpërndarës, zhurmat me decibel të larta mund të dëmtojnë dëgjimin dhe trurin e njeriut, rrymat elektromanjetike të pajisjeve të komunikimit dhe elektroshtëpiaket përçojnë rreze të rrezikshme për njeriun, aktivitetet industriale (sidomos të industrisë së rëndë) shkarkojnë gazra të dëmshëm, gjendja e pastërtisë në rrugët e qyteteve dhe në qendrat e grumbullimit të mbetjeve urbane mund të dëmtojnë rëndë shëndetin.

Këta faktorë si dhe elementë të tjerë dytësorë, mund të kompensojnë dhe të konsumojnë efektin pozitiv të shërbimeve shëndetësore dhe infrastrukturore që qytetet kanë. Nuk është e pamundur, përkundrazi, që të arrihet pika A (në grafikun nr. 5.8.), ku jetëgjatësia në qytete ulet në krahasim me atë të zonave rurale, si pasojë e ndotjes. Në pikën B, duket edhe efekti që ndotja mund të ketë mbi vetë banorët e zonave rurale, pasi disa burime të ndotjes shkaktojnë fenomene atmosferike globale, por në këtë rast, efektet mbi jetëgjatësinë mbi zonat rurale do të ishin më të reduktuara.

Grafiku 5.8. Evolucioni i jetëgjatësisë në raport me ndotjen




Burimi: Autori

Pika A duhet thënë se nuk është fikse, sepse efektet e ndotjes mundet të zbuten dhe të shtyhen në kohë si pasojë e masave të marra nga qeverisja vendore. Për shembull, zgjerimi i infrastrukturës rrugore i lë më pak kohë automjetet në trafik dhe zvogëlon shkarkimin e gazrave të dëmshëm. Krijimi i linjave elektrike të tramvaj dhe të metropolitanave nëntokësore, reduktojnë ndjeshëm trafikun rrugor dhe me të reduktojnë shkarkimet e gazrave. Diferencimi i mbetjeve urbane dhe ripërdorimi i tyre zvogëlon ndjeshëm sasitë e mbeturinave në vendgrumbullime. Subvencionet mbi filtrat e pastrimit të industrisë së rëndë ulin ndotjen e ajrit. Restaurimi periodik i rrjetit të ujësjellësit me materiale të reja zvogëlon mundësitë e ndotjes së ujit etj.

**Në rastin e Tiranës dhe të qyteteve të tjera shqiptare, një pjesë e mirë e këtyre masave nuk janë marrë, por duhet të themi gjithashtu se Shqipëria gjendet në atë pikë të grafikut ku në mënyrë të natyrshme ende nuk është kapur pika A dhe ku jetëgjatësia në qytete vazhdon të rritet më shumë se në zonat rurale.**

### 5.3. Investimet dhe Rritja Ekonomike

Arsyeja përse kemi huazuar treguesin e Investimeve të Huaja Direkte si një faktor zhvillimi ekonomik dhe urban është, pasi rasti tipik dhe gati unikal i Shqipërisë na e lejon këtë përshtatje.

Kjo për arsye se, nga viti në vit, Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri janë të përqendruara në më shumë se 99% të vlerës së tyre në fusha jobujqësore (shih tabelën nr.1 në Apendiks).

Thënë ndryshe, më pak se 1% të IHD-ve në Shqipëri përqendrohen në peshkim, ndërhyrje në prodhimin bujqësor, mirëmbajtjen e pyjeve etj. Pikërisht për këtë arsye, analiza e IHD-ve në raport me PBB-në na jep një tregues të qartë mbi efektet që Investimet e Huaja Direkte kanë jo thjesht mbi zhvillimin ekonomik, por edhe mbi urbanizimin në vendin tonë. Investimet ose IHD-të përqendrohen në fushat e industrisë dhe shërbimeve, fusha të cilat shtrijnë aktivitetin e tyre dhe zhvillohen të lidhura ngushtësisht me mjedisin urban dhe qytetar.

Në këtë pjesë do të analizohet lidhja midis Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Investimeve të Huaja Direkte.

Regresioni do të realizohet duke u bazuar te seritë kohore vjetore të PBB-së si dhe të IHD-ve për rastin e Shqipërisë. Objektivi është që, me anë të regresionit të vlerësojmë ndikimin që IHD-të kanë në rritjen ekonomike dhe si pasojë në rritjen e urbanizimit në Shqipëri.

Tabela 5.9. Vlera e Investimeve të Huaja Direkte dhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto (në USD) në Shqipëri.

| Vitet | IHD | PBB |
|---|---|---|
| **2000** | 143000000 | 3686649387 |
| **2001** | 207300000 | 4091020249 |
| **2002** | 135000000 | 4449373455 |
| **2003** | 178036401 | 5652325082 |
| **2004** | 341285113 | 7464446950 |
| **2005** | 262479013 | 8376668352 |
| **2006** | 325138317 | 9132558097 |
| **2007** | 652275604 | 10701011524 |
| **2008** | 1240972849 | 12881353508 |
| **2009** | 1343091150 | 12044208086 |
| **2010** | 1089416366 | 11926957255 |
| **2011** | 1049425306 | 12890866743 |

| | | |
|---|---|---|
| **2012** | 920080650 | 12344529628 |
| **2013** | 1253783309 | 12916669736 |
| **2014** | 1161188212 | 13370191506 |

Burimi: *Banka Botërore (2015)*

Janë të disponueshme në shumë databaza ndërkombëtare të dhënat për Investimet e Huaja Direkte dhe Prodhimin e Brendshëm Bruto në Shqipëri që prej vitit 1992. Arsyeja për të cilën kemi zgjedhur të marrim të dhënat vetëm pas vitit 2000 e tej është sepse, në periudhën 1992 - 1995 IHD-të në Shqipëri jepnin një kontribut tepër të vogël për të dalluar një influencë të qartë mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto.

Me trazirat e viteve 1997 - 1998 kemi luhatje të mëdha, qoftë të IHD-ve, qoftë të PBB-së. Për këto arsye nuk mund të kryhej një analizë sasiore domethënëse e impaktit të Investimeve të Huaja Direkte në rritjen ekonomike shqiptare para shekullit të ri.

Grafiku 5.10. Vlera e IHD-ve dhe e PBB-së ndër vite në Shqipëri.







Burimi: *Banka Botërore (2015)*

Siç duket qartazi nga grafiku i mësipërm, vetëm pas vitit 2006 Investimet e Huaja Direkte kanë pasur një evolucion gati shpërthyes nga pikëpamja e rritjes së tyre, ndonëse edhe pas vitit 2007 ka pasur luhatje jo të pakta në evolucionin e tyre. Dinamika e IHD-ve ka qenë mjaft e luhatshme dhe volatiliteti shprehet qartë në grafikun e mëposhtëm, ku nga viti në vit, IHD-të në Shqipëri

janë rritur me norma mjaft të larta si dhe kanë pësuar ulje po aq të befta. Nëse do të shikonim evolucionin e PBB-së, ky paraqitet si një tregues mjaft më i qëndrueshëm, stabël, dhe me rritje të kontrolluar e të vazhdueshme.

Kjo ndodh sepse Investimet e Huaja Direkte janë vetëm një pjesë e vogël e Prodhimit të Brëndshem Bruto, i cili përbën një nivel midis 5 - 10 % të PBB-së dhe, në këtë mënyrë, volatiliteti i IHD-ve përthithet dhe zbutet nga një agregat 10 - 20 herë më i madh, që është Prodhimi i Brendshëm Bruto.

Grafiku 5.11. Evolucioni nga viti në vit i rritjes së IHD-ve dhe PBB-së




Burimi: *Banka Botërore (2015)*

Për të identifikuar vlerën e koeficientit të "përkthimit" të Investimeve të Huaja Direkte është përdorur programi e-views dhe është analizuar regresioni nëpërmjet metodës së katrorëve minimalë (*Least Squares*). Dy variablat e analizuar në regresion janë Prodhimi i Brendshëm Bruto (i cila specifikohet me akronimin PBB ) dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD). Në këtë rast është marrë si variabël i varur PBB dhe variabël i pavarur vlera e IHD-ve në rastin e

Shqipërisë, nga viti 2000 deri në vitin 2014. Hapi tjetër është interpretimi i rezultateve statistikore referuar vlerësimit të parametrave të analizuar nga programi.

Modeli i propozuar në këtë punim përfaqësohet nga ekuacioni i mëposhtëm:

$$Y_t = \beta_0 + \beta_1 X_t + \varepsilon_t$$

Ku me $y_t$ (variabli i varur) shënojmë vlerën e Produktit të Brendshëm Bruto me çmime konstante për periudhën **t**, kurse me $x_t$ (variabli i pavarur) vlerën e IHD -vë të shprehur në dollar për periudhën **t.**

**<u>Hipoteza e ngritur</u> (H0) me anë të kësaj analize është se Investimet e Huaja Direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në rritjen e urbanizimit në Shqipëri.**

**Në regresionin e parë** do t'i lidhim dy variablat duke u bazuar te vlerat e tyre origjinale. Nga regresioni shohim se probabiliteti i variablit të pavarur (IHD) është 0.000, i cili është më i vogël se 5%. Ky rezultat do të thotë se variabli është sinjifikativ, pra ky është një variabël i rëndësishëm për të shpjeguar variablin e varur (PBB). Në këtë rast variablat kanë një lidhje të drejtë me njëri-tjetrin, pasi shenja e koeficientit është pozitive.

Gjithashtu, po të shohim **F-statistic,** rezulton (72.46723) me prob (F-statistic) = 0.000001, një p-value <5%, që do të thotë se është domethënëse ose, e thënë ndryshe, F-statistic është sinjifikativ.

Nga regresioni rezulton se, për çdo rritje me 1% të Investimeve të Huaja Direkte, PBB-ja rritet me 6.964%.

Kurse vlera e Durbin Watson stat rezulton 0.711, e cila është mjaft e vogël në krahasim me vlerën optimale që duhet të jetë pranë koeficientit 2. Duke marrë parasysh këto të dhëna, mund të analizojmë secilin variabël në mënyrë të pavarur për të vërejtur stacionaritetin e serive kohore.

Unit Root Test për Investimet e Huaja Direkte, në Nivel (*level*) dhe me konstante (*Intercept*).

Nëse marrim parasysh **Unit Root Test** për variablin **IHD,** do të zbulonim se Prob është 0.7428, pra një vlerë më e madhe se 5%, që do të thotë se pranojmë hipotezën zero, që seria ka një rrënjë unitare (**unit root**), pra nuk është stacionare.

H0: seria ka një rrënjë unitare

H1: seria nuk ka një rrënjë unitare, pra është stacionare.

Gjithashtu, vlera e t-Statistic (-0.941490) është më e vogel se vlerat kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -0.941490 | 0.7428 |
| Test critical values: | 1% level | -4.004425 | |
| | 5% level | -3.098896 | |
| | 10% level | -2.690439 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(IHD)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:48
Sample (adjusted): 2001 2014
Included observations: 14 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| IHD(-1) | -0.123017 | 0.130662 | -0.941490 | 0.3650 |
| C | 1.53E+08 | 1.04E+08 | 1.470738 | 0.1671 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.068786 | Mean dependent var | 72727729 |
| Adjusted R-squared | -0.008815 | S.D. dependent var | 2.22E+08 |
| S.E. of regression | 2.23E+08 | Akaike info criterion | 41.41441 |
| Sum squared resid | 5.97E+17 | Schwarz criterion | 41.50570 |
| Log likelihood | -287.9009 | Hannan-Quinn criter. | 41.40596 |
| F-statistic | 0.886403 | Durbin-Watson stat | 1.601505 |
| Prob(F-statistic) | 0.365022 | | |

Unit Root Test për Prodhimin e Brendshëm Bruto, testi në Nivel (level) dhe me konstante (Intercept). E njëjta procedurë është ndjekur me variablin e Prodhimit të Brendshëm Bruto

(PBB), ku rezulton se Prob është 0.5690, pra më e madhe se 5%, dhe në këtë rast pranojmë Hipotezën zero, që seria ka rrënjë unitare dhe nuk është stacionare.

Edhe në këtë rast t-Statistic (-1.363525) është më i vogël se vlerat kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -1.363525 | 0.5690 |
| Test critical values: | 1% level | -4.004425 | |
| | 5% level | -3.098896 | |
| | 10% level | -2.690439 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PBB)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:52
Sample (adjusted): 2001 2014
Included observations: 14 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| PBB(-1) | -0.087769 | 0.064369 | -1.363525 | 0.1978 |
| C | 1.50E+09 | 6.31E+08 | 2.374160 | 0.0351 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.134149 | Mean dependent var | 6.92E+08 |
| Adjusted R-squared | 0.061995 | S.D. dependent var | 8.51E+08 |
| S.E. of regression | 8.24E+08 | Akaike info criterion | 44.02960 |
| Sum squared resid | 8.15E+18 | Schwarz criterion | 44.12089 |
| Log likelihood | -306.2072 | Hannan-Quinn criter. | 44.02115 |
| F-statistic | 1.859200 | Durbin-Watson stat | 1.950188 |
| Prob(F-statistic) | 0.197751 | | |

Pikërisht sepse rezultati i testit nuk është i pëlqyeshëm, jemi të detyruar ta thellojmë analizën tonë duke aplikuar diferencën e parë për secilin nga të dy variablat.

Unit Root Test për Investimet e Huaja Direkte, Testi në Diferencën e parë dhe me konstante (Intercept). Për diferencën e parë të variablit **IHD,** rezulton se Prob është 0.0853, vijon të ketë një vlerë më të madhe se 5%, që do të thotë se seria ka një rrënjë unitare (**unit root**), pra nuk është stacionare. Gjithashtu, vlera e t-Statistic (-2.798679) është përgjithësisht më e vogël se vlerat kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -2.798679 | 0.0853 |
| Test critical values: | 1% level | -4.057910 | |
| | 5% level | -3.119910 | |
| | 10% level | -2.701103 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(IHD,2)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:50
Sample (adjusted): 2002 2014
Included observations: 13 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| D(IHD(-1)) | -0.855176 | 0.305564 | -2.798679 | 0.0173 |
| C | 61001514 | 71211191 | 0.856628 | 0.4099 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.415907 | Mean dependent var | -12068854 |
| Adjusted R-squared | 0.362807 | S.D. dependent var | 2.99E+08 |
| S.E. of regression | 2.39E+08 | Akaike info criterion | 41.56142 |
| Sum squared resid | 6.28E+17 | Schwarz criterion | 41.64834 |
| Log likelihood | -268.1493 | Hannan-Quinn criter. | 41.54356 |
| F-statistic | 7.832602 | Durbin-Watson stat | 1.829076 |
| Prob(F-statistic) | 0.017316 | | |

Unit Root Test për Prodhimin e Brendshëm Bruto, testi në Diferencën e parë dhe me konstante (*Intercept*). Diferenca e parë për variablin PBB rezulton me një probabilitet prej 0.0532, pra afërsisht 5%. Në këtë rast jemi në limitet e pranimit se seria ka ose jo një rrënjë unitare. Në këtë rast koeficienti i t-Statistic (-3.083135) është më i madh se (-2.701103) të nivelit 10% së vlerës kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -3.083135 | 0.0532 |
| Test critical values: | 1% level | -4.057910 | |
| | 5% level | -3.119910 | |
| | 10% level | -2.701103 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PBB,2)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:54
Sample (adjusted): 2002 2014
Included observations: 13 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| D(PBB(-1)) | -0.925640 | 0.300227 | -3.083135 | 0.0104 |
| C | 6.61E+08 | 3.32E+08 | 1.990136 | 0.0720 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.463564 | Mean dependent var | 3780839. |
| Adjusted R-squared | 0.414797 | S.D. dependent var | 1.20E+09 |
| S.E. of regression | 9.18E+08 | Akaike info criterion | 44.25468 |
| Sum squared resid | 9.28E+18 | Schwarz criterion | 44.34159 |
| Log likelihood | -285.6554 | Hannan-Quinn criter. | 44.23681 |
| F-statistic | 9.505720 | Durbin-Watson stat | 1.974550 |
| Prob(F-statistic) | 0.010413 | | |

Unit Root Test për Investimet e Huaja Direkte, testi në Diferencën e dytë dhe me konstante (Intercept). Për diferencën e dytë të variablit **IHD,** rezulton se probabiliteti është 0.0163, pra një vlerë më të vogël se 5%, që do të thotë se seria nuk ka një rrënjë unitare (**unit root**), pra pranojmë se seria është stacionare.

Gjithashtu, vlera e t-Statistic ( -3.827041) është më e madhe se vlera e 5% (-3.144920) të vlerës kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -3.827041 | 0.0163 |
| Test critical values: | 1% level | -4.121990 | |
| | 5% level | -3.144920 | |
| | 10% level | -2.713751 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(IHD,3)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:51
Sample (adjusted): 2003 2014
Included observations: 12 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| D(IHD(-1),2) | -1.277049 | 0.333691 | -3.827041 | 0.0033 |
| C | 4528551. | 91119805 | 0.049699 | 0.9613 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| S.E. of regression | 3.15E+08 | Akaike info criterion | 42.12238 |
| Sum squared resid | 9.90E+17 | Schwarz criterion | 42.20320 |
| Log likelihood | -250.7343 | Hannan-Quinn criter. | 42.09246 |
| Durbin-Watson stat | 2.006752 | | |

Unit Root Test për Prodhimin e Brendshëm Bruto, testi në Diferencën e dytë dhe me konstante (*Intercept*). Diferenca e dytë për variablin PBB rezulton me një probabilitet prej 0.0032, pra më e vogël se 5%. Në këtë rast pranojmë se seria nuk ka rrënjë unitare, pra kemi një stacionaritet. Koeficienti i t-Statistic (-4.967513) është më i madhe se (-4.200056) të nivelit 1% të vlerës kritike të testit.

| | | t-Statistic | Prob.* |
|---|---|---|---|
| Augmented Dickey-Fuller test statistic | | -4.967513 | 0.0032 |
| Test critical values: | 1% level | -4.200056 | |
| | 5% level | -3.175352 | |
| | 10% level | -2.728985 | |

Augmented Dickey-Fuller Test Equation
Dependent Variable: D(PBB,3)
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:54
Sample (adjusted): 2004 2014
Included observations: 11 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| D(PBB(-1),2) | -2.236686 | 0.450263 | -4.967513 | 0.0011 |
| D(PBB(-1),3) | 0.648384 | 0.277638 | 2.335359 | 0.0478 |
| C | -1.13E+08 | 3.12E+08 | -0.361719 | 0.7269 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.815985 | Mean dependent var | -87565160 |
| Adjusted R-squared | 0.769981 | S.D. dependent var | 2.15E+09 |
| S.E. of regression | 1.03E+09 | Akaike info criterion | 44.57237 |
| Sum squared resid | 8.50E+18 | Schwarz criterion | 44.68088 |
| Log likelihood | -242.1480 | Hannan-Quinn criter. | 44.50396 |
| F-statistic | 17.73732 | Durbin-Watson stat | 2.087919 |
| Prob(F-statistic) | 0.001147 | | |

Pasi identifikuam se seritë janë stacionare në diferencën e dytë, mund të rikrijojmë regresionin e këtyre dy variablave të lartpërmendur. Me akronimin D2PBB specifikohet diferenca e dytë e variablit të PBB-së dhe me akronimin D2IHD specifikohet diferenca e dytë e IHD-ve.

Regresioni lidh Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe Investimet e Huaja Direkte në diferencën e dytë të variablave. Nga regresioni rezulton se probabiliteti (0.0120) është më i vogël se niveli 5%, pra koeficienti është sinjifikativ. Gjithashtu, t-Statistic (3.005455) është më i madh se vlera

absolute 2, që do të thotë se koeficienti i variablit të pavarur është sinjifikativ. Durbin Watson stat rezulton 2.33, pra afër vlerës optimale të koeficientit 2.

Dependent Variable: D2PBB
Method: Least Squares
Date: 08/14/15 Time: 18:47
Sample (adjusted): 2002 2014
Included observations: 13 after adjustments

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | 36291137 | 2.58E+08 | 0.140708 | 0.8906 |
| D2IHD | 2.693735 | 0.896282 | 3.005455 | 0.0120 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.450899 | Mean dependent var | 3780839. |
| Adjusted R-squared | 0.400981 | S.D. dependent var | 1.20E+09 |
| S.E. of regression | 9.29E+08 | Akaike info criterion | 44.27801 |
| Sum squared resid | 9.50E+18 | Schwarz criterion | 44.36493 |
| Log likelihood | -285.8071 | Hannan-Quinn criter. | 44.26015 |
| F-statistic | 9.032759 | Durbin-Watson stat | 2.332829 |
| Prob(F-statistic) | 0.011963 | | |

Estimation Command:
=========================
LS D2PBB C D2IHD

Estimation Equation:
=========================
D2PBB = C(1) + C(2)*D2IHD

Substituted Coefficients:
=========================
D2PBB = 36291137.2372 + 2.69373539495*D2IHD

**Hipoteza e ngritur H0 vërtetohet sipas ekuacionit të mëposhtëm.** Nga regresioni rezultojnë vlerat e konstantes dhe të koeficientit të variablit të pavarur si dhe lidhje pozitive midis IHD-ve dhe PBB-së.

**D2PBB = 36291137.2372 + 2.69373539495*D2IHD**

**Sipas ekuacionit, rezulton se një rritje me 1 USD të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri shkakton një rritje prej 2.69 USD të Prodhimit të Brendshëm Bruto.**

Pasi u vertetua lidhja virtuoze midis Investimeve të Huaja Direkte dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto, duhet që tanimë të vlerësojme ekzistencën e nje lidhjeje midis IHD-ve dhe Urbanizimit në Shqipëri. Arsyetimi që do të donim të mbështesnim do të ishte që, meqenëse IHD-të në 99% të rasteve jane aplikuar në qytete, si pasojë edhe popullsia e qyteteve duhet të jetë rritur jo thjesht në vlera absolute, por edhe si përqindje (vlera relative) ndaj popullsise rurale, pikërisht si pasojë e ndikimit që IHD-të kanë pasur në nevojën për krah pune.

### 5.4. Investimet dhe Urbanizimi

Në tabelën e mëposhtme, krahas normës së urbanizimit në Shqipëri, kemi edhe konsumin e energjisë elektrike në kwh për person. Është e ditur se energjia elektrike u shërben njerëzve kudo ku ata banojnë, në qytete apo fshat; gjithashtu është e pamohueshme se, për arsye të prezencës së shumë aktiviteteve tregtare dhe prodhuese, nevojitet energjia elektrike shtesë. Zhvillimi ekonomik që sjell përparimi i aktiviteteve prodhuese dhe shërbimeve shkakton edhe rritjen e standardit të jetesës së shqiptarit mesatar që banon në qytet. Pas lidhjes fillestare midis IHD-së, zhvillimit ekonomik dhe urbanizimit, do të kërkojmë të vërtetojmë nëse urbanizimi në Shqipëri është shkaktar i rritjes së konsumit të energjisë elektrike.

Tabela 5.12. Përqindja e Urbanizimit dhe konsumi i kwh për person

| Vitet | Urbanizimi | Energjia |
|---|---|---|
| **2000** | 41.7 | 1436.7 |
| **2001** | 42.4 | 1338.8 |
| **2002** | 43.5 | 1561.1 |
| **2003** | 44.6 | 1469.3 |
| **2004** | 45.7 | 1797.5 |
| **2005** | 46.7 | 1722.1 |
| **2006** | 47.8 | 1218.4 |
| **2007** | 48.9 | 1213.1 |
| **2008** | 50.0 | 1617.7 |
| **2009** | 51.1 | 1837.4 |
| **2010** | 52.2 | 1947.5 |

| | | |
|---|---|---|
| **2011** | 53.2 | 2195.0 |
| **2012** | 54.3 | 2118.3 |

Burimi: *INSTAT (2015)*

Nga viti 2000 e tej, popullsia në qytetet shqiptare është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, qoftë në mënyrë relative, qoftë në vlera absolute. Në fillimin e mijëvjeçarit të ri, vetëm katër shqiptarë në dhjetë banonin në qendra administrative, ndërsa në vitin 2012, rreth 55% të shqiptarëve banonin në qytete. Të dhënat e mëpasshme tregojnë se norma e shqiptarëve që banon në qytete vazhdon të rritet, duke prekur 57% ndaj totalit të popullsisë për vitin 2014.

Në vlerë absolute, numri i qytetarëve shqiptarë për vitin 2000 ka qenë 1.293.549 persona, ndërsa për vitin 2012 ka qenë 1.615.832 persona. Dinamika e rritjes së qyteteve shqiptare ka vijuar deri në vitin 2014, ku shënohen 1.654.797 persona banues nëpër qytetet e Shqipërisë.

Në rreshtin e sipërm është vendosur viti përkatës, ndërsa në rreshtin e dytë është vendosur norma e banorëve të Shqipërisë të cilët jetojnë në Tiranë. Në vitin 2000, vetëm 12.4% të shqiptarëve ose rreth 380.000 persona jetonin në Tiranë, ndërsa në vitin 2012, një shqiptar në pesë jetonte tashmë në Tiranë. Në vitin 2014, kryeqyteti ka të regjistruar rreth 610.000 persona, sa 21.1% e popullsisë shqiptare.

| 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12.4% | 13,0% | 13.4% | 14.2% | 14.8% | 15.5% | 16.1% | 16,8% | 17,5% | 18,2% | 18,8% | 19,4% | 20,2% | 21,0% | 21,1% |

Gjatë të njëjtit hark kohor, konsumi i energjisë elektrike për person është rritur me 50%, duke kaluar nga 1436 kwh, në 2120 kwh për vitin 2012. Shkaqet e rritjes, veç rritjes së standardeve të jetesës dhe të shtimit të pajisjeve elektroshtëpiake, janë krijimi dhe rritja e aktiviteteve të reja tregtare dhe prodhuese. Grafiku i mëposhtëm tregon ecurinë e konsumit të energjisë elektrike, i cili nuk ka qenë në kërkesë tërësisht e lirë, por ka qenë i kushtëzuar nga një ofertë (prodhim) shpeshherë i pamjaftueshëm, së paku deri në fillimin e vitit 2010.

Grafiku 5.13. Ecuria e konsumit të energjisë elektrike për person




Burimi: *Banka Botërore (2015)*

Në tabelën e mëposhtme kemi vendosur të ripërllogarisim të dhënat e urbanizimit dhe të Investimeve të Huaja Direkte. Kjo për arsye se, të dhënat origjinale nuk na lejojnë një krahasim të mirëfilltë të dy agregateve. Për t'i bërë të krahasueshëm, kemi zgjedhur formulën:

$$\{(Ut-U0)/U0\}+1$$

Ku me Ut nënkuptojmë Urbanizimin ose IHD-të në vitin t, kurse me U0 Urbanizimin në vitin bazë, që në rastin konkret është viti 2000.

Në vitin 2012, shkalla e urbanizimit në Shqipëri është rritur me 30.2%, ndërsa IHD-të për vitin 2012 kanë qenë sa 6.4 herë më të mëdha se ato të vitit 2000. Ende pa bërë një analizë korrelacioni, mund të shohim se të dy treguesit kanë të njëjtin drejtim në sensin rritës.

Tabela 5.14. Ecuria e Urbanizimit dhe IHD-ve ndër vite

| Vitet | Urbanizimi | IHD |
|---|---|---|
| 2000 | 1 | 1 |
| 2001 | 1.017 | 1.450 |
| 2002 | 1.042 | 0.944 |
| 2003 | 1.068 | 1.245 |
| 2004 | 1.094 | 2.387 |
| 2005 | 1.120 | 1.836 |
| 2006 | 1.146 | 2.274 |
| 2007 | 1.172 | 4.561 |
| 2008 | 1.198 | 8.678 |
| 2009 | 1.224 | 9.392 |
| 2010 | 1.250 | 7.618 |

| | | |
|---|---|---|
| 2011 | 1.276 | 7.339 |
| 2012 | 1.302 | 6.434 |

Burimi: *Autori*

Duke përdorur të dhënat e tabelës së mësipërme, kemi vendosur dy variablat me objektivin e vlerësimit të një lidhjeje midis tyre. Si variabël i pavarur është marrë ai i IHD-ve, ndërsa presupozohet se urbanizimi është rritur si pasojë.

Dependent Variable: URB
Method: Least Squares
Date: 08/16/15 Time: 17:57
Sample: 2000 2012
Included observations: 13

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| C | 1.032957 | 0.025099 | 41.15522 | 0.0000 |
| IHD | 0.026771 | 0.004787 | 5.592638 | 0.0002 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.739815 | Mean dependent var | 1.146546 |
| Adjusted R-squared | 0.716162 | S.D. dependent var | 0.099796 |
| S.E. of regression | 0.053168 | Akaike info criterion | -2.890091 |
| Sum squared resid | 0.031095 | Schwarz criterion | -2.803176 |
| Log likelihood | 20.78559 | Hannan-Quinn criter. | -2.907956 |
| F-statistic | 31.27760 | Durbin-Watson stat | 1.680294 |
| Prob(F-statistic) | 0.000162 | | |

Estimation Command:
=========================
LS URB C IHD

Estimation Equation:
=========================
URB = C(1) + C(2)*IHD

Substituted Coefficients:
=========================
**URB = 1.03295700195 + 0.0267714379538*IHD**

**Hipoteza e ngritur H0 vërtetohet sipas ekuacionit të mëposhtëm.** Nga regresioni rezultojnë vlerat e konstantes dhe të koeficientit të variablit të pavarur si dhe lidhje pozitive midis IHD-ve dhe Urbanizimit.

Lidhja midis dy variablave është e konfirmuar, pasi Adjusted R squared është pranë nivelit 72% dhe koeficienti i variablit të pavarur rezulton sinjifikativ nga pikëpamja statistikore, pasi Prob është 0.0002, pra më pak se 5%. Treguesi i D-W është 1.68, dhe, ndonëse jo tërësisht pranë nivelit 2, mundet që të quhet si i pranueshëm.

Nga ekuacioni i mësipërm rezulton, se për një rritje me 100% të IHD-ve nga viti në vit, niveli i urbanizimit do të rritej me 2.67%. Kujdes, kjo gjë nuk do të thotë se Urbanizimi mund të shkojë p.sh., nga 50% në 52.67% nga viti në vit, por kjo rritje është ndaj vetes, gjë që do të thotë se popullsia në qytete do të rritej me 2.67%. Në një situatë ku p.sh., 50% e popullsisë banon në qytet, rezultati nga viti në vit do të ishte për një rritje me 1.34%.

*Rast hipotetik:*

Rritje me 80% e IHD-ve nga viti 0 në vitin 1. Urbanizimi në nivel 45% në vitin 0.

**0.8*0.0267*0.45=0.009612**

Pra nga viti në vit, popullsia që banon në qytete do rritet me 0.96% dhe në vitin 1 popullsia urbane do të jetë 45.96%.

Kjo situatë është vërtetuar për sa i përket afatit kohor 2000-2012. Nëse nuk do të ketë ndryshime në formimin e variablave, atëherë në këtë mënyrë mund të parashikojmë edhe evolucionin e urbanizimit në Shqipëri mbi bazën e të dhënave që kemi mbi Investimet e Huaja Direkte.

### 5.5. Urbanizimi dhe Energjia

Pasi vërtetuam lidhjen ekzistuese midis IHD-ve dhe Urbanizimit, vijojmë analizën duke verifikuar ekzistencën e një lidhjeje midis energjisë së konsumuar dhe urbanizimit. Pas analizave

të ndërsjellta të dy variablave, është vendosur që të merret, pasi rezulton edhe më domethënës, urbanizimi si variabël i pavarur dhe energjia ose konsumi i energjisë elektrike si variabël i varur.

Ashtu siç është vepruar për analizën e mëparshme, edhe në këtë rast, kemi transformuar të dhënat e konsumit të energjisë elektrike për person në vit dhe ato të urbanizmit sipas formulës së mëposhtme, ku me anagramën Ut nënkuptojmë vlerën në kohën t për Urbanizimin dhe Energjinë, ndërsa me U0 këto vlera për vitin bazë, që në rastin tonë është viti 2000.

$$\{(Ut-U0) / U0\} + 1$$

Tabela 5.15. Urbanizimi dhe energjia ndër vite

| Vitet | Energjia | Urbanizimi |
|---|---|---|
| 2000 | 1 | 1 |
| 2001 | 0.932 | 1.017 |
| 2002 | 1.087 | 1.042 |
| 2003 | 1.023 | 1.068 |
| 2004 | 1.251 | 1.094 |
| 2005 | 1.199 | 1.120 |
| 2006 | 0.848 | 1.146 |
| 2007 | 0.844 | 1.172 |
| 2008 | 1.126 | 1.198 |
| 2009 | 1.279 | 1.224 |
| 2010 | 1.356 | 1.250 |
| 2011 | 1.528 | 1.276 |
| 2012 | 1.474 | 1.302 |

Burimi: *INSTAT*

Konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri nga viti 2000 deri në vitin 2013 është rritur me gati 47.4%, ndërsa përqindja e popullsisë urbane, ashtu siç është parathënë, është rritur me 32%. Në grafikun e mëposhtëm mund të shohim se dy variablat kanë tendenca rritjeje mjaft të ngjashme dhe të ndërthurura. Nga një vështrim paraprak mund të duket se ekziston një lidhje e qartë dhe e drejtpërdrejtë midis tyre.

Grafiku 5.16. Ecuria e konsumit të energjisë dhe urbanizmi ndër vite




Burimi: *INSTAT (2015)*

Pas një analize fillestare, është vazhduar drejt një analize ku relacioni statistikor midis variablave provohet nga elementët korrelativë.

Dependent Variable: EN
Method: Least Squares
Date: 08/18/15 Time: 17:44
Sample: 2000 2012
Included observations: 13

| Variable | Coefficient | Std. Error | t-Statistic | Prob. |
|---|---|---|---|---|
| URB | 1.006142 | 0.041183 | 24.43080 | 0.0000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| R-squared | 0.411107 | Mean dependent var | 1.149769 |
| Adjusted R-squared | 0.411107 | S.D. dependent var | 0.222687 |
| S.E. of regression | 0.170889 | Akaike info criterion | -0.621802 |
| Sum squared resid | 0.350436 | Schwarz criterion | -0.578345 |
| Log likelihood | 5.041714 | Hannan-Quinn criter. | -0.630735 |
| Durbin-Watson stat | 1.453273 | | |

Estimation Command:
=========================
LS EN URB

Estimation Equation:
=========================
EN = C(1)*URB

Substituted Coefficients:
=========================
EN = 1.00614232499*URB

Në këtë rast, lidhja midis urbanizmit dhe konsumit të energjisë elektrike (dhe anasjelltas) është e dobët, pasi Adjusted R Square rezulton vetëm 41.1%. Pra nga pikëpamja statistikore, edhe duke marrë parasysh treguesin Durbin Watson, mund të kemi dyshime të arsyeshme mbi lidhjen midis dy variablave të marrë në analizë, por është e pamohueshme se dy variablat kanë të njëjtën tendencë dhe nga pikëpamja teorike janë të lidhur. Për të përmbledhur analizat e kryera në pikën 3.1, mund të shohim ndikimin që Investimet e Huaja Direkte kanë pasur mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto dhe mbi Urbanizimin e vendit, ndërsa, për sa i përket raportit midis Urbanizmit dhe konsumit të energjisë elektrike, ky i fundit ngelet relativisht i dobët, ashtu siç është shënuar nga shigjetat përkatëse. Nga pika 1 është huazuar raporti bazik dhe fillestar i provuar midis Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Urbanizimit.



### 5. 6. Qytetet dhe bizneset

Në pikat e mëparshme është vendosur theksi te raporti i virtytshëm që krijohet midis rritjes ekonomike dhe urbanizimit. Në këtë pjesë të punimit do të evidentohet kontributi që bizneset japin në rritjen e qendrave urbane në raport me mesataren e vendit. Në analizë do të vendoset konkretisht, jo vetëm numri i bizneseve, por edhe dimensioni i tyre, pa harruar fushën e tyre të veprimit.

| **Banorët** | **2009** | **2010** | **2011** | **2012** | **2013** | **2014** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Berat** | 157597 | 153077 | 149672 | 146649 | 145236 | 145097 |
| **Dibër** | 152783 | 148074 | 144194 | 140788 | 138450 | 138321 |
| **Durrës** | 262867 | 265639 | 269784 | 274258 | 275471 | 275205 |
| **Elbasan** | 314757 | 309657 | 306939 | 305140 | 303120 | 302827 |
| **Fier** | 336356 | 330378 | 324863 | 320216 | 318102 | 317799 |
| **Gjirokastër** | 85885 | 82238 | 78405 | 74720 | 73627 | 73556 |
| **Korçë** | 236904 | 233820 | 230259 | 227328 | 226282 | 226066 |
| **Kukës** | 93626 | 91226 | 89400 | 87841 | 86555 | 86472 |
| **Lezhë** | 142872 | 140755 | 139734 | 138992 | 138349 | 138214 |
| **Shkodër** | 232013 | 229140 | 225548 | 222494 | 221459 | 221235 |
| **Tiranë** | 731005 | 747173 | 763559 | 781020 | 789129 | 788330 |
| **Vlorë** | 189691 | 187501 | 185003 | 182745 | 183002 | 182825 |
| **Total** | **2936355** | **2918674** | **2907361** | **2902190** | **2898782** | **2895947** |

Tabela 5.17. Ecuria e popullsisë në qarqet e Shqipërisë

Burimi: *INSTAT (2015)*

Në tabelën e mësipërme mund të vërejmë se popullsia e Shqipërisë ka shfaqur një rënie të vazhdueshme gjashtë vitet e fundit, duke marrë për bazë censusin e vitit 2011. Në fakt, censusi ka pasur jo pak probleme në mbledhjen e të dhënave, pasi mjaft komunitete, me protesta të ndryshme kanë zgjedhur të mos regjistrohen ose, në raste të tjera, ka pasur probleme takimi midis recensuesve dhe familjeve. Sido që të jetë, pavarësisht problematikave, jemi të detyruar t'i

marrim këto të dhëna si një rezultat zyrtar, pasi nuk disponojmë të dhëna të tjera më të besueshme.

Në të gjitha qarqet e Shqipërisë, veç atij të Tiranës dhe Durrësit, evolucioni i popullsisë ka qenë mjaft negativ. Numrat janë dekurajues, sidomos për qarqet verilindore të vendit, sidomos qarku i Kukësit dhe ai Dibrës, të cilët në pesë vitet e fundit kanë humbur mesatarisht 9% të popullsisë së tyre. Edhe qarqet e tjera në jug të vendit, si Gjirokastra dhe Korça, kanë humbur shifra gati dyshifrore në normë të popullsisë së tyre. Për sa u përket qarqeve të tjera, humbja e popullsisë ecën me ritmin e 1% çdo vit.

Në dy grafikët e mëposhtëm dallohen qartazi dy tendencat e ndryshme të ecurisë së popullsisë së Tiranës nga një krah, dhe të Shqipërisë nga krahu tjetër.

Në qarkun e Tiranës në pesë vite janë shtuar 57.325 persona, thënë ndryshe, 7.8% banorë shtesë, ndërsa nga Shqipëria kanë ikur ose janë larguar, pa marrë parasysh koeficientet të lindshmërisë dhe të shtesës natyrore të popullsisë, rreth 40.408 persona, thënë ndryshe, rreth 1.5% banorë më pak.

Grafiku 5.18. Krahasimi midis ecurisë së popullsisë në qarkun Tiranë dhe numri i personave që banojnë në Shqipëri






Në tabelën e mëposhtme kemi një historik të shkurtër të numrit të ndërmarrjeve të pranishme në Shqipëri. Numrat na shërbejnë thjesht si një konsideratë fillestare e situatës së biznesit në vend. Nga shifrat e huazuara nga INSTAT-i, rezulton se numri i ndërmarrjeve në Shqipëri për vitin 2009 ka qenë 54.412. Këtu përfshihen të gjitha llojet e ndërmarrjeve, në të gjitha fushat dhe me të gjitha dimensionet, duke filluar nga gjithë të vetëpunësuarit, te ndërmarrjet e mëdha me më shumë se 50 punëtorë.

Gjatë pesë viteve të fundit numri i ndërmarrjeve të regjistruara në Shqipëri është dyfishuar, duke arritur në 112.537 njësi për vitin 2014. Nën mesataren e rritjes kanë qenë qarqet e Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Gjirokastrës dhe Korçës. Qarqet të cilat kanë mbi dyfishuar numrin e bizneseve të pranishme në territoret e tyre kanë qenë Kukësi, Lezha, Shkodra, Tirana dhe Vlora. Edhe në këtë rast spikat numri i ri i bizneseve të hapura në Tiranë, i cili është rritur me 128%, nga viti 2009 në vitin 2014.

Tabela 5.19. Numri i bizneseve në Shqipëri sipas qarqeve dhe viteve

| **Bizneset** | **2009** | **2010** | **2011** | **2012** | **2013** | **2014** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Berat** | 2445 | 2792 | 3048 | 3352 | 3632 | 4302 |
| **Dibër** | 1347 | 1526 | 1653 | 1764 | 1911 | 2164 |
| **Durrës** | 4807 | 5476 | 6144 | 6844 | 7742 | 9578 |
| **Elbasan** | 4119 | 5039 | 5624 | 6244 | 6919 | 7859 |
| **Fier** | 5213 | 6094 | 6772 | 7364 | 8116 | 9693 |
| **Gjirokastër** | 1497 | 1679 | 1867 | 2067 | 2292 | 2681 |
| **Korçë** | 4136 | 4680 | 5231 | 5791 | 6359 | 7311 |
| **Kukës** | 489 | 561 | 631 | 720 | 825 | 1068 |
| **Lezhë** | 1580 | 1803 | 2023 | 2247 | 2519 | 3388 |
| **Shkodër** | 2674 | 3033 | 3383 | 3861 | 4305 | 5446 |
| **Tiranë** | 21695 | 26925 | 31326 | 36575 | 42414 | 49467 |
| **Vlorë** | 4410 | 5296 | 6201 | 7155 | 8126 | 9580 |
| **Total** | **54412** | **64904** | **73903** | **83984** | **95160** | **112537** |

Burimi: *INSTAT, Anketa strukturore e ndërmarrjeve, 2014*

Tabela 5.20. Ndarja në fusha të veprimtarisë së ndërmarrjeve në Shqipëri

| % | Gjithsej | Berat | Dibër | Durrës | Elbasan | Fier | Gjirokastër | Korçë | Kukës | Lezhë | Shkodër | Tiranë | Vlorë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej Total | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 |
| Prodh mirave | 15,1 | 18,0 | 19,5 | 17,7 | 13,9 | 20,0 | 17,9 | 15,6 | 17,6 | 16,9 | 14,7 | 12,3 | 18,5 |
| Bujqësia | 2,0 | 3,8 | 2,6 | 1,7 | 1,4 | 6,9 | 2,3 | 2,3 | 3,2 | 2,6 | 2,6 | 0,4 | 4,5 |
| Industria | 9,0 | 12,3 | 12,7 | 10,8 | 10,1 | 9,8 | 11,5 | 10,7 | 9,3 | 9,8 | 9,2 | 7,5 | 8,6 |
| Ndërtimi | 4,1 | 1,9 | 4,2 | 5,2 | 2,5 | 3,4 | 4,0 | 2,6 | 5,1 | 4,5 | 2,9 | 4,4 | 5,5 |
| Prodhuesit e shërbimeve | 84,9 | 82,0 | 80,5 | 82,3 | 86,1 | 80,0 | 82,1 | 84,4 | 82,4 | 83,1 | 85,3 | 87,7 | 81,5 |
| Tregtia | 40,0 | 46,7 | 34,7 | 41,7 | 42,7 | 44,0 | 40,9 | 42,7 | 36,9 | 42,0 | 43,1 | 37,7 | 37,1 |
| Transporti | 6,7 | 7,3 | 14,0 | 7,2 | 10,2 | 7,0 | 7,8 | 11,1 | 8,3 | 8,4 | 6,2 | 4,7 | 7,5 |
| Akomodimi, shërbimi ushq | 16,0 | 14,9 | 15,9 | 14,1 | 15,9 | 14,3 | 15,0 | 15,0 | 15,5 | 14,9 | 15,8 | 16,3 | 21,1 |
| Inform dhe komunik | 2,3 | 1,9 | 1,6 | 1,4 | 2,1 | 1,8 | 1,6 | 1,7 | 1,2 | 1,1 | 1,5 | 3,1 | 1,6 |
| Shërbime të tjera | 19,9 | 11,2 | 14,3 | 17,9 | 15,1 | 12,8 | 16,9 | 13,9 | 20,4 | 16,6 | 18,6 | 25,9 | 14,2 |

Tabela e mësipërme tregon se ku përqendrohet aktiviteti ekonomik i ndërmarrjeve në Shqipëri. Në fakt, në krahasim me vitet e kaluara, nuk ka evolucione domethënëse për sa u përket fushave të specializimit të ekonomisë shqiptare. Në punën tonë, detyra do të jetë evidentimi i specializimit ekonomik të kryeqytetit shqiptar. Nga një ndarje fillestare e përgjithshme rezulton se, 15,1% e ndërmarrjeve shqiptare veprojnë në fushat e prodhimit, qoftë ky i lidhur me ndërtimin, bujqësinë ose industrinë. Në Tiranë kjo normë ulet në 12,3% ndaj totalit të ndërmarrjeve. Arsyeja fillestare qëndron në një prezencë simbolike të ndërmarrjeve bujqësore, 0,4%, kundrejt 2% të ndërmarrjeve në rang vendi. Gjithashtu, edhe ndërmarrjet industriale janë vetëm 7.5% të totalit, kundër një mesatareje prej 9% në Shqipëri. Nga këto shifra fillestare mund të nxjerrim se Tirana nuk është një qendër e veçantë ndërkombëtare prodhuese, përkundrazi, mund të themi se ajo qëndron nën mesataren kombëtare të industrializimit dhe prodhimit.

Janë qarqet e Fierit, Vlorës dhe Beratit ato ku sektori bujqësor ka qartazi më shumë peshë ndaj mesatares shqiptare, ndërsa në Berat, Dibër, Durrës, Elbasan dhe Korçë ndërmarrjet industriale tajkalojnë 10% të ndërmarrjeve totale. Në Durrës, Kukës dhe Vlorë sektori i ndërtimit zë më shumë se 5% të totalit të ndërmarrjeve të qarkut. Tirana ka një numër më të madh ndërmarrjesh në raport me mesataren vetëm në sektorin e ndërtimit, ku 4.4% të ndërmarrjeve veprojnë në këtë sektor kundrejt 4.1% të Shqipërisë.

Tirana konfigurohet si kryeqyteti i shërbimeve. Në Shqipëri, 84,9% të ndërmarrjeve janë të bazuara mbi aktivitete shërbimi, ndërsa në Tiranë ato arrijnë normën e 87,7%. Nuk është tregtia e vogël ajo që e dallon qytetin nga qarqet e tjera, pasi më pak se 38% të aktiviteteve në Tiranë veprojnë në tregti, ndryshe nga qarqe si Berati, ku arrihet norma 46.7%. E njëjta gjë vlen për fushën e transportit, ku në kryeqytet, vetëm 4.7% e ndërmarrjeve vepron në këtë sektor, kundrejt 6.7% të mesatares.

Qarku i Dibrës ka ndërmarrje transporti sa 14% të ndërmarrjeve totale. Fushat ku kryeqyteti dallon dhe ku ekonomia e tij është specializuar janë ato të akomodimit, shërbimit ushqimor, informatikës, komunikacionit, shërbimeve financiare dhe shërbimeve të tjera, të cilat përfshijnë fushën e financës, arsimit, shëndetësisë dhe argëtimit.

Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, 16.3% të ndërmarrjeve të regjistruara në Tiranë merren me hoteleri, në shpërndarjen e ushqimeve dhe në qendra tregtare. Më e qartë duket epërsia në fushën e shërbimeve të tjera, duke filluar nga prezenca e qindra filialeve bankare dhe të sigurimeve, nga prezenca e shumtë e shëndetësisë private, nga prezenca e qendrave universitare private dhe publike. Në Tiranë ndodhen gjithashtu shumica e aktiviteteve që merren me argëtimin si dhe pjesa më e madhe e televizioneve dhe shtypit. Qarku i Tiranës ka numrin më të madh të ndërmarrjeve të huaja të përbashkëta.

**Për të përmbyllur analizën e specializimit të ekonomisë së qytetit, mund të themi se Tirana është sot një qendër drejtimi dhe shërbimesh me një strukturë prodhuese të atrofizuar dhe josistemike.**

Grafiku 5.21. Specializimi ekonomik i kryeqytetit




Burimi: *INSTAT (2015)*

*5.6.1 Mundësia për të bërë biznes*

Numrat e përgjithshëm të bizneseve në Shqipëri rrezikojnë të mos japin një kuadër të qartë të situatës, pasi numri i bizneseve duhet peshuar me numrin e banorëve të pranishëm në zonën e analizuar. Vetëm duke kryer këtë raport, mund të kuptojmë realitetin e pasurisë ose varfërisë së bizneseve, e si pasojë të ekonomisë. Nga shifrat që do të kemi, do të mund të kuptojmë cila është mundësia për të bërë biznes në çdo qark të vendit tonë, duke marrë parasysh lehtësirat dhe vështirësitë gjeografike, infrastrukturore, financiare dhe njerëzore.

Në tabelën e mëposhtme mund të shohim për çdo qark të Shqipërisë se sa banorë për ndërmarrje ka, që nga viti 2009 deri në vitin 2014. Në vitin 2009, në Shqipëri për çdo aktivitet ekonomik ka pasur 54 banorë. Me termin "aktivitet ekonomik" nënkuptojmë, nga një dyqan të thjeshtë ushqimor deri në një aktivitet industrial të madh. Qarqet më të prapambetura kanë qenë ato të Kukësit dhe Dibrës, në të cilat për çdo biznes ka pasur më shumë se 100 banorë. Numri i banorëve për biznes është ulur në të gjitha qarqet, shenjë kjo se është rritur numri i bizneseve në çdo qark të vendit, duke sjellë rritje ekonomike dhe përmirësim të situatës së familjeve në vend. Në fakt, nuk mundet që të përcaktojmë cili do të ishte një numër optimal banorësh për biznes,

por rritja e numrit të bizneseve dhe ulja e numrit të banorëve për biznes tregon një rizgjim të shpirtit sipërmarrës të qytetarëve shqiptarë. Që në vitin 2009, Tirana ka kryesuar pozitivisht listën e banorëve për biznes, duke pasur 34 persona për çdo biznes të hapur. Në vitin 2014, në Tiranë për çdo biznes ka 14 persona, shenjë kjo që numri i bizneseve është rritur, por gjithashtu, bizneset e pranishme në pjesën e tyre më të madhe janë mjaft të vogla.

Në qarqet e tjera të vendit, ndonëse situata duket e përmirësuar në krahasim me vitet e tjera, vendet me më shumë banorë për biznes ngelen qarku i Kukësit dhe ai Dibrës. Situata më e mirë në qytetet e tjera, veç kryeqytetit, i referohet qarkut Vlorë (19 banorë për biznes) dhe Gjirokastër (27 banorë për biznes). Në Shqipëri, mesatarisht numri i banorëve për ndërmarrje në pesë vitet e fundit ka kaluar, nga 54 në 26 persona.

Tabela 5.22. Ndërmarrje për banorë ndër vite

| **Denduria** | **2009** | **2010** | **2011** | **2012** | **2013** | **2014** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Berat** | 64 | 55 | 49 | 44 | 40 | 34 |
| **Dibër** | 113 | 97 | 87 | 80 | 72 | 64 |
| **Durrës** | 55 | 49 | 44 | 40 | 36 | 29 |
| **Elbasan** | 76 | 61 | 55 | 49 | 44 | 39 |
| **Fier** | 65 | 54 | 48 | 43 | 39 | 33 |
| **Gjirokastër** | 57 | 49 | 42 | 36 | 32 | 27 |
| **Korçë** | 57 | 50 | 44 | 39 | 36 | 31 |
| **Kukës** | 191 | 163 | 142 | 122 | 105 | 81 |
| **Lezhë** | 90 | 78 | 69 | 62 | 55 | 41 |
| **Shkodër** | 87 | 76 | 67 | 58 | 51 | 41 |
| **Tiranë** | 34 | 28 | 24 | 21 | 19 | 16 |
| **Vlorë** | 43 | 35 | 30 | 26 | 23 | 19 |
| **Total** | **54** | **45** | **39** | **35** | **30** | **26** |

Burimi: *INSTAT, Autori*

Grafiku 5.23. Krahasimi i banorëve për ndërmarrje në Tiranë dhe Shqipëri




| Vitet | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Tendenca** | 1,601597 | 1,620499 | 1,613984 | 1,618272 | 1,637278 | 1,614741 |

Burimi: *Autori*

Në Tiranë, shpejtësia ose vrulli i të bërit biznes vazhdon të rritet, duke thelluar diferencat paraekzistuese me pjesën tjetër të vendit.

Nga tabela e mësipërme mund të shquhet se në vitin 2009, në Tiranë ka për çdo banor 60.15% më shumë aktivitete ekonomike ose biznese në krahasim me mesataren shqiptare, ndërsa në vitin 2014, pavarësisht luhatjeve periodike, në Tiranë ka 61.47% më shumë biznese se në pjesën tjetër të Shqipërisë. Në nivel qarku, numrin më të madh të bizneseve e ka Bashkia e Tiranës, me 29.490 biznese ose 72% të të gjitha bizneseve që operojnë në qarkun e Tiranës. Po kështu, në bashkitë e tjera të qarkut janë të përqendruara një numër i konsiderueshëm i bizneseve, si në Bashkinë Kamëz 1.800 biznese, Bashkinë e Kavajës 828 biznese dhe Bashkinë e Vlorës 749 biznese ( *Pyetësorët e njësive vendore, 2012*).

Ajo që vihet re, është që komunat e vendosura rreth e rrotull Bashkisë së Tiranës kanë një numër më të madh biznesesh se komunat që ndodhen më larg saj. Kështu, komuna Kashar ka 1.591

biznese, komuna Paskuqan 404 biznese, komuna Dajt 372 biznese dhe komuna Vaqar 320 biznese.

Nga të dhënat e mësipërme mund të themi, se numri i madh i banorëve urbanë që karakterizojnë Tiranën në krahasim me pjesën tjetër të Shqipërisë krijon efekte sinergjike të shprehura qartazi, për arsye të një administrate më të afërt, të kushteve infrastrukturore dhe gjeografike, për lehtësinë më të madhe të financimit, për burime njerëzore më të kualifikuara, furnizim me energji elektrike më të sigurt dhe për një treg të gjerë në numër dhe të shumëllojshëm për preferenca. Me kalimin e viteve, numri i bizneseve për banor në krahasim me mesataren kombëtare vazhdon të rritet, pavarësisht luhatjeve. Kjo është një provë tjetër se urbanizimi favorizon mundësitë për të bërë biznes dhe për ta rritur atë.

Grafiku 5.24. Numri i banorëve të ndërmarrjeve ndër vite, sipas qarqeve




Burimi: *INSTAT, Autori*

Në tabelën e mëposhtme vihet në dispozicion treguesi i kundërt ose sa ndërmarrje janë të pranishme për çdo banor. Natyrisht, raportet tregojnë një situatë më pozitive në Tiranë në krahasim me qytetet e tjera.

Tabela 5.25. Banorë për ndërmarrje sipas viteve dhe qarqeve

| Denduria | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Berat | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 | 0,03 |
| Dibër | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,02 |
| Durrës | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 | 0,03 |
| Elbasan | 0,01 | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 |
| Fier | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 | 0,03 |
| Gjirokastër | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 | 0,03 | 0,04 |
| Korçë | 0,02 | 0,02 | 0,02 | 0,03 | 0,03 | 0,03 |
| Kukës | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,01 |
| Lezhë | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,02 | 0,02 | 0,02 |
| Shkodër | 0,01 | 0,01 | 0,01 | 0,02 | 0,02 | 0,02 |
| Tiranë | 0,03 | 0,04 | 0,04 | 0,05 | 0,05 | 0,06 |
| Vlorë | 0,02 | 0,03 | 0,03 | 0,04 | 0,04 | 0,05 |
| **Total** | **0,02** | **0,02** | **0,03** | **0,03** | **0,03** | **0,04** |

Burimi: *INSTAT, Autori*

Tabela 5.26. Banorë për ndërmarrje sipas viteve dhe qarqeve




Burimi: *INSTAT, Autori*

*5.6.2. Urbanizimi dhe ndërmarrjet e mëdha*

Analiza e kryer më lart do të ishte e pjesshme dhe relativisht sipërfaqësore në rast se nuk do të merrte parasysh dimensionin ose madhësinë e ndërmarrjeve që veprojnë në Shqipëri dhe Tiranë. Nëse, nga një anë, është e vërtetë se vetëm 1.478 ndërmarrje kanë më shumë se 50 punëtorë për vitin 2014 dhe përbëjnë vetëm 1.3% të totalit të ndërmarrjeve në Shqipëri, nga ana tjetër, duhet të marrim parasysh se një ndërmarrje e madhe mund të punësojë sa 50 ose 100 ndërmarrje të vogla. Në Shqipëri, mesatarja e të punësuarve për ndërmarrjet e mëdha me më shumë se 50 punëtorë është 80 punëtorë. Nga një shumëzim i thjeshtë do të zbulonim, se numri i të punësuarve në ndërmarrjet e mëdha do të ishte më shumë se 118 mijë persona. Në raport me totalin e të punësuarve në sektorin jobujqësor, në Shqipëri ky numër është mjaft i lartë, pasi tejkalon 37% të të punësuarve, duke përjashtuar administratën shtetërore. Kjo gjë do të thotë se, ndonëse të pakta në numër, ndërmarrjet e mëdha në Shqipëri janë një burim domethënës punësimi si dhe furnizuesit fillestarë dhe qendrorë të buxhetit të shtetit.

Nga tabela e mëposhtme mund të vërejmë, se 54% e të gjitha ndërmarrjeve të mëdha gjejnë vendndodhjen e tyre në qarkun Tiranë. Ky element modifikon analizën tonë, duke përforcuar ndjeshëm pozitat që Tirana ka si qendër ekonomike dhe zhvillimore. Jo më kot, denduria e ndërmarrjeve të mëdha në Tiranë është më shumë se dyfishi në krahasim me mesataren shqiptare. Në fakt, në Tiranë ka 1 ndërmarrje të madhe mesatarisht për çdo 988 banorë, ndërsa në Shqipëri, mesatarja rritet deri në 1 ndërmarrje çdo 1.959 banorë. Elementi infrastrukturor, administrativ, financiar etj., tregon fuqinë e tërheqjes ekonomike të kryeqytetit pikërisht në ndërmarrjet e mëdha. Nëse do të hidhnim një vështrim mbi pjesën tjetër të Shqipërisë, qyteti i Elbasanit dhe qarku i tij janë ato me një prezencë më të ulët të ndërmarrjeve të mëdha, ku për çdo të tillë banojnë më shumë se 5.000 banorë. Edhe në qarqet Fier dhe Korçë numri i

ndërmarrjeve të mëdha është mjaft i ulët në raport me popullsinë, ndërsa vetëm në qarqet Durrës dhe Gjirokastër, për çdo ndërmarrje të mëdha ka më pak se 2.000 banorë.

Tabela 5.27. Ndërmarrjet e mëdha (+50 punëtorë)

| Qarku | Norma ndaj totalit | Nr ndërmarrje të mëdha | Ndërmarrje për person |
|---|---|---|---|
| **Berat** | 2,9% | 43 | 3374 |
| **Dibër** | 2,4% | 35 | 3952 |
| **Durrës** | 11,5% | 170 | 1619 |
| **Elbasan** | 4,0% | 59 | 5133 |
| **Fier** | 5,2% | 77 | 4127 |
| **Gjirokastër** | 2,5% | 37 | 1988 |
| **Korçë** | 3,8% | 56 | 4037 |
| **Kukës** | 1,6% | 23 | 3760 |
| **Lezhë** | 2,8% | 42 | 3291 |
| **Shkodër** | 4,9% | 72 | 3073 |
| **Tiranë** | 54,0% | 798 | 988 |
| **Vlorë** | 4,5% | 66 | 2770 |
| **Gjithsej / Total** | 100,0% | 1.478 | 1959 |

Burimi: *INSTAT, Autori.*

Kuadri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të mëdha në Shqipëri, duke marrë parasysh edhe Tiranën, është problematik, pasi bizneset e mëdha janë të pakta dhe janë të vetmet që mund të përcjellin një kulturë sipërmarrëse dhe të përforcojnë më shumë aftësitë menaxhuese. Pika e tyre më e fuqishme është në raportin e vazhdueshëm me institucionet financiare dhe bankat, si levë për zgjerimin e tyre dhe zhvillimin ekonomik. Ndonëse kuadri i përgjithshëm nuk është ai i një vendi të zhvilluar, duhet të kujtojmë se Shqipëria 11 vite më parë (viti 2004) ka pasur vetëm 386 ndërmarrje të mëdha, ndërsa në vitin 2014 janë 798 ndërmarrjet e mëdha vetëm në Qarkun e Tiranës. Nga kjo pikëpamje, qyteti i Tiranës ka qenë qartazi pika e referimit të investimeve kombëtare e të huaja, dhe deri më tani ka dhënë prova numerike si një aglomerat urban i cili lejon dhe promovon rritjen dhe zhvillimin e biznesit.

## 5.7. Konkluzione

Ky kapitull ofroi informacione në lidhje me metodologjinë e përdorur, analizën e kryer mbi këtë punim. Në të u paraqitën të dhëna në lidhje me studimin empirik të kryer dhe me mbledhjen e të dhënave nga burime si INSTAT-i, Banka Botërore etj. Kështu, u paraqitën marrëdhëniet midis variablave dhe përcaktimi i hipotezave të studimit. Më pas, në këtë kapitull u prezantua një analizë e kujdesshme e të dhënave. Ajo çfarë ishte e rëndësishme në këtë pjesë, është kryesisht lidhja që ekziston midis urbanizimit dhe ekonomisë, si ndikon popullsia te rritja ekonomike dhe anasjelltas, si ndikojnë faktorë të tjerë mjaft të rëndësishëm, si: Investimet e Huaja Direkte, konsumi i energjisë elektrike, bizneset, ndërmarrjet e mëdha, jetëgjatësia e banorëve, lëvizja e tyre nga zonat rurale drejt atyre urbane, - të tërë këta, faktorë mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të një vendi.

# KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## 6.1. Hyrje

Ky studim u fokusua tek urbanizimi si një element i rëndësishëm në rritjen ekonomike të një vendi. Në kapitujt e mëparshëm u paraqit shqyrtimi i hollësishëm i literaturës në lidhje me vetë konceptin e urbanizimit dhe zhvillimit. Analiza empirike u mbështet në të dhënat e mbledhura nga burimet dytësore. Mbi bazën e këtyre të dhënave u bë testimi i hipotezave të propozuara. Më tej u paraqitën rezultatet e testimit të lidhjeve të hipotezuara. Në këtë kapitull do të paraqiten konkluzionet dhe rekomandimet e këtij studimi.

Kështu, fillimisht më poshtë, në nënçështjet si 6.2 do të paraqiten konkluzionet e studimit, të cilat janë të lidhura kryesisht me gjetjet e analizës empirike të prezantuara në kapitullin e mëparshëm. Në nënçështjet 6.3 dhe 6.4 do të paraqesim kontributet teorike dhe praktike të studimit, ndërsa më pas, në nënçështjen 6.5. do të prezantohen kufizimet që përmban ky studim i nisur, dhe në fund, nënçështja 6.6 u kushtohet rekomandimeve për studiuesit dhe për praktikuesit në sektorin e urbanistikës dhe ekonomisë.

## 6.2. Konkluzione të studimit

Analiza kritike e literaturës e paraqitur në kapitullin e dytë dëshmoi për ekzistencën e një sërë studimesh në lidhje me urbanizimin dhe zhvillimin. Gjithsesi, kjo analizë tregoi se ende nuk ka një mendim të pranuar nga studiuesit në lidhje me konceptin "urbanizim" dhe lidhjen midis ekonomisë, faktorëve që e përcaktojnë atë. Në analizën e përcaktuesve të urbanizimit, faktorëve, ekonomisë, pra janë analizuar njëherazi disa elementë, të cilët, në dijeninë e autores së këtij studimi, nuk janë analizuar në të njëjtin model në asnjë studim tjetër.

Këta variabla ndikojnë dhe përcaktojnë urbanizimin e vendit, dhe nga shqyrtimi i literaturës teorike e sidomos empirike, duket se janë trajtuar kryesisht veçmas me urbanizimin dhe nuk janë analizuar njëherazi të gjithë së bashku në asnjë studim tjetër të mëparshëm. Kjo gjë përbën risi në lidhje me konceptimin e përgjithshëm.

Metoda e përdorur për përpunimin dhe analizën e të dhënave, megjithëse mjaft e njohur dhe e vlerësuar prej vitesh në literaturën shkencore ndërkombëtare, është fare pak e përdorur në studimet në Shqipëri.

Kjo analizë tregoi ndikimin e secilit prej faktorëve që ndikojnë në urbanizimin dhe rritjen ekonomike (si popullsia, Investimet e Huaja Direkte, jetëgjatësia në zonat urbane, ndërmarrjet, bizneset, zhvillimi i vendit etj.).

U vërtetua se rritja ekonomike ka një lidhje të qartë me rritjen e qyteteve shqiptare, me në krye Tiranën. Sa më e fuqishme të jetë rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto, aq më shpejt fshatrat shqiptare do të humbasin banorët e tyre dhe qytetet do të rriten. Prodhimi i Brendshëm Bruto krijon një efekt tërheqës kundrejt banorëve të zonave rurale dhe i shtyn ata të transferohen në qytete.

Është e vërtetë, nga një krah, se vendndodhja e re i detyron banorët të konsumojnë dhe të kryejnë aktivitetet normale të jetë së tyre në qytet, dhe kjo gjë rrit dimensionin e tregut të qytetit dhe kërkesën agregate që nga qyteti lind, por nga krahu tjetër, jo domosdoshmërisht banorët e rinj mund të kenë kompetenca profesionale që mund të sjellin një vlerë të shtuar të lartë dhe nuk është e thënë që banorët e rinj të kenë kapitale të bollshme për të investuar në ekonominë e qyteteve ku ata rishtas banojnë.

Në këtë aspekt, qytetet shqiptare, me Tiranën në krye, rrezikojnë të bëhen qendra parazitare dhe jo qytete që rriten nga bashkëpunimi virtuoz midis investimeve që tërheqin popullsi dhe popullsisë që investon dhe krijon zhvillim. Gjithashtu, ajo çfarë u vërtetua, si në rastin e Tiranës, edhe të qyteteve të tjera shqiptare, është se jetëgjatësia në qytete vazhdon të rritet më shumë se në zonat rurale. Interesante ishin gjithashtu të dhënat nga Investimet e Huaja Direkte, nga të cilat rezultoi që kishte rritje ekonomike në vend.

Me anë të kësaj analize u pa se Investimet e Huaja Direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në rritjen e urbanizimit në Shqipëri. Urbanizimi është një bazë e fortë për të krijuar dhe mbështetur një strategji të rëndësishme në rritjen ekonomike të një vendi.

Modeli i ofruar për të konceptuar dhe analizuar urbanizimin shpjegon mjaft mirë rëndësinë e secilit variabël. Ky model ofron mbështetje teorike dhe empirike për krijimin dhe zhvillimin e strategjisë së urbanizimit. Këto konkluzione qëndrojnë në bazë të kontributeve dhe rekomandimeve të studimit.

## 6.3. Kontribute teorike të studimit

Ky studim ofroi një trajtim të strategjisë së urbanizimit në lidhje me ekonominë. Studimi konfirmoi se urbanizimi është një strategji mjaft e rëndësishme për t'u ndjekur. Gjithashtu, studimi vlerësoi dhe përforcoi konceptimin e termit “zhvillim”. Shqyrtimi i literaturës tregoi se pak studime kishin analizuar urbanizimin dhe rritjen ekonomike në vendet në zhvillim.

Në këtë studim u zhvillua një model teorik i cili shërben si instrument për matjen e urbanizimit. U identifikuan dhe u analizuan empirikisht të gjitha lidhjet e hipotezuara midis elementëve në model. Mbi bazën e një trajtimi origjinal, ky studim ndërthur njohuri nga zhvillimi urban dhe lidhja ekonomike, si ndikojnë te njëri-tjetri. Studimi tregoi, se në analizën kritike të urbanizimit

duhet të përfshihen të gjithë faktorët që ndikojnë në të dhe të trajtohen së bashku, për të arritur një kuptim tërësor të kësaj strategjie.

Në këtë studim nuk u trajtuan vetëm lidhjet e drejtpërdrejta, por edhe ato jo të drejtpërdrejta ndërmjet faktorëve të ndryshëm, duke konfirmuar lidhjen pozitive midis tyre dhe midis urbanizimit. Eshtë përdorur gjërësisht literatura ekzistuese, dhe më tej është vazhduar në të dhëna primare të mbledhura posaçërisht për këtë studim.

Gjithashtu, modelimi i ekuacioneve strukturore u rikonfirmua si një teknikë e vlefshme për të analizuar në të njëjtën kohë, marrëdhënie të ndryshme midis variablave të varur dhe të pavarur të studimit.

### 6.4. Kontributet praktike të studimit

Krahas kontributeve teorike, ky studim ofron disa kontribute praktike, që mund t'u vijnë në ndihmë urbanistëve, sektorit të ekonomisë, por edhe institucioneve të tjera. Ai u fokusua në një strategji të fortë, konkretisht në lidhjen e urbanizimit me ekonominë, duke u ndalur në situatën aktuale.

Studimet e ngjashme me këtë studim pothuajse mungojnë, dhe ky përbën një kontribut mjaft të rëndësishëm praktik.

Një tjetër kontribut i rëndësishëm është analiza e faktorëve që ndikojnë në urbanizim, dhe kjo ndihmon pikërisht institucionet e ndryshme për të parashikuar vazhdimësinë dhe rritjen ekonomike të një vendi. Duke u bazuar në këtë studim, shohim se ku duhet të kontribuojmë më tepër në zhvillimin ekonomik të një vendi.

## 6.5. Kufizimet e studimit

Studimi i teorisë krahasohet gjithmonë me realitetin në praktikë. Pengesat në zbatim do të ekzistojnë në momentin që autoritetet kompetente ose personat përgjegjës në vendimmarrje do të jenë të kushtëzuar në pranimin ose kundërshtimin e propozimeve teorike të studimit.

Për shembull, nëse studimi propozon rregullore ose zgjidhje të cilat janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme në vendet e zhvilluara perëndimore, mund të ekzistojë mundësia që të njëjtat zgjidhje të mos jenë të përshtatshme në situatat reale për vendin e zgjedhur për studim. Pengesat në një situatë të tillë mund të kalohen në gjetjen e një zgjidhjeje, duke përdorur metoda më të thjeshta dhe më lehtësisht të zbatueshme në realitetin në të cilin do të zbatohen.

Nuk do trajtoj zhvillimet urbanistike në lidhje me tecet, koncensionet etj. Studimi i temës do të ketë në fokus urbanizimin, elementët e tij që ndikojnë në ekonomi si: popullësia, jetegjatësia e banorëve, lëvizja e banorëve nga zonat rurale në ato urbane, bizneset dhe ndërmarrjet ku janë më të zhvilluara, investimet e huaja direkte, konsumi i energjisë elektrike, produkti i brendshëm bruto. Periudha kohore e marrë në shqyrtim 2000-2014.

**Koha.** Urbanizimi është shumë kompleks, ka përjetuar zhvillim të shpejtë në vend sidomos në 25 vitet e fundit. Për të bërë një analizë të detajuar të sektorit të urbanistikës, ndikimet e tij në ekonomi dhe kontributin në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit, kërkon kohën e nevojshme.

**Aksesi i informacionit**. Informacioni lidhur me indikatorët dhe faktorët kryesorë në urbanizim është shumë i vështirë për t'u marrë.

## 6.6. Rekomandime

Urbanizimi dhe zhvillimi janë elemente mjaft të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të një vendi. Në këtë studim, urbanizimi u shqyrtua në sektorin e zhvillimit ekonomik, si një pjesë tepër e rëndësishme për një vend që është në zhvillim e sipër dhe për studiuesit që janë të angazhuar në këtë fushë të veçantë.

*Rekomandime për praktikuesit*

Ky studim konfirmoi lidhjen e urbanizimit me ekonominë. Faktorët me të rëndësishëm që ndikuan në urbanizim ishin të ndryshëm, si: popullsia, konsumi i energjisë elektrike, Investimet e Huaja Direkte, jetëgjatesia e banorëve etj.

Disa pika kyçe në të cilat duhet të fokusohemi për të arritur akoma edhe më tepër zhvillim në aspektin ekonomik dhe urban të një vendi janë:

Infrastruktura, do të ishte e nevojshme t'u vihej në dispozicion të gjithë banorëve; p.sh., furnizimi me ujë dhe kanalizime, rrugë të mira, sisteme të kullimit dhe shërbimeve sociale siç janë shkollat;

Një plan investimi, në rrugë të reja, rrjet të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, duhet të bëhet i njohur për banorët dhe të përditësohet vazhdimisht nga bashkia.

Të mund të realizohej strehimi i ligjshëm për pjesën më të madhe të popullsisë, pasi lëvizjet e banorëve tentojnë çdo ditë e më tepër të rriten drejt zonave urbane. Gjithashtu, vendbanimi dhe ndërtimet e reja të mund të ishin të ligjshme/formale, çka do të thotë se, sistemi duhet t'u lejojë përdoruesve të tokës të kenë një titull pronësie të ligjshëm dhe leje ndërtimi;

Qytetet të mund t'i zhvillonin hapësirat e tyre në mënyrë kompakte, në mënyrë që të lejojnë përdorimin maksimal të transportit publik, dhe të sigurojnë qëndrueshmëri ekonomike dhe mjedisore.

- Së dyti, në përputhje me këta objektiva të gjerë kombëtarë dhe me vizion lokal, çdo qytet ka nevojë të zhvillojë dhe të përditësojë planin rregullator (plani i përdorimit të tokës), duke përfshirë dhe planin e ndarjes së zonave.

Detyra kryesore është përcaktimi i zonave ku ndërtimet duhet të kufizohen ose shmangen për shkak të interesave mjedisore ose interesave të tjera publike, si dhe të sigurojë kritere shumë të qarta dhe të thjeshta për përdorimin e tokës, duke përfshirë këtu të drejtat e kalimit për rrugët kryesore për pjesën tjetër.

Një shembull i mirë është plani i ndarjes së zonave i Varshavës në Poloni, i cili mbron zonat delikate historike dhe mjedisore, dhe stimulon zhvillimin e orientuar drejt tregut, si dhe ripërdorimin e pronave që ndodhen në qendër, në mënyrë që të plotësohet kërkesa e tregut, duke mbajtur njëkohësisht qytetin sa më kompakt që të jetë e mundur.

Të krijohen hapësira për të mundësuar zhvillimin e industrisë së ndërtimit dhe kalimin, nga ndërtimi i ndërtesave për banim, në objekte me karakter social, kulturor dhe publik.

*Burimet e kapitalit*. Për zhvillimin e industrisë së ndërtimit dhe për përballimin e bumit të ndërtimeve në veprat publike, paraqitet nevoja e burimeve të kapitalit relativisht të mëdha, të cilat nuk mund të sigurohen nga burimet e brendshme të vetë biznesit të angazhuar me ndërtimin.

*Mungesa e energjisë elektrike* në vitet e kaluara ka ndikuar negativisht në biznesin e ndërtimit.

*Konkurrenca e pandershme.* Niveli i tregut informal dhe i konkurrencës së pandershme deformon zhvillimin e industrisë së ndërtimit dhe të vetë bizneseve të angazhuara me të. Kjo situatë sjell në ekonomi një orientim jo të drejtë dhe, në veçanti në ndërtim, i shkakton dëme të mëdha ekonomike shtetit direkt dhe indirekt.

Rritja e vendbanimeve informale dhe joligjore shpesh është lidhur ngushtë me norma të papranueshme. Kjo është arsyeja që çdo plan rregullues duhet të përmbajë një hartë që tregon

